



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 20

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 20

Janar-Dhjetor 2023

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: +383 38 222 055
Fax: +383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

KRYEREDAKTOR

Zana GJOCAJ

REDAKTORË

Krenare MALOKU BAKIJA

Bejtush KIÇMARI

AUTORË

Arta NUSHI

Taulant SYLA

Tringa NIKA

Blerta HYSENI

Albion MAZREKU

Shqipe ÇERKINI GRAINCA

REDAKTOR TEKNIK

Butrint BOJAJ

SHKURTESAT:

AJN	Asetet e Jashtme Neto
APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATM	Bankomatë (<i>anglisht: Automated Teller Machines</i>)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
KJP	Kreditë jo-performuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
MNI	Margjina Neto e Interesit
POS	Pika të Shitjes (<i>anglisht: Point of Sales</i>)
pp	Pikë Përqindje
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
TMK	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Vërejtje:

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2024),
Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 20, Prishtinë.
Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

PËRMBAJTJA:

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit -----	8
2. Përmbledhja e rreziqeve dhe zhvillimeve kryesore të stabilitetit financiar-----	8
Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar -----	18
3. Mjedisi i jashtëm dhe zhvillimet në ekonominë e brendshme -----	21
3.1 Ekonomia e brendshme-----	23
Kutia 2. Pasqyrë e Sektorëve të Aktiviteteve me Pasuri të Paluajtshme dhe Ndërtimtarisë-----	26
3.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve -----	30
3.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare -----	31
Kutia 3. Ngarkesa me Borxh e huamarrësëve Individual në Kosovë -----	33
4. Zhvillimet në sistemin financiar -----	33
4.1. Sektori bankar -----	43
Kutia 4. Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës -----	49
5. Rreziqet e sektorit bankar -----	54
5.1. Rreziku kreditor -----	55
5.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit -----	59
5.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja -----	62
5.4. Kapitali-----	63
5.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit -----	66
5.6. Kapaciteti absorbues i goditjeve - analiza Stress-Test-----	70
Kutia 5. Strategjia, Planet e Veprimet dhe Aktivitetet e deritashme të BQK-së në menaxhimin e rrezikut që ndërlidhet me ndryshimet e kushteve klimatike -----	79
6. Institucionet financiare jo-bankare -----	84
6.1 Sektori Pensional-----	84
6.2 Sektori i Sigurimeve-----	86
6.3. Sektori mikrofinanciar dhe ndihmësit financiar -----	90
7. Infrastruktura financiare në Kosovë -----	96
7.1. Sistemi i pagesave -----	96
8. Shtojca Statistikore -----	99

LISTA E GRAFIKËVE DHE FIGURAVE

Grafik 1. Indekset e çmimeve të ndërtimit, prodhimit dhe inputeve bujqësore -----	11
Grafik 2. Borxhi i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare -----	13
Grafik 3. Ndryshimi vjetor i kredive të reja -----	14
Grafik 4. Tregues të përzgjedhur të shëndetit financiar -----	14
Grafik 5. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuesit në rritje -----	23
Grafik 6. Indekset e shitjeve dhe të punësuarëve në sektorin e shërbimeve -----	24
Grafik 7. Inflacioni sipas kontributit të kategorive kryesore -----	28
Grafik 8. Pesha e artikujve në shportën e konsumit sipas normës së rritjes së çmimeve -----	28
Grafik 9. Ndryshimi vjetor në numrin e ndërmarrjeve të reja -----	30
Grafik 10. Borxhi i ndërmarrjeve -----	31
Grafik 11. Normat e interesit për ndërmarrjet -----	31
Grafik 12. Borxhi i ekonomive familjare -----	32
Grafik 13. Depozitat e ekonomive familjare -----	32
Grafik 14. Normat e interesit për ekonomitë familjare -----	32
Grafik 15. Pesha e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së -----	41
Grafik 16. Pjesëmarrja e sektorëve përkatës në asetet e sistemit financiar -----	41
Grafik 17. Pronësia e sektorëve përbërës të sistemit financiar -----	42
Grafik 18. Pjesëmarrja në strukturën e asetëve -----	44
Grafik 19. Pjesëmarrja në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake -----	44
Grafik 20. Stoku i gjithsej depozitave dhe depozitave të reja -----	45
Grafik 21. Pozicioni neto ndaj jo-rezidentëve -----	45
Grafik 22. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktiviteteve me jorezidentët -----	45
Grafik 23. Rritja vjetore e kredive për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare -----	46
Grafik 24. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të reja për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare -----	46
Grafik 25. Stoku i kredive sipas sektorëve të ekonomisë -----	47
Grafik 26. Kreditë a aprovuara dhe të garantuara nga FKGK -----	47
Grafik 27. Kreditë e ndërmarrjeve, pjesëmarrja sipas maturitetit -----	48
Grafik 28. Kreditë e ekonomive familjare, pjesëmarrja sipas maturitetit -----	48
Grafik 29. Indeksi i agreguar i stabilitetit të sektorit bankar -----	54
Grafik 30. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, sipas kriterëve të rreziqeve -----	55
Grafik 31. Rritja vjetore e stokut të kredisë dhe kredive jo-performuese -----	56
Grafik 32. Kreditë sipas kalsifikimit të ri kreditor në tri shtylla -----	56
Grafik 33. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave -----	57
Grafik 34. Kreditë joperformuese -----	57
Grafik 35. Raporti i KJP-ve ndaj stokut të kredisë, sipas sektorëve -----	58
Grafik 36. Raporti KJP/gjithsej kreditë në vende të rajonit -----	58
Grafik 37. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione -----	58
Grafik 38. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	59

Grafik 39. Struktura e profitit të sektorit bankar -----	59
Grafik 40. Kontribuesit kryesor në rritjen/zvogëlimin e profitit -----	59
Grafik 41. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit -----	60
Grafik 42. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit -----	60
Grafik 43. Struktura e të hyrave të sektorit bankar -----	60
Grafik 44. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar -----	60
Grafik 45. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	61
Grafik 46. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit -----	62
Grafik 47. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë -----	63
Grafik 48. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj -----	63
Grafik 49. Kapitalizimi i sektorit bankar -----	64
Grafik 50. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit -----	64
Grafik 51. Struktura e kapitalit rregullator -----	64
Grafik 52. Norma e levës -----	65
Grafik 53. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej asetëve të sektorit -----	65
Grafik 54. Asetet e peshuara me rrezik kreditor -----	65
Grafik 55. Klasat e asetëve sipas peshës së rrezikut -----	66
Grafik 56. Struktura e APR-ve për rrezik kreditor -----	67
Grafik 57. Struktura e financimit -----	66
Grafik 58. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar -----	67
Grafik 59. Struktura e depozitave -----	67
Grafik 60. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit -----	68
Grafik 61. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive -----	68
Grafik 62. Treguesi i Mbulimit me Likuiditet-Liquidity Coverage Ratio (LCR) -----	68
Grafik 63. Indikatorët e likuiditetit -----	69
Grafik 64. Rezervat e likuiditetit -----	69
Grafik 65. Hendeku i likuiditetit -----	70
Grafik 66. Rezultatet e TML të sektorit në bazë të skenarëve -----	77
Grafik 67. Kategoritë e TML sipas skenarit të rënduar -----	78
Grafik 68. Treguesi mbulimit me likuiditet -----	78
Grafik 69. Asetet e sektorit pensional -----	84
Grafik 70. Struktura e investimeve të sektorit pensional -----	84
Grafik 71. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës -----	85
Grafik 72. Performanca financiare e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve -----	85
Grafik 73. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve -----	86
Grafik 74. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë -----	86
Grafik 75. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	87
Grafik 76. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve -----	87
Grafik 77. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve -----	87
Grafik 78. Primet bruto të arkëtuara -----	88

Grafik 79. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara-----	90
Grafik 80. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	91
Grafik 81. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar -----	91
Grafik 82. Kreditë e sektorëve ekonomik sipas maturitetit -----	92
Grafik 83. Struktura e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik -----	92
Grafik 84. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj korporatave jofinanciare-----	92
Grafik 85. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar-----	93
Grafik 86. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	93
Grafik 87. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik-----	93
Grafik 88. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	94
Grafik 89. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	94
Grafik 90. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	94
Figura 1. Ndërlidhjet institucionale të Sistemit Financiar të Kosovës-----	42
Figura 2 . Ndërlidhjet bankare të sektorit bankar të Kosovës-----	43

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Rreziqet kryesore dhe qëndrueshmëria e sektorit bankar -----	10
Tabela 2. Borxhi ndaj bankave dhe performanca e ekonomive familjare -----	32
Tabela 3. Numri i institucioneve financiare -----	42
Tabela 4. Skenarët dhe peshat (haircut) të përdorura në secilin skenar për kategoritë kryesore të TML – LCR -----	74
Tabela 5. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit-----	89
Tabela 6. Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit -----	89
Tabela 7. Rezultati financiar -----	90
Tabela 8. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së-----	96
Tabela 9. Rrjeti i sektorit bankar-----	97
Tabela 10. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela-----	97
Tabela 11. Numri i llogarive të parasë elektronike-----	98
Tabela 12. Numri i llogarive të parasë elektronike-----	98

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) po prezanton numrin e 20-të të Raportit të Stabilitetit Financiar (RSF). Përmes një perspektive të analizës së bazuar në rrezik, RSF synon të informoj publikun mbi gjendjen e sistemit financiar, të rrisë transparencën dhe nxisë debatin profesional mbi zhvillimet dhe sfidat e sistemit financiar dhe infrastrukturës së tij.

Dinamikat në aktivitetin ekonomik global tregojnë për një rritje të ngadalësuar të aktivitetit ekonomik dhe rënie të inflacionit global, nën kushtet e një rritje të ndjeshme të normave të interesit. Rënia e presioneve inflacioniste u shoqërua me fillim të lehtësimit të politikave monetare, ndërkohë që balancimi i këtij lehtësimi në kontekst të mbështetjes ekonomike pa rikthyer presionet inflacioniste u konsiderua sfidë. Ekonomia e Eurozonës u karakterizua me ngadalësim më të theksuar ekonomik dhe përkundër rënies së shkallës së inflacionit, shkallë të lartë të inflacionit bazë përgjatë vitit 2023. Pavarësisht qëndrueshmërisë së sistemit financiar, rritja e normave të interesit dhe reduktimi i likuiditetit nga BQE rritën koston e financimit për bankat dhe rrezikun kreditor. Ndërkohë që parashikimet sugjerojnë për përmirësim gradual të ekonomisë së eurozonës në vitet në vijim, rreziqet ndaj këtyre pritjeve vazhdojnë të anojnë nga kahu i lartë, duke përfshirë tensionet gjeopolitike dhe ndikimin potencial në zingjirët e furnizimit dhe në çmime, zhvendosjen e pritjeve për inflacionin, kushtet klimatike, etj.

Ngjashëm me dinamikat globale, Ballkani Perëndimor u ballafaqua me ngadalësim të aktivitetit ekonomik dhe shtërngim të politikave monetare. Rënia graduale e normave të interesit pritet të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike në vijim, megjithëse subjekt i ndikimit të presioneve të jashtme si rikuperimi i kërkesës së jashtme dhe dinamikave të brendshme.

Ekonomia e Kosovës në vitin 2023 shënoi një rritje të qëndrueshme dhe rënie të shkallës së inflacionit. Përgjatë vitit 2024, mjedisi i

brendshëm dhe dinamikat makroekonomike janë përmirësuar, ndërkohë që parashikimet e BQK-së sugjerojnë një përshpejtim të rritjes reale të ekonomisë, mbështetur kryesisht nga rritja e të ardhurave reale të disponueshme, stabilizimi i çmimeve dhe lehtësimi i politikës monetare në tregjet globale, faktor që pritet të përkthehen në rritje të besueshmërisë së konsumatorëve dhe investitorëve. Ngadalësimi i ndjeshëm i inflacionit, rritja e shkallës së ndërmjetësimit financiar dhe përmirësimi i pozicionit fiskal tregojnë për zhvillime pozitive në mjedisin e brendshëm, që mbështetur nga stabilizimi i çmimeve ndërkombëtare, pritet të reflektojnë në një rritje reale ekonomike drejt nivelit potencial dhe të ndikojnë pozitivisht në stabilitetin financiar të Kosovës, si një ekonomi e hapur.

Në mbështetje të aktivitetit ekonomik, sektori bankar mbajti nivelin e një rritjeje dyshifrore të kreditimit përgjatë vitit, mbështetur kryesisht nga kërkesa, ndërkohë që materializimi i rreziqeve mbeti i ulët me tregues të pandryshuar të ulët të kredive jo-performuese. Rritja e të hyrave neto nga interesi kontribuoi në rritje të profitit, i cili për shkak të konkurrencës dhe presionit në anën e kostove, shënoi rritje të ngadalësuar vjetore. Rezerva e kapitalit u rrit me qasje kapitalizuese të BQK-së, duke kontribuar pozitivisht në qëndrueshmërinë e sektorit. Ndërkohë, ngadalësimi i rritjes së fitimeve dhe presionet në koston e financimit, pritet të vazhdojnë edhe në vitin 2024, duke ruajtur një rrezik të moderuar për financimin dhe profitabilitetin.

Performanca e mirë financiare e sektorit dhe qasja kapitalizuese e BQK-së mundësoi që raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të rritet, pavarësisht rritjes dyshifrore të kreditimit nga rritja e asetëve të peshura me rrezik. Gjithashtu, rritja e depozitave të sektorit privat mirëmbajti treguesit e likuiditetit mbi kërkesat rregullative.

Sistemi financiar në Kosovë ka adaptuar qasje prudente dhe proaktive të operimit përkitazi me rrethanat, si dhe ka krijuar rezerva të kënaqshme të kapitalit dhe likuiditetit për t'u përballuar me rreziqet e rritura të funksionimit të tij në periudhën në vijim.

Ahmet ISMAILI

Guvernator

Kryesues i Bordit Ekzekutiv

2. Përmbledhja e rreziqeve dhe zhvillimeve kryesore të stabilitetit financiar

Sistemi financiar i Kosovës vazhdoi të zgjerohet, duke ruajtur një pozicion të mirë të likuiditetit, financimit dhe kapitalit, përkundër operimit në ambient me rreziqe dhe pasiguri më të larta. Ekonomia globale dhe ajo e eurozonës kanë treguar qëndrueshmëri relativisht të lartë përballë sfidave dhe tronditjeve të shumta të viteve të fundit. Pavarësisht se rritja ekonomike ishte më e ngadaltë si rezultat i politikave shtrënguese monetare në luftë kundër inflacionit, ajo mbeti e kënaqshme duke pasur parasysh rreziqet dhe paqartësitë e shumta që e kanë rrethuar. Për më tepër, efektet e ngadalësimit ekonomik dhe rreziqeve kreditore indirekte nga rritja e inflacionit nuk u bartën në sektorin financiar.

Megjithatë, zhvillimet globale dhe makroekonomike kanë krijuar presione dhe sfida për sistemin financiar të Kosovës, të cilat u përballuan me sukses. Pasiguritë në eurozonë dhe tensionet gjeopolitike nuk e rritën ekspozimin ndaj rreziqeve në sektorin bankar, ndërsa rritja e normave të interesit pati ndikim të pjesshëm. Kjo ndikoi në rritjen e kostove të huamarrjes dhe depozitave. Konkurrenca për depozita dhe presioni në marzhën e fitimit, për shkak të rritjes së normave të interesit, shtuan rreziqet e financimit dhe profitabilitetit për sektorin bankar. Si rezultat, bankat janë përballur me një mjedis financiar më sfidues, duke ndryshuar strukturën e investimeve dhe financimit për të mbetur konkurrues dhe për të menaxhuar më mirë rreziqet që lidhen me luhatjet e normave të interesit. Rreziqet për stabilitetin financiar priten të mbeten të ngjashme edhe në vitin 2024, me tendenca përmirësimi. Zbutja e presioneve inflacioniste dhe frenimi i rritjes së normave të interesit pritet të ndikojnë pozitivisht në rreziqet nga sektori i

jashtëm. Njësoj, presionet mbi pozicionin e likuiditetit dhe financimit pritet të mbeten të larta për shkak të nevojës së shtuar për burime të financimit të aktivitetit kreditor dhe konkurrencës së lartë për tërheqje të depozitave në tregun e brendshëm, me mundësi të zgjerimit të burimeve të fondeve edhe jashtë.

Aktiviteti ekonomik global u ngadalësua lehtësisht në 3.3 përqind, dhe i njëjti ritëm është parashikuar të vazhdojë edhe në dy vitet në vijim. Inflacioni global vijoi të bjerë, por mbeti në nivele të larta për shkak të tregjeve të shtrënguara të punës dhe presioneve nga rritja e pagave. Për të frenuar inflacionin, bankat qendrore, përfshirë Rezervën Federale dhe BQE-në, rritën ndjeshëm normat e interesit. Megjithatë, me rënien e inflacionit, disa banka qendrore tashmë kanë filluar të lehtësojnë politikat monetare. Sfidë mbetet balancimi i këtij lehtësimi për të shmangur një lehtësim të parakohshëm që mund të rikthejë presionet inflacioniste, duke ruajtur njëkohësisht stabilitetin ekonomik.

Në këtë kontekst, ekonomia e Eurozonës shënoi ngadalësim më të theksuar, me rritje modeste prej 0.4 përqind. Inflacioni zbriti në 5.4 përqind në vitin 2023, nga 8.4 përqind një vit më parë, kryesisht për shkak të uljes së çmimeve të energjisë dhe stabilizimit të çmimeve të mallrave bazë. Sidoqoftë, inflacioni bazë shënoi rritje dhe mbeti i lartë në 5.0 përqind në vitin 2023. Pavarësisht qëndrueshmërisë së sistemit financiar, rritja e normave të interesit dhe reduktimi i likuiditetit nga BQE rritën koston e financimit për bankat dhe rrezikun kreditor, duke shtrënguar kushtet e kreditimit. BQE parashikon një përmirësim gradual të ekonomisë në vitet në vijim, të mbështetur nga rritja e pagave, eksportet dhe lehtësimi i politikës monetare, por që rreziqet ndaj këtyre projeksioneve vazhdojnë të anojnë nga kahu i lartë, duke përfshirë tensionet gjeopolitike dhe ndikimin potencial në zingjirët e furnizimit dhe në çmime, zhvendosjen e pritjeve për inflacionin, kushtet klimatike, etj.

Ballkani Perëndimor u ballafaqua me dinamika të ngjashme, me ç'rast zhvillimet në ekonominë e BE-së si dhe shtrëngimi i politikave monetare

të bankave në rajon për të frenuar inflacionin, ndikuan në ngadalësim të rritjes ekonomike. Inflacioni në rajon u ul në 7.7 përqind, por mbeti më i lartë në disa vende, si dhe u karakterizua me presione të larta të inflacionit bazë. Rënia graduale e normave të interesit pritet të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike në vijim, por mbetet subjekt i ndikimeve nga presionet e jashtme, duke përfshirë ngadalësimin e aktivitetit ekonomik në eurozonë dhe tensionet gjeopolitike, si dhe nga sfidat e brendshme si përballja me inflacionin dhe migrimin potencial bazuar në tregun e punës.

Ekonomia e Kosovës në vitin 2023 shënoi një rritje të qëndrueshme, me një normë

rritjeje të BPV-së reale prej 4.1 përqind, duke treguar një rënie të lehtë krahasuar me 4.3 përqind në vitin 2022. Rënia e eksportit të mallrave dhe rritja e importit të mallrave dhe shërbimeve ndikuan në ngadalësimin e aktiviteti ekonomik. Megjithatë, konsumi, së bashku me investimet dhe eksportin e shërbimeve, kontribuan pozitivisht në dinamikën ekonomike. Inflacioni në Kosovë zbriti në 4.9 përqind nga 11.6 përqind sa ishte në vitin paraprak, kryesisht për shkak të ngadalësimit të rritjes së çmimeve të ushqimit, rënies së çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare, dhe ngadalësimit të çmimeve të shërbimeve.

Tabela 1. Rreziqet kryesore dhe qëndrueshmëria e sektorit bankar

Rreziqet	2021	2022	2023	TM1 2023	TM2 2023	TM3 2023	TM4 2023	Trendet
Rreziqet								Trendi i rrezikut
Rreziku makroekonomik	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	→
Rreziku kreditor	Q. Mesatare	Q. Mesatare	Q. Mesatare	Q. Mesatare	Q. Mesatare	Q. Mesatare	Q. Mesatare	→
Rreziku në të hyrat (profitabiliteti)	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	→
Qëndrueshmëria e sektorit								Trendi i qëndrueshmërisë
Kapitalizimi	Q. Mesatare	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	Q. e shumë e ulët	→
Likuiditeti dhe financimi	Q. e shumë e ulët	Rrezik i lartë	Rrezik i lartë	Q. e shumë e ulët	Rrezik i lartë	Rrezik i lartë	Q. e shumë e ulët	→

Qëndrueshmëri e lartë Q. Mesatare Q. e ulët Q. e shumë e ulët

Rrezik i ulët Rrezik i mesëm Rrezik mbimesatar Rrezik i lartë

Burimi: BQK.

*Metodologjia e ndërtimit të tabelës së rrezikut dhe qëndrueshmërisë së sektorit bankar bazohet pjesërisht në metodologjinë e Hartës së Stabilitetit Financiar të Kosovës (sipas së cilës vlera e treguesve kryesorë përkatës notohet në relacion me historikun e tij), si dhe në vlerësimin e gjykimit të analistëve.

Kahja e shigjetës sugjeron për tendencën e rrezikut/qëndrueshmërisë në periudhën e fundit (tremujorin e fundit), si dhe pritjet për zhvillimet në periudhën vijuese një vjeçare.

Kur shigjeta e treguesëve të rreziqeve është me kahje lartë kemi të bëjmë me rritje të rreziqeve dhe anasjelltas

Kur shigjeta e treguesëve të qëndrueshmërisë është me kahje lart, kemi të bëjmë me forcim të qëndrueshmërisë dhe anasjelltas

Konsumi u mbështet nga rritja e pagave dhe burimeve të financimit, ngadalësimi i rritjes së çmimeve dhe përmirësimi i besimit të konsumatorëve. Investimet gjithashtu dhanë një kontribut pozitiv për dallim nga rënia në vitin e kaluar, kryesisht për shkak të rritjes së investimeve publike në infrastrukturë. Sektorët me kontributin më të lartë në rritjen ekonomike ishin industria përpunuese, ndërtimtaria, aktivitetet financiare dhe të sigurimit, si dhe transporti dhe magazinimi. Ndërsa, sektori i furnizimit me energji elektrike, bujqësia, dhe edukimi shënuan rënie në këtë periudhë. Ngadalësimi i inflacionit në Kosovë ndodhi kryesisht për shkak të ngadalësimit të rritjes së çmimeve të ushqimit


dhe rënies së çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare. Inflacioni bazë zbriti në 4.4 përqind, mbështetur nga ngadalësimi i çmimeve të shërbimeve të transportit dhe hotelierisë. BQK parashikon ngadalësimin e inflacionit në 1.6 përqind në vitin 2024, megjithëse rreziqet nga tensionet gjeopolitike dhe ndryshimet në tregjet e naftës mbeten të pranishme.

Sa i përket vitit 2024, është vërejtur përmirësim i kushteve makroekonomike në mjedisin e brendshëm ku vlerësimet preliminare të ASK-së sugjerojnë një rritje ekonomike prej 4.9 përqind në gjysmën e parë të vitit. Projeksionet e BQK-së sugjerojnë një rritje prej 4.3 përqind të

aktivitetit ekonomik në vitin 2024, e mbështetur nga rritja e të ardhurave të ekonomive familjare, kërkesa e huaj dhe stabilizimi i çmimeve, që do të rrisin besimin e konsumatorëve dhe investitorëve.

Kërkesa e brendshme pritet të ketë kontributin kryesor pozitiv, ndërsa eksportet neto pritet të kontribuojnë negativisht në rritje. Rritja e të ardhurave reale të disponueshme dhe investimet publike, së bashku me lehtësimin e politikës monetare në tregjet globale, do të mbështesin konsumin dhe investimet. Megjithatë, pasiguritë rreth projeksioneve mbeten të larta për shkak të rritjes së dobët të ekonomisë botërore dhe tensioneve gjeopolitike, që mund të ndikojnë negativisht në investime dhe tregti në vend.

Grafik 1. Indekset e çmimeve të ndërtimit, prodhimit dhe inputeve bujqësore



Burimi: BQK.

Ngadalësimi i ndjeshëm i inflacionit dhe përmirësimi i pozicionit fiskal tregojnë për zhvillime pozitive në mjedisin e brendshëm, që mbështetur nga stabilizimi i çmimeve ndërkombëtare, pritet të reflektojnë në një rritje reale ekonomike drejt nivelit potencial dhe të ndikojnë pozitivisht në stabilitetin financiar të Kosovës, si një ekonomi e hapur.

Pozicioni fiskal u konsolidua më tej si dhe bilanci i pagesave shënuan përmirësim gjatë vitit. Bilanci buxhetor për shkak të rritjes së të hyrave buxhetore kaloi në bilanc pozitiv prej 0.2 përqind nga territori negativ vitin e kaluar, si dhe borxhi publik shënoi rënie në 17.5 përqind. Bilanci i pagesave gjithashtu shënoi përmirësime të rëndësishme, me reduktimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe rritjen e bilancit të llogarisë kapitale. Zhvillime pozitive u shënuan kryesisht nga rritja e eksportit të shërbimeve,

veçanërisht në sektorin e udhëtimit dhe teknologjisë, ndërsa remitencat dhe investimet e huaja direkte shënuan rritje duke përfunduar rolin e tyre të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës. Megjithatë, rënia e eksportit të mallrave, e ndikuar nga rënia e kërkesës së jashtme dhe dinamikat e çmimeve, si dhe rritja e importit të mallrave, po ashtu e ndikuar nga dinamika e çmimeve globale, reflektojnë varësinë e lartë të ekonomisë nga zhvillimet globale si dhe problemet e gamës së ngushtë të mallrave eksportuese. Gjatë vitit 2023, investimet e kosovarëve jashtë vendit u rritën, sidomos në sektorin e patundshmërisë, dhe kjo dukuri mund të çojë në ulje të investimeve private brenda vendit, duke dobësuar potencialin e rritjes së brendshme. Ndërkohë, liberalizimi i vizave pritet të rrisë remitencat përmes kanaleve joformale/jo-zyrtare, por gjithashtu mund të ndikojë në rënie të bilancit të shërbimeve për shkak të rritjes së importit të shërbimeve të udhëtimit jashtë vendit.

Sektori privat shënoi rritje të qarkullimit në sektorin e tregtisë dhe industrisë, kryesisht si reflektim i rritjes së çmimeve dhe zgjerimit të aktiviteteve prodhuese. Po ashtu, numri i ndërmarrjeve të reja shënoi rritje, i përqendruar kryesisht në sektorët e tregtisë, aktiviteteve profesionale dhe informacionit, ndërsa ndërmarrjet e mbyllura pësuan rënie, veçanërisht në ndërtimtari dhe hoteleri. Financimi i aktivitetit të ndërmarrjeve përmes borxhit nga institucionet financiare vendore dhe të jashtme vazhdoi të rritet, megjithëse me normë më të ulët krahasuar me vitin e kaluar. Gjithsej borxhi i ndërmarrjeve u rrit për 9.7 përqind, në 45.1 përqind të BPV-së, me trend më të ngadalshëm të rritjes krahasuar me vitin e kaluar. Borxhi i brendshëm është rritur për 10.7 përqind, me ritëm më të ngadalësuar të rritjes së borxhit ndaj sektorit bankar, përderisa rritja e borxhit në sektorin mikrofinanciar u përshpejtua dhe rezultoi në 4.5 përqind të gjithsej borxhit të ndërmarrjeve ndaj sektorit financiar. Borxhi i jashtëm i ndërmarrjeve, kryesisht në formë të kredive tregtare, është rritur për 7.1 përqind, duke arritur në 28.6 përqind të gjithsej borxhit. Raporti i kreditimit të ndërmarrjeve nga

institucionet kredituese vendase ndaj BPV-së arriti në 32.2 përqind, duke çuar në një hendek pozitiv të kredisë ndaj BPV-së. Përkundër rritjes më të lartë të depozitave të ndërmarrjeve në raport me kreditimin, pozicioni neto debitor i ndërmarrjeve ndaj sektorit bankar shënoi rritje vjetore prej 9.4 përqind, si rezultat i efektit të volumit më të madh të kredive. Kreditë e reja të ndërmarrjeve në sektorin bankar shënuan ngadalësim të rritjes vjetore, ndikuar nga rënia e kërkesës por edhe rritja e normës së interesit në dy vitet e fundit. Për vitin 2024, pritet që rreziku për sektorin e ndërmarrjeve të mbetet në nivele të ngjashme, me një tendencë të lehtë ulëse, si rezultat i pritjeve për rritje të aktivitetit ekonomik. Sidoqoftë, sfidat e tregut të punës mbesin dhe mund të ndikohen tutje pjesërisht me liberalizimin e vizave, duke shtuar nevojën për strategji inovative për rritje të produktivitetit.

Borxhi i ekonomive familjare shënoi rritje vjetore më të lartë krahasuar me borxhin e ndërmarrjeve, prej 18.0 përqind dhe arriti në 22.7 përqind të BPV-së, ende në shkallë më të ultë të ndërmjetësimit krahasuar me rajonin. Rritja u ndikua kryesisht nga borxhi i brendshëm ndaj bankave, ngase rritja e borxhit të brendshëm nga mikrofinanciat si dhe borxhi i jashtëm, përkundër rritjes së lartë kanë pjesëmarrje të ulët. Kreditë e reja të lëshuara nga sektori bankar për ekonomitë familjare shënuan rritje të përshpejtuar vjetore, kryesisht si rezultat i rritjes së lartë të kredive personale jo investuese (jo hipotekare) për 23.2 përqind, ndërkohë që kreditë e reja hipotekare (sipas definicionit rregullativ) shënuan rënie për 11.3 përqind. Neto pozicioni kreditor i ekonomive familjare ndaj sektorit bankar shënoi rritje vjetore prej 6.8 përqind, ndikuar nga niveli më i lartë i depozitave në raport me kreditë. Aktivitetit kreditues, përkundër rritjes së lehtë të normës së interesit, u rrit më shpejtë se depozitat, të cilat gjithashtu shënuan rritje të përshpejtuar vjetore. Këto të fundit u rritën si rezultat i normës së favorshme të interesit të ofruar nga bankat si dhe rritjes së të ardhurave të ekonomive familjare nga rritja e pagave, remitencave dhe rritja e shkallës së punësimit. Gjithashtu treguesi i varësisë ekonomike, që

paraqet raportin ndërmjet popullsisë së përgjithshme joaktive (mbi 15 vjeç) dhe punësimin, tregoi përmirësim, duke sugjeruar për rritje të të ardhurave në dispozicion. Rezultatet e vlerësimit të ngarkesës me borxh të huamarrësve individual sugjerojnë për rënie të lehtë të nivelit të pjesëmarrjes së huamarrësve të cilët shuma e kësteve mujore tejkalon 50 përqindshin e të hyrave mujore në 25.9 përqind nga 26.1 përqind. Por, përkundër kësaj, pjesëmarrja e huamarrësve në fazë kritike - kësti mujor tejkalon 75 përqindshin e të hyrave mujore - dhe atyre që kanë këstin mujor më të lartë se niveli i të hyrave, ka treguar tendencë të lehtë rritëse, me përqendrim tek huamarrësit me nivel më të ulët të të ardhurave. Si mekanizëm për bartjen e rrezikut nga normat e interesit tek huamarrësit, bankat kanë vazhduar rritjen e pjesëmarrjes së kredive me normë variable që arriti në 33.9 përqind të portofolit të kredisë, gjë që në rrethanat aktuale të pritjeve për lehtësim të politikës monetare, mund të rezultojë në rënie të kostos së servisimit të borxhit për këtë pjesë të huamarrësve. Në përgjithësi, performanca e ripagesës së ekonomive familjare ka mbetur e kënaqshme me ndikim të ulët nga rritja e kostos së jetesës, ndërsa presioent inflacioniste pritet të bien dhe rreziku potencial nga migrimi nuk u materializua.


Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit të jashtëm shënoi rritje vjetore të lartë për të dytin vit radhazi, kryesisht për shkak të rritjes së investimeve në letra me vlerë, të cilat ofruan kthime më të larta, megjithëse pjesëmarrja e tyre mbetet relativisht e ulët. Kërkesat ndaj jo-rezidentëve në dhjetor 2023 përbënin 16.8 përqind të totalit të aseteve të sektorit bankar. Detyrimet e sektorit bankar ndaj jo-rezidentëve gjithashtu mbesin të ulëta, në vetëm 4.2 përqind të detyrimeve. Ndërsa, prania e kufizuar e aseteve dhe detyrimeve në valutë të huaj redukton rrezikun e bartjes së problemeve nga jashtë dhe shmang humbjet e mundshme nga luhajtjet e pafavorshme të kursit të këmbimit ndaj euros.

Aktiviteti kreditor i sektorit bankar mbajti nivel rritjeje dyshifrore, megjithëse shënoi ngadalësim të rritjes. Dinamikat e

kreditimit në tremujorin e katërt të vitit 2023, ashtu si gjatë pjesës tjetër të vitit, u ndikuan kryesisht nga kërkesa kreditore, ndërkohë që oferta kreditore kishte ndryshime të vogla. Ngadalësimi i shkallës së rritjes pasqyron trendin më të ngadalësuar të rritjes së kreditimit për korporatat jofinanciare, si dhe parapagimin e një pjese të kredive nga disa kreditorë të mëdhenj, përderisa ekonomitë familjare përshpejtuan rritjen.

Rritja më e ngadalësuar e kreditimit për korporatat jofinanciare karakterizoi sektorët ekonomikë me peshë të lartë të portofolit kreditor bankare si prodhimtarinë, tregtinë dhe ndërtimit, e që është në linjë me qarkullimin më të ngadalësuar të ndërmarrjeve të këtyre veprimtarive ekonomike. Kreditimi ndaj ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme vazhdoi të mbështet nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, që në vitin 2023 shtoi edhe dy dritare të reja për përkrahje të grave në biznes dhe ndërmarrjeve eksportuese. Kreditë për ekonomi familjare përshpejtuan ritmin e rritjes, si rezultat i rritjes së lartë të kredive të reja konsumuese për financim të nevojave për konsum. Kreditë e reja hipotekare vazhduan me rënien që filloi qysh nga viti 2022, dhe ky zhvillim ndikoi në frenimin e trendit rritës të pjesëmarrjes së kredive afatgjata (mbi 5 vite) në gjithsej strukturën e kredive sipas maturitetit.

Grafik 2. Borxhi i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare, në milionë euro



Burimi: BQK

Pavarësisht shqetësimeve për rrezikun kreditor të shkaktuar nga ndryshimet makroekonomike, materializimi i tij ishte i ulët dhe atë përkeqësimi i portofolit kreditor u vu re vetëm në tremujorin e fundit të vitit që rezultoi me rritje më të


theksuar të vlerës së kredive jo-performuese, megjithëse treguesi i kredive jo-performuese mbeti i njëjtë (2%). Performanca e mirë financiare dhe aftësia e ndërmarrjeve për të shlyer borxhet mbështetën kryesisht nga aktiviteti i rritur ekonomik dhe bartja e kostove të konsumatorët finalë, ndërsa konsumatorët u mbështetën nga rritja e pagave, pakove stimuluese, remitencat dhe aktiviteti ekonomik në disa sektorë. Ndërkohë, edhe pse kreditë jo-performuese u rritën lehtë, raporti i tyre ndaj gjithsej kredive mbeti i njëjtë si në vitin paraprak, në 2.0 përqind, për shkak të zgjerimit të kreditimit. Ekonomitë familjare shënuan rritje të lehtë vjetore të raportit të kredive jo-performuese, nga 1.2 përqind në 1.4 përqind, ndërsa segmenti i ndërmarrjeve shënoi rënie të lehtë të këtij raporti nga 2.5 përqind në 2.4. Bankat reagueshan duke shtuar rezervat, duke klasifikuar sektorët më të prekur dhe duke shtrënguar kriteret e huadhënies. Disa sektorë të ndjeshëm ndaj krizës energjetike dhe inflacionit u kategorizuan në shtyllën e dytë (sipas klasifikimit të SNRF 9), përfshirë edhe klientët individualë me të ardhura më të ulëta. Në vitin 2024, me përmirësimin e kushteve të tregut, disa prej këtyre kredive u riklasifikuan në shtyllën e parë për shkak të mos materializimit të rrezikut kreditor. Megjithatë, bankat mbeten të vëmendshme duke monitoruar rrezikun potencial nga migrimi pas liberalizimit të vizave për Kosovën në zonën Schengen, përkundër që sipas të dhënave aktuale ky rrezik nuk u materializua. Disbalancat në tregun e punës dhe ndikimi i tyre potencial në performancën e ndërmarrjeve, sidomos NVM-ve, së bashku me rritjen e kredive personale-konsumuese, theksojnë nevojën për vazhdimësi të qasjes prudenente ndaj rrezikut të mundshëm kreditor. Koncentrimi i rrezikut kreditor, i shprehur si raport ndërmjet vlerës së ekspozimeve të mëdha ndaj numrit të këtyre ekspozimeve, ka shënuar rritje të lehtë por mbetet nën nivelin maksimal rregullator të ekspozimeve kreditore.

Rritja e të hyrave neto nga interesi kontribuoi në rritje të profitit, i cili për shkak të konkurrencës dhe presionit në anën e kostove, shënoi rritje të ngadalësuar vjetore. Rezerva e kapitalit u

rrit me qasje kapitalizuese të BQK-së, duke kontribuar pozitivisht në qëndrueshmërinë e sektorit. Megjithatë, ngadalësimi i rritjes së fitimeve dhe presionet në kostot e financimit, pritet të vazhdojnë edhe në vitin 2024, duke ruajtur një rrezik të moderuar për financimin dhe profitabilitetin.

Struktura e investimeve dhe financimit ka pësuar ndryshime të ndjeshme, të nxitura nga rritja e normave të interesit dhe konkurrenca për depozita e cila u reflektua në rënie të profitit të sektorit bankar nga viti paraprak.

Grafik 3. Ndryshimi vjetor i kredive të reja




Burimi: BQK.

Pra, kjo rënie e profitit u ndikua kryesisht nga dy faktorë: rritja e normave të interesit dhe ndryshimet në strukturën e investimeve dhe financimit. Rritja e normave të interesit ndikoi pjesërisht kërkesën për kredi, duke ngadalësuar kreditimin krahasuar me vitin paraprak. Për më tepër, disa banka u përballën me konkurrencë të lartë për depozita, gjë që ndikoi në ofertën e tyre kreditore. Ndërkohë, disa banka më të mëdha përfituan nga normat atraktive të kthimeve nga investimet në tregjet e jashtme, duke zhvendosur pozicionet nga kreditimi drejt investimeve në letra me vlerë ndërkombëtare. Kjo rezultoi në profit më të lartë për disa banka, ndërsa të tjera u përballën me kosto më të larta financuese. Të hyrat nga interesi në kredi dhe letra me vlerë kontribuan në rritjen e profitit, ndërsa shpenzimet administrative dhe interesi për depozita e ngadalësuan këtë rritje. Kthimi mesatar në asete mbeti në nivelin e njëjtë të një viti më parë 2.5 përqind, ndërsa kthimi mesatar në kapital u zvogëlua për 1 pikë përqindje në 22.0 përqind.

Ekspozimi ndaj rrezikut të ndryshimeve në normat e interesit është rritur, vlerësuar nga rritja e hendekut ndërmjet aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit. Ky hendek kumulativ u zgjerua si rezultat i rritjes së maturitetit të kredive si dhe investimeve në letra me vlerë afatgjata, përderisa depozitat janë ende me maturitet kryesisht afatshkurtër. Megjithatë, ky është rrezik i moderuar që mundëson mbështetjen ndaj ekonomisë, brenda apetitit të riskut. Si mekanizëm për mbrojtje ndaj ekspozimit ndaj këtij rreziku, sektori vazhdoi rritjen e pjesëmarrjes së kredive me norma variable, duke zhvendosur një pjesë të rrezikut tek huamarrësit, që në anën tjetër paraqet rrezik të shtuar kreditor. Rënia e pritshme e normave të interesit mund të ndikojë negativisht në të hyrat nga kreditë variable dhe mundësitë e riinvestimit të këtyre mjeteve. Ndaj, në vijim, profiti i sektorit bankar karakterizohet nga pasiguritë e rritura në aspekt të mundësive të sektorit për të realizuar të hyra në nivelet aktuale, ngase konkurrenca në rritje pritet të shtoj presionin në kostot e financimit, përkundër rënies së përgjithshme të normave të interesit.

Grafik 4. Tregues të përzgjedhur të shëndetit financiar



Burimi: BQK.

Performanca e mirë financiare e sektorit dhe qasja kapitalizuese e BQK-së, mundësoi që raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të rritet, pavarësisht rritjes dyshifrore të kreditimit nga rritja e aseteve të peshura me rrezik. Bankat me rëndësi sistemike vazhdojnë të kenë normë më të lartë të kapitalizimit.

Gjithsesi, varianca midis TMK-së së bankave individuale dhe mesatares së sektorit bankar ka shënuar rënie, duke treguar një përafrim të TMK-së ndaj mesatares së sektorit. TMK u rrit në 17.4 përqind, nga 15.5 përqind një vit më parë. Pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë është e lartë në 89.3 përqind, që tregon për cilësi të lartë të kapitalit rregullativ. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit të klasit të parë ndaj asetëve të peshuara me rrezik, si dhe leva financiare, u rritën në 15.6 përqind, respektivisht 9.8 përqind dhe qëndrojnë mbi kërkesat rregullative. Sidoqoftë, përkundër nivele të kapitalit mbi kërkesat minimale rregullatore, rritja e vazhdueshme e kompleksitetit të sektorit dhe rreziqeve të jashtme me të cilat mund të ballafaqohet sektori shton nevojën për fuqizimin e mekanizmave për rritje të rezistencës. Për shkak të rritjes së konsiderueshme të asetëve dhe kreditimit gjatë viteve të fundit, në mungesë të të dhënave të duhura për segmente të caktuara është e vështirë matja e rreziqeve në segmente të caktuara në nivel të sektorit. Në të njëjtën kohë, rreziqet makroekonomike dhe gjeopolitike kanë krijuar një ambient pasigurie, duke e bërë edhe më të domosdoshme rritjen e rezistencës ndaj goditjeve potenciale. Tendencat globale sugjerojnë se, për shkak të sfidave në parashikimin e rreziqeve, është e rëndësishme që bankat të shfrytëzojnë periudhën aktuale të profitabilitetit të lartë për të rritur nivelet e kapitalit rregullator, të cilat, në rastin e Kosovës, janë më të ulëta në krahasim me rajonin dhe Bashkimin Evropian.

Sektori bankar i Kosovës vazhdon të mbetet i qëndrueshëm në aspektin e likuiditetit, me treguesit kryesorë që qëndrojnë mbi kërkesat rregullative, kryesisht për shkak të rritjes së depozitave të sektorit privat. Megjithatë, rritja e normave të interesit gjatë vitit ka krijuar konkurrence dhe presione për bankat në ruajtjen e pozicionit të likuiditetit dhe menaxhimin e kostove të financimit. Rritja e depozitave ishte më e lartë në fillim të vitit 2023, por kjo rritje u ngadalësua drejt fundit të vitit, e ndikuar nga tërheqjet më të mëdha të depozitave nga

korporatat dhe individët, gjë që mund të lidhet me nevojat e shtuara për financim në cikël të biznesit dhe pritshmëritë për stabilizim të normave të interesit. Raporti i asetëve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra ka shënuar rënie në disa banka për shkak të rritjes më të lartë të detyrimeve, ndërsa disa banka të tjera kanë ruajtur apo përmirësuar këtë raport. Nga ana tjetër, treguesi i mbulimit me likuiditet (LCR), i cili filloi të raportohet nga fillimi i vitit, qëndron në një nivel të lartë, megjithëse me dallime të theksuara ndërmjet bankave. Disbalancat në tepricat e likuiditetit midis bankave dhe ngadalësimi i rritjes së depozitave kanë vënë në pah rrezikun e financimit. Pjesa e lartë e depozitave të transferueshme, së bashku me rritjen e kërkesës për financim të qëndrueshëm, thekson më tej rëndësinë e praktikave prudente të bankave në lidhje me burimet e tyre të financimit dhe kostot përkatëse, përballë aktivitetit të zgjeruar kreditor dhe financiar.

Sektorët tjerë në kuadër të sistemit financiar u karakterizuan me rritje dhe performancë financiare pozitive, duke përfutuar nga normat globale të rritura të interesit. Sektori pensional, i dyti për nga pesha në sistemin financiar, shënoi rritje të përshpejtuar të asetëve pas një ngadalësimi të theksuar një vit më parë. Kjo rritje i atribuohet kthimit pozitiv në investime në vlerë prej 88.5 milionë euro. Numri i kontributdhënësve dhe vlera e kontributeve të paguara ka përshpejtuar trendin e rritjes duke kontribuar gjithashtu në zgjerim të asetëve. Për dallim nga viti i kaluar, investimet jashtë vendit kanë shënuar rritje të pjesëmarrjes, ndikuar nga mundësitë më të mëdha për kthim.

Si rezultat i kthimeve më të larta, çmimi i aksionit të dy fondeve pensionale shënoi rrije.

Sektori i sigurimeve vazhdoi zgjerimin dyshifror të asetëve, mbështetur nga rritja e primeve të shkruara nga policat e shitura, por pesha e tij në kuadër të sistemit financiar mbetet e ulët me vetëm 2.7 përqind të asetëve totale. Niveli i ndërmjetësimit dhe densitetit të sektorit mbeten të ngjashëm me vitet paraprake, me një

rritje marginale të primeve të shkruara bruto në raport me BPV-në, që qëndron në 1.51 përqind, dhe një densitet prej 92.3 euro për kokë banori. Si rezultat i rritjes së të hyrave nga primet e shitura dhe uljen e pagesave për risigurim, sektori mbylli vitin me fitim shumë më të lartë se viti paraprak, duke kontribuar tutje në zvogëlim të humbjeve të bartura nga vitet e kaluara. Niveli i likuiditetit në sektor ka pësuar një rënie të lehtë si rezultat i rritjes më të lartë të rezervave teknike. Ecuria e trajtimit, rezervimit dhe pagesës se dëmeve mbetet në fokusin e lartë të BQK-së.

Sektori mikrofinanciar shënoi rritje të ndjeshme, kryesisht falë zgjerimit të kreditimit dhe lizingjeve, pavarësisht kostove të larta të financimit nga jashtë, të cilat nuk u barten tek kredimarrësit ndaj ngadalësuar rritjen e fitimit të sektorit. Viti i ardhshëm pritet të sjellë kushte më të favorshme sa i përket normave të interesit në tregjet financiare globale, gjë që mund të reflektohet në uljen e kostove të financimit.

Asetet e sektorit shënuan rritje prej 34.8 përqind (edhe për shkak të ri-kategorimit të dy institucioneve financiare nga ndryshimi i licencës), ndërsa stoku i kredive u rrit për 25.9 përqind, me një rritje të dukshme në të dy segmentet, ekonominë familjare dhe korporatat jofinanciare, mbështetur nga kërkesa e rritur kreditore. Lizingjet gjithashtu shënuan rritje prej 30.8 përqind, me peshën kryesore të lizingjeve për korporatat jofinanciare. Normat e interesit për kreditë e sektorit mikrofinanciar u ndikuan pjesërisht nga dinamikat globale, duke ndaluar trendin e rënies graduale të viteve të fundit dhe duke shënuar një rritje të lehtë. Rritja e normave të interesit në tregjet globale nga financohet sektori në masën më të madhe ndikoi në rritje të theksuar të shpenzimeve të interesit, përderisa normat veçse të larta të interesit në anën e aseteve (kredi dhe lizingje) kufizuan mundësitë për rritje të të hyrave nga interesi me të njëjtin magnitudë. U rritën gjithashtu shpenzimet nga jointerisi, ndikuar nga presionet për rritje të pagave si dhe rritja e numrit të punëtorëve, dhe së bashku me rritjen e shpenzimeve për provizione, ndikuan në rritjen e raportit shpenzimeve ndaj të hyrave si dhe rënie të treguesve të profitabilitetit për sektorin. Megjithatë, sektori mbetet i mirë

provizionuar dhe ka mbajtur një nivel të ulët të kredive joperformuese përkundër rritjes së lartë të kreditimit dhe sfidave të fundit si kosto e lartë e jetesës dhe aktiviteti më i ngadalësuar ekonomik.

Sistemi i pagesave ndër-bankare të Kosovës ka vazhduar të operojë me qëndrueshmëri dhe efikasitet të lartë, duke kontribuar në efikasitetin dhe stabilitetin financiar. Krahas rritjes graduale të përdorimit të sistemit të pagesave, janë ndërmarrë veprime rregullative dhe operacionale për zgjerimin e bazës së përfshirjes, rritjen e digjitalizimit si dhe avancimin e sistemit drejt standardeve dhe praktikave të aplikueshme ndërkombëtare. Transaksionet në sistem janë rritur si në volum ashtu edhe në vlerë, me rritje më të theksuar të përdorimit të pagesave digjitale dhe ulje të përdorimit të parasë së gatshme. Përdorimi i llogarive bankare online dhe shërbimeve përmes pajisjeve elektronike, si POS dhe ATM, është rritur me trend të përshpejtuar, duke e përmirësuar qasjen dhe shërbimet për klientët. Njëkohësisht, rritja e përdorimit të shërbimeve të digjitalizuara dhe proceseve të automatizuara është reflektuar edhe në rritje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut operacional dhe kibernetik, duke rritë kapitalin për mbulueshmëri ndaj këtij rreziku si dhe përpjekjet tjera për mbrojtje dhe adresim të tij.

Mbikëqyrja makroprudenciale ka shënuar përparime të rëndësishme në drejtim të përmirësimit të modeleve vlerësuese dhe zhvillimit të kornizës së testimeve të qëndrueshmërisë financiare (stres-testit makroprudencial), megjithëse sfida e vazhdueshme mbetet disponueshmeria e të dhënave cilësore dhe sektoriale për vlerësimin adekuat të rrezikut sistematik. Përkundër kapitalit cilësor dhe niveleve të larta të fitimit të sektorit bankar, vlerësohet nevoja për aplikim të instrumenteve specifike të politikës makroprudenciale, me qëllim rritjen edhe me tej të rezistencës së sektorit ndaj rreziqeve të mundshme, në situata të përshtatshme për ndërtim të tyre. Kompleksiteti në rritje i sektorit bankar dhe ekspozimi ndaj rreziqeve ciklike dhe strukturore thekson nevojën për një qasje më proaktive në ruajtjen e qëndrueshmërisë. Ndërsa sektori bankar i Kosovës tejkalon kërkesat minimale për

kapital, trendet nga tërheqjet e dividendëve dhe reduktim të kapitalit mbi kërkesat rregullative dhe presionet e mundshme mbi profitabilitetin për shkak të konkurrencës së brendshme dhe rënies së normave globale të interesit nënvizojnë rëndësinë e ruajtjes së kapaciteteve për përballje me goditjet potenciale, në rrethanat e rritjes së shpejtë të kreditimit dhe mungesës së informacionit për vlerësim në kohë të akumulimit të rreziqeve. Andaj, për të forcuar sistemin financiar, është miratuar korniza e shtesës kundërciklike pozitive-neutrale (CCyB) në linjë me praktikën e fundit të vendeve evropiane, që lejon ruajtjen e një niveli të caktuar kapitali edhe kur rreziqet nuk janë të theksuara ose kur

mungon informacion i mjaftueshëm për vlerësim të rrezikut sistemik. Gjithashtu, për adresimin e komponentës strukturore të rrezikut sistemik, është duke u shqyrtuar aplikimi i shtesës së kapitalit për bankat me rëndësi sistematike. Rrjedhimisht, të njëjtat pritjet të ndihmojnë në fuqizimin e qëndrueshmërisë së sektorit, menaxhimin e rreziqeve ciklike dhe strukturore, duke siguruar që bankat të mbajnë kapital të mjaftueshëm gjatë periudhave të rritjes së shpejtë të kreditimit dhe të mund të përballojnë ndikimet e mundshme negative në periudha të caktuara, konform rolit të tyre kritik në sistemin financiar përkatësisht peshës së tyre sistematike.

Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar¹

Harta e stabilitetit financiar² paraqet zhvillimet në treguesit kryesorë të rreziqeve ndaj stabilitetit financiar (Grafik 1). Në vitin 2023, rreziqet ndaj stabilitetit financiar mbetën të ulta dhe në nivelin e ngjashëm me vitin paraprak. Përderisa rreziqet që burojnë nga norma e lartë e inflacionit shënuar rënie si rezultat i zbutjes së presioneve inflacioniste, shënuan rritje rreziqet nga rritja e kostos së financimit dhe ngadalësimi i aktivitetit ekonomik – zhvillime këto të prishme si rezultat i masave të shtrënguara të politikës monetare.

Treguesit e ekonomisë së brendshme dhe të jashtme, si dhe ai i veprimtarisë së ndërmarrjeve, u karakterizuan me rritje vjetore rreziku, ndërsa treguesit tjerë si veprimtaria e Ekonomive familjare dhe ajo e Qeverisë shënuar rënie. Në kuadër të treguesve të qëndrueshmërisë së sektorit, rënie rreziku – përkatësisht rritje të qëndrueshmërisë shënoi treguesi i Kapitalizimit dhe Profitabilitetit si dhe ai i Strukturës së sektorit bankar, ndërsa treguesi i Likuiditetit dhe Financimit u karakterizua me rritje të lehtë të rrezikut. Megjithëse treguesi i veprimtarisë së ndërmarrjeve shënoi rritjen më të lartë në notën e rrezikut, ai rezultoi nën nivelin e mesatares historike. Ndërsa dy treguesit tjerë që shënuan rritje të lehtë të notës së rrezikut, ai i ekonomisë së brendshme dhe i Likuiditetit dhe Financimit, qëndruan mbi mesataren historike (Grafik 2).³


Dinamika e treguesit të **ekonomisë së jashtme** për vitin 2023 u përcaktua nga nëntreguesi i normave të interesit, i cili shënoi rritje të theksuar si rezultat i politikës shtrënguese monetare në nivel global. Gjithashtu, me rritje rreziku u karakterizua edhe nëntreguesi i normës së rritjes ekonomike të partnerëve kryesorë tregtar të Kosovës, si rezultat i ngadalësimit të rritjes ekonomike në këto vende. Nëntreguesit tjerë shënuan rënie rreziku, duke zbutur efektin rritës së rrezikut në normën mesatare të treguesit. Çmimet e naftës ishin në nivel më të ulët se viti 2022; Sentimenti i ndërmarrjeve shënoi përmirësim, si dhe Treguesi i Papunësisë shënoi rënie, meqë dinamikat negative në sektorin real dhe politika e shtrënguar monetare nuk u reflektuan

gjatë vitit në tregun e punës në vendet evropiane me koncentrimin më të lartë të diasporës kosovare.

Tutje në vitin 2024, pritjet janë që rreziqet nga sektori i jashtëm të mbesin në nivel të ngjashëm, me mundësi përmirësimi si rezultat i zbutjes së presioneve inflacioniste, dhe stagnimit të rritjes së normës së interesit.

Rreziku nga **ekonomia e brendshme** shënoi po ashtu rritje, duke reflektuar ndikimin e ngadalësimit të rritjes ekonomike në vend si dhe zhvlerësimin e euros në raport me valutat e partnerëve tregtarë. Borxhi i jashtëm në raport me BPV-në gjithashtu shënoi rritje, por në shkallë të ulët. Ndërsa, nëntreguesi i indeksit të çmimeve të konsumit shënoi rënie të notës së rrezikut, si rezultat i ngadalësimit të trendit të inflacionit. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në raport me BPV-në shënoi përmirësim, dhe së bashku me inflacionin zbutën efektin e rritjes së notës së rrezikut nga nëntreguesit tjerë. Për vitin në vijim, rreziku nga Ekonomia e brendshme pritet të zbutet, si rezultat i pritjeve për aktivitet më të rritur ekonomik dhe inflacion në rënie.

Grafik 1. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: BQK.

Sektori i ndërmarrjeve shënoi rritje të notës së rrezikut krahasuar me një vit më parë, si rezultat i ecurisë në indeksin e qarkullimit në sektorët kryesorë me peshën më të madhe në ekonominë e vendit. Përkatësisht, indeksi i qarkullimit industrial, indeksi i qarkullimit në sektorin e shërbimeve, si dhe vlera e shtuar në BPV nga sektori i tregtisë, përkundër rritjes pozitive vjetore, shënuan shkallë

¹ Kalkulimi i treguesve bazohet në vlerën e BPV-së deri në majin mars 2021, dhe nuk përfshinë revidimin e fundit të BPV-së në prill 2021.

² Harta e Stabilitetit Financiar (HSF) prezanton në mënyrë grafike lëvizjen e shkallës së rrezikut në kategoritë kryesore të rrezikut ndaj stabilitetit financiar në sektorin bankar të Kosovës, si dhe mundëson krahasimin me notën mesatare historike të rrezikut për kategoritë përkatëse. Rritja e distancës nga qendra e hartës për treguesit reflekton

rritje të rrezikut dhe zvogëlim të aftësisë për përballimin e goditjeve ndaj stabilitetit financiar, dhe anasjelltas. Metodologjia e plotë e modelit të HSF-së për Kosovën, i cili ka pësuar revidime të vazhdueshme në tregues dhe mënyrën e tyre të llogaritjes, paraqitet në Materialin Studimor të BQK-së Nr. 6.

³ Ecuria e rrezikut nga treguesit e Hartës së Stabilitetit Financiar dhe kontributi i komponentëve përbërëse në nivelin përkatës të rrezikut paraqitet në Shtojcën 1.

më të ulët të rritjes vjetore në raport me vitin paraprak. Në nivel të ngjashëm mbeti nëntreguesi i hendekut të kreditimit si rezultat i ngadalësimit të trendit të kreditimit krahas ngadalësimit të rritjes së aktivitetit ekonomik. Nëntreguesi i ecurisë së ndërmarrjeve kishte kontribut pozitiv si rezultat i bilancit pozitiv të regjistrimit të ndërmarrjeve të reja. Gjithashtu, treguesi i cilësisë së portfolios kreditore kishte kontribut të lehtë pozitiv, i ndikuar nga rritja më e lartë e kredive në raport me vlerën e kredive joperformuese të ndërmarrjeve. Për vitin 2024, treguesi i ndërmarrjeve pritet të ketë nivel të ngjashëm rreziku me tendencë rënese si rezultat i pritjeve për aktivitet të përshpejtuar ekonomik.


Rreziku nga **ekonomitë familjare** shënoi rënie të lehtë, i ndikuar kryesisht nga rritja e burimeve të financimit, përkatësisht rritja e përshpejtuar vjetore e dërgesave të emigrantëve si dhe rënia e shkallës së papunësisë. Ndërsa, nëntreguesit tjerë u karakterizuan me rritje të notës së rrezikut duke zbutur efektin pozitiv të nëntreguesve të mësipërm. Hendeku i kreditimit ndaj BPV-së u zgjerua, i ndikuar nga rritja e përshpejtuar e kredive për ekonomitë familjare në raport me BPV-në. Gjithashtu, norma e kredive joperformuese shënoi rritje të lehtë si rezultat i rritjes më të lartë të vlerës së kredive joperformuese në raport me rritjen e kreditimit. Informatat për nëntreguesin e përballeshmërisë së shpenzimeve, që është nëntregues mjaft i rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut, ishin të mangëta edhe për vitin 2023. Ecuria e rritjes së lartë të kreditimit të ekonomive familjare, nëse shoqërohen me rritje potenciale të KJP-ve të këtij segmenti mund të ndikojnë në rritjen e notës së rrezikut të këtij treguesi në vitin vijues. Megjithatë, indikacione për këtë nuk vërehen nga vlerësimi i deritanishem.

Rreziku nga **sektori qeveritar** shënoi rënie, si rezultat i rënies së notës së rrezikut në katër nga gjithsej pesë nëntreguesit përbërës. Shtrëngimi i politikës monetare ka ndikuar në rritjen më të theksuar të normës së interesit në bonot e thesarit të qeverisë gjermane, në krahasim me ato të qeverisë së Kosovës të cilat pësuan rritje më të ulët të normës, duke u reflektuar kështu në ngushtim të dallimit, përkatësisht rënie të primit të rrezikut sovran. Nëntreguesi i radhës me rënie më të lartë të notës së rrezikut ishte ai i të ardhurave tatimore, të cilat shënuan rritje më të lartë në raport me BPV-në. Rënia e borxhit publik në raport me BPV-në kontribuoi në rënie të notës së rrezikut gjithashtu, ndërsa nëntreguesi i bilancit buxhetor në raport me BPV-në kishte kontribut të ulët përshkak të nivelit të ngjashëm të deficitit fiskal. Nëntreguesi i vetëm me rritje të notës së rrezikut ishte ai i kostos së

borxhit publik, si rezultat i rritjes së normave të interesit. Sa i përket vitit 2024, efekti negativ nga nëntreguesi i kostos së financimit mund të zbutet përshkak të frenimit të shtrëngimit tutje të politikës monetare në nivel global, me efekt pozitiv në dimensionin e rrezikut nga sektori qeveritar.

Në kuadër të treguesve të brendshëm të qëndrueshmërisë së sektorit, **treguesi i kapitalizimit dhe profitabilitetit** u karakterizua me fuqizim, përkatësisht rënie të përgjithshme të rrezikut, si rezultat i zhvillimit pozitiv në pothuajse të gjithë nëntreguesit. Kontributin kryesorë pozitiv e shënoi rënia e ekspozimeve të mëdha në raport me kapitalin e klasit të parë. Tutje, kontribut pozitiv dhanë rritja e raportit të të hyrave neto nga interesi ndaj aseteve të sektorit, si dhe rënia e raportit të kredive joperformuese. Gjithashtu, rezerva e kapitalit, përkatësisht diferenca e normës së kapitalizimit dhe minimumit të kërkuar me rregullore shënoi rritje në raport me vitin paraprak, dhe së bashku me rritjen e raportit të ekuitet ndaj aseteve të sektorit kontribuan pozitivisht në rënie e notës së rrezikut.

Grafik 2. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: BQK.

Nëntreguesi i vetëm me kontribut negativ në notën e rrezikut ishte ai i fitimit ndaj aseteve të sektorit, i cili shënoi rënie si rezultat i rritjes së ngadalësuar të profitit të sektorit, i cili pritet të jetë subjekt i presionit më të lartë edhe në vitin 2024 për shkak të konkurrencës dhe rritjes së kostos së financimit.

Treguesi i likuiditetit dhe financimit të sektorit shënoi rritje të lehtë të rrezikut, me zhvillime të ndryshueshme në nëntreguesit përbërës. Ngadalësimi i trendit rritës së depozitave të ekonomive familjare kishte kontributin kryesorë në rritje të notës së rrezikut. Dinamika e rritjes më të lartë të kreditimit krahas ngadalësimit të rritjes së depozitave ndikuan gjithashtu në rënie e raportit të likuiditetit dhe rritjen e raportit kredi/depozita, duke u reflektuar me notë më të lartë rreziku nga këta nëntregues. Ndërsa, nëntreguesi i hendekut

kumulativ të likuiditetit për periudhën 3 mujore dhe ai i pjesëmarrjes së detyrimeve të jorezidentëve shënuan rënie të notës së rrezikut. Në vitin 2023, hendeuku kumulativ i likuiditetit për këtë afat maturimi u zgjerua me ritëm më të ngadalshëm në raport me gjithsej asetet, si rezultat i rritjes së maturitetit të depozitave dhe reduktimit relativ të atyre me afat më të shkurtër, të nxitura nga ofertat për normë më të lartë të interesit. Si rezultat i rritjes së rrezikut në treguesin e Likuiditetit dhe Financimit, devijimi mbi nivelin e mesatares historike që ky tregues e kishte ndër vite shënoi rritje. Në vijim, pritet që presionet në pozicionin e likuiditetit dhe financimit të rriten, si rezultat i rritjes së nevojës për financim të aktivitetit kreditues në rrethana të rritjes së konkurrencës dhe ngadalësimit të rritjes së depozitave.

Struktura e sektorit bankar shënoi rënien më të theksuar të rrezikut, si vazhdimësi e trendit gradual

rënës që e karakterizon këtë tregues ndër vite. Të gjithë nëntreguesit përbërës shënuan rënie të notës së rrezikut, por kontributin më të lartë e kishte ai i rritjes së diversifikimit të burimeve të financimit. Nëntreguesi i radhës me kontributin më të lartë ishte ai i devijimit negativ të normës së kapitalizimit ndaj normës mesatare të kapitalizimit, i cili u karakterizua me përmirësim, përkatësisht ngushtim të devijimit negativ ndaj mesatares. Nëntreguesi i diversifikimit të portfolios së kredisë së bankave ndaj asaj të tregut gjithashtu shënoi përmirësim si rezultat i rritjes së diversifikimit të kreditimit dhe reduktimit të koncentrimin. Ndërsa me ndryshime pozitive por më të vogla ishin nëntreguesi i përgjithshëm i konkurrencës, përkatësisht asetet e tri bankave më të mëdha ndaj asetëve të sektorit, dhe ai i diversifikimit të portfolios së kredive të bizneseve, i cili kishte nivel pothuajse të njëjtë me vitin paraprak.

3. Mjedisi i jashtëm dhe zhvillimet në ekonominë e brendshme

Ekonomia globale shfaq qëndrueshmëri në vitin 2023, me rritje të aktivitetit ekonomik dhe ngadalësim të inflacionit i cili u mbështet nga shtrëngimi i politikës monetare. Po ashtu, edhe sistemi financiar ishte stabil, pasi sfidat në sistemin bankar nuk u amplifikuan siç ekzistonin disa shqetësime. Megjithatë, shtrëngimi i kushteve të financimit, tensionet gjeopolitike dhe ngadalësimi i tregtisë globale të mallrave, ndër të tjera, ndikuan në ngadalësim të aktivitetit ekonomik global. Sipas vlerësimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), aktiviteti ekonomik global u ngadalësua në 3.3 përqind në vitin 2023 nga 3.5 përqind në vitin paraprak, dhe ky ritëm është parashikuar të vazhdojë edhe në dy vitet pasuese. Sigurisht, perspektiva është subjekt i rishikimit të vazhdueshëm në bazë të ecurive ekonomike. Dinamikat ekonomike variojnë mes ekonomive, me rritje të përshpejtuar në ekonomitë e zhvilluara si Kina, SHBA-të, dhe Japonia, dhe ngadalësim të dukshëm në BE dhe Britaninë e Madhe. Rritja ekonomike u mbështet nga aktiviteti në shërbime, përkatësisht ato të udhëtimit dhe turizmit, kurse kërkesa për mallra mbeti e zbehur.

Inflacioni global vijoi të ndjekë ecuri rënëse përgjatë vitit 2023, duke rezultuar me normë mesatare vjetore prej 6.7 përqind. Ngadalësimi i inflacionit u mundësua nga politika shtrënguese monetare që ndikoi në zbehje të aktivitetit ekonomik dhe nga rënia e çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare. Përkundër shqetësimeve rreth rikthimit të presioneve inflacioniste nga konflikti në Lindjen e Mesme dhe pengesat në transport të mallrave përmes Detit të Kuq, ndikimi ishte i limituar në zinxhirët e furnizimit dhe në çmime. Në anën tjetër, tregjet e shtrënguara të punës, të përforcuara nga migrimi në ekonomitë e zhvilluara, si dhe rritja e pagave ushtruan presione inflacioniste që ngadalësuan ritmin e rënies së inflacionit. Sipas projeksioneve të

FMN-së, inflacioni global pritet të bie në 5.8 përqind në 2024 dhe 4.3 përqind në 2025. Sidoqoftë, ecuria e inflacionit kushtëzohet nga faktorë që ndikojnë kahun e ofertës, si tensionet gjeopolitike, barrierat tregtare, kushtet klimatike, etj., dhe së fundmi kryesisht nga dinamikat në sektorin e shërbimeve dhe tregun e punës. Të dhënat e tregut të punës në SHBA ngritën shqetësime rreth perspektivës së ekonomisë si pasojë e rritjes së shkallës së papunësisë. Shqetësime janë ngritur edhe për Eurozonën, bazuar në atë se numri i punëtorëve mund të rezultojë artificialisht i lartë në pritje të rritjes së kërkesës, e cila mund të rezultojë më e zbehur. Po qe se këto dinamika vazhdojnë, ritmi i rënies së inflacionit do të përshpejtohej, duke ndikuar potencialisht edhe në ritmin e lehtësimit të politikës monetare. Prandaj, sfidë për Bankat Qendrore mbetet kohëzgjatja e shtrëngimit të politikës monetare aq sa është e nevojshme për të shmangur një lehtësim të hershëm që mund të rikthejë presione inflacioniste, mirëpo edhe një vonesë e cila mund të sjellë pasojë të ndjeshme në aktivitetin ekonomik dhe normë më të ulët të inflacionit sesa ajo e targetuar.

Përgjatë vitit 2023, Rezerva Federale rriti normat e interesit për 100 pikë bazë, duke rezultuar në rritje kumulative prej 525 pikë bazë nga marsi 2022. Ndërsa, normat e interesit të BQE-së u rritën për 450 pikë bazë në total nga korriku 2022, me rritje prej 200 pikë bazë vetëm në vitin 2023. Ngadalësimi i inflacionit, mirëpo edhe i aktivitetit ekonomik në përpjekje për të frenuar inflacionin, ndikuan në rritjen e pritjeve të tregut për lehtësim të politikës monetare. Rezerva Federale uli normat e interesit për 50 pikë bazë në shtator 2024, kurse Banka Qendrore Evropiane (BQE) uli normën bazë të interesit për 50 pikë bazë deri në shtator, si dhe zvogëloi diferencën mes normës bazë dhe normës së rifinancimit të operacioneve nga 50 në 15 pikë bazë.

Normat e ngritura të interesit në vitin 2023 në nivel global u pasqyruan në ngadalësim të rritjes së kreditimit si pasojë e rënies së

kërkesës për kredi dhe shtrëngimit të kushteve të financimit nga bankat. Përgjatë vitit u evidentuan presione në segmente të caktuara, veçanërisht në bankat e ekspozuara ndaj sektorit të patundshmërive komerciale si pasojë e rënies së çmimeve në këtë sektor. Në anën tjetër, si rrjedhojë e rritjes së optimizimit në tregjet financiare për lehtësim të politikës monetare, u evidentua zvogëlim i premiumit të riskut dhe rënie e spread-eve të letrave me vlerë të korporatave dhe të qeverisë, si dhe rritje e vlerës së asetëve në bursat kryesore. Kjo e fundit ka rritur rreziqet ndaj stabilitetit financiar global në rast të një korigjimi potencial të çmimeve të asetëve.

Ekonomia e Eurozonës dhe Ballkanit Perëndimor

Aktiviteti ekonomik në Eurozonë ishte relativisht i dobët në vitin 2023, me rritje prej vetëm 0.4 përqind sipas Eurostat. Përballë një sfondi të karakterizuar me kosto të ngritur financimi, norma të larta inflacioni dhe pasiguri tjera, kërkesa e brendshme ishte relativisht e dobët e pasqyruar edhe në rënie të importit të mallrave. Kurse, rënia e kërkesës së jashtme për mallra ndikoi negativisht eksportin e mallrave dhe akumulimin e stoqeve, që shënuan rënie në vitin 2023. Banka Qendrore Evropiane (BQE) parashikon një përmirësim gradual të ekonomisë së Eurozonës në vitet në vijim. Aktiviteti ekonomik pritet të rritet për 0.8 përqind në 2024 dhe 1.3 përqind në 2025. Ky parashikim bazohet, ndër të tjera, në pritjet për lehtësim të kushteve të financimit, rritje të të ardhurave të disponueshme nga rritja e pagave, rritje të eksporteve me përmirësimin e tregtisë globale.

Inflacioni në Eurozonë u ngadalësua në 5.4 përqind në vitin 2023, nga 8.4 përqind në vitin e mëparshëm. Rënia e inflacionit ishte rezultat i rënies së çmimeve të energjisë dhe stabilizimit të çmimeve të mallrave tjera bazë në tregjet ndërkombëtare, ankorimit të pritjeve për inflacionin, si dhe transmetimit të shtrëngimit të politikës monetare në aktivitetin ekonomik. Në anën tjetër, presione inflacioniste vazhduan të ndjehen

në sektorin e shërbimeve, nxitur pjesërisht nga tregu i shtrënguar i punës dhe rritja e pagave, që u pasqyruan edhe në përsheptim të inflacionit bazë në 4.9 përqind në 2023 nga 4.0 përqind në vitin paraprak.

Sipas Eurostat, inflacioni i përgjithshëm u ngadalësua në 2.6 përqind në korrik 2024, dhe ai bazë në 2.9 përqind. Projektionet e BQE-së parashohin që inflacioni të shënojë mesatare vjetore prej 2.5 përqind në 2024 dhe të ulet në 2.2 përqind në 2025. Rreziqet kryesore ndaj këtyre projeksioneve vazhdojnë të anojnë nga kahu i lartë, duke përfshirë tensionet gjeopolitike dhe ndikimin potencial në zingjirët e furnizimit dhe në çmime, zhvendosjen e pritjeve për inflacionin, rritjen e pagave ose fitimeve përtej pritjeve, kushtet klimatike, etj.

Rritja e normave të interesit dhe reduktimi i likuiditetit nga BQE, rezultuan në rritje të koston të financimit për bankat në Eurozonë dhe rritje të rrezikut kreditor. Këta faktorë ndikuan që bankat të vazhdojnë shtrëngimin e kushteve të kreditimit për të gjitha segmentet e ekonomisë në vitin 2023. Shtrëngimi i kushteve kreditore ishte më i theksuar për ndërmarrjet, veçanërisht ato në tregun e patundshmërive komerciale. Për ekonomitë familjare, u evidentua shtrëngim i standardeve për kredi konsumuese, ndërsa për kreditë hipotekare ka pasur ngadalësim të dukshëm në shtrëngimin e kushteve të kreditimit si rezultat i rritjes së konkurrencës për kreditimin e këtij segmenti. Për më shumë, kreditimi u ndikua negativisht edhe nga rënia e kërkesës nga ndërmarrjet si rezultat i dobësimit të investimeve fikse dhe rritjes së koston të financimit. Po ashtu, kërkesa e ekonomive familjare për kredi është ulur si rezultat i rritjes së normave të interesit, rënies së besueshmërisë së konsumatorëve dhe pasigurive në tregun e patundshmërive.

Ekonomia në vendet e Ballkanit Perëndimor shënoi rritje të ngadalësuar mesatarisht prej 3.0 përqind në vitin 2023 (4.1 përqind në vitin 2022), e ndikuar nga ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në vendet e BE-së dhe politikat monetare të aplikuara nga bankat qendrore

të rajonit për të frenuar inflacionin. Në Shqipëri dhe Mal të Zi, rritja ekonomike u mbështet nga zgjerimi i sektorit të shërbimeve, veçanërisht për shkak të rritjes së të ardhurave nga turizmi. Ndërsa në vendet tjera të rajonit rritja ekonomike u mbështet kryesisht nga konsumi. Rritja ekonomike më e lartë u shënuar në Mal të Zi (6.0 përqind), e mbështetur nga performanca e mirë e turizmit, ndërsa rritja më e ulët u shënuar në Maqedoninë e Veriut (1.0 përqind), ndikuar kryesisht nga ngadalësimi i investimeve.

Projeksionet e FMN-së për vitin 2024 sugjerojnë për rritje mesatare prej 3.2 përqind për vendet e Ballkanit Perëndimor. Rritja ekonomike mund të ndikohet nga presionet e jashtme, duke përfshirë ngadalësimin e aktivitetit ekonomik në eurozonë dhe tensionet gjeopolitike, si dhe nga sfidat e brendshme si përballja me inflacionin dhe tregun e punës.

Norma e inflacionit shënoi rënie në vlera një shifrore në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor (me përjashtim të Serbisë). Inflacioni në rajon u ngadalësua në 7.7 përqind (nga 11.6 përqind në vitin 2022), e mbështetur nga dinamikat e çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht të energjisë dhe ushqimeve, të cilat kanë një pjesëmarrje të lartë në shportën e konsumit. Shtrëngimi i politikave monetare nga bankat qendrore të vendeve të rajonit, së bashku me përmirësimin gradual të zinxhirëve të furnizimit gjithashtu kontribuan në stabilizimin e inflacionit në rajon.

Aktiviteti kredihënës në vitin 2023 është rritur në nivel më të ngadalësuar kundrejt vitit paraprak, me Kosovën që shënoi rritjen më të lartë me 13.0 përqind, ndjekur nga Mali i Zi me 7.7 përqind dhe Bosnjë e Hercegovina me 5.5 përqind. Cilësia e kredive në rajon ka mbetur e qëndrueshme, duke marr parasysh që kreditë jo-performuese shënuan rënie pothuajse në të gjitha vendet e rajonit, përveç Serbisë që raportoi rritje marginale. Rënia më e theksuar ishte në Mal të Zi dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, ndërsa Kosova ishte


i vetmi vend që kishte nivel të ngjashëm të kredive jo-performuese kundrejt vitit paraprak.

Bankat qendrore në vendet e rajonit kanë marrë vendime për normat bazë të interesit varësisht nga ecuria e zhvillimeve ekonomike në vendet përkatëse. Këshilli mbikëqyrës i bankës së Shqipërisë në korrik të vitit 2024, uli normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindje, duke zbritur nga niveli 3.25 përqind në 3.0 përqind, bazuar në performancën e mirë të ekonomisë dhe ngadalësimin të inflacionit. Ndërsa në gusht 2024 vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 3.0 përqind. Në Maqedoninë e Veriut, norma bazë e interesit u ul për 0.25 pikë përqindje deri në shtator 2024 nga niveli 6.30 përqind në 6.05 përqind. Ndërsa në Serbi, norma bazë e interesit u ul tre herë deri në shtator të vitit 2024, nga niveli 6.5 përqind në 5.7 përqind, në përpjekje për të stimuluar rritjen ekonomike. Rënia graduale e normave të interesit pritet të ndikoi pozitivisht në rritjen ekonomike në muajt e ardhshëm, duke rritur kërkesën për huamarrje dhe investime.

3.1 Ekonomia e brendshme

Aktiviteti ekonomik në Kosovë, ngjashëm me dinamikat në rajon, u karakterizua me rritje të qëndrueshme në vitin 2023. Norma e rritjes së BPV-së reale rezultoi në 4.1 përqind, sipas vlerësimeve të ASK-së, kundrejt 4.3 përqind në 2022 (Grafik 5).

Grafik 5. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuesit në rritje



Rënia e eksportit të mallrave, si dhe rritja e importit të mallrave dhe shërbimeve, ndikuan që rritja e aktivitetit ekonomik të

jetë pak më e ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, rritja ekonomike u mbështet nga konsumi, investimet dhe eksporti i shërbimeve.

Dinamikat që karakterizuan sektorin e jashtëm të ekonomisë, veçanërisht bilancin tregtar të mallrave dhe shërbimeve, kontribuuan me një ndikim negativ prej 0.5 pikë përqindje në rritjen e BPV-së. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve kontribuoi me 2.8 pikë përqindje, ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve kontribuoi negativisht me 3.3 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së. Rritja e deficitit tregtar në terma real ishte rezultat i rritjes së importit të mallrave për 1.3 përqind dhe shërbimeve për 20.2 përqind, si dhe rënies së eksportit të mallrave për 7.2 përqind. Ndërsa, ndër të tjera, rritja e vizitave të diasporës në Kosovë rezultoi në rritje reale të eksportit të shërbimeve për 12.7 përqind.

Në vitin 2023, konsumi si komponentë kryesore e kërkesës së brendshme kontribuoi me 3.4 pikë përqindje në rritjen e BPV-së reale, krahasuar me 2.9 pikë përqindje në vitin 2022. Rritja e konsumit shpjegohet me rritjen e pagave dhe burimeve të financimit, ngadalësimin e rritjes së çmimeve dhe përmirësimin e besimit të konsumatorëve. Investimet gjithashtu kontribuuan pozitivisht në rritjen e BPV-së reale me 1.2 pikë përqindje në vitin 2023, krahasuar me -1.4 pikë përqindje në vitin 2022, kryesisht për shkak të rritjes së investimeve publike në infrastrukturë.


Në tremujorin e parë të vitit 2023, rritja ekonomike u gjenerua kryesisht nga rritja e investimeve dhe përmirësimi i eksporteve neto, kryesisht si rezultat i rritjes së eksportit të shërbimeve dhe rënies së importit të mallrave. Konsumi shënoi rritje të ngadalësuar për shkak të nivelit të lartë të inflacionit në tremujorin e parë. Nga tremujori i dytë e tutje, kërkesa e brendshme filloj të rikuperohet si rezultat i stabilizimit të çmimeve. Ndërkohë, kërkesa e jashtme e dobësuar dhe rënia e çmimeve ndërkombëtare ndikuan negativisht eksportin e mallrave dhe pozitivisht importin

e mallrave, duke bërë që megjithatë rritja ekonomike të jetë pak më e ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak.

Sektorët me pjesëmarrjen më të lartë në vlerën e shtuar me kontributin më të lartë në rritjen ekonomike ishin industria përpunuese, tregtia, aktivitetet financiare dhe të sigurimit, industria nxjerrëse, si dhe transporti dhe magazinimi. Ndërsa, sektori i furnizimit me energji elektrike, bujqësia dhe edukimi shënuan rënie në këtë periudhë.

Rritja e aktivitetit ekonomik, sidomos në sektorin e shërbimeve, është reflektuar edhe në statistikat e shërbimeve, ku është vërejtur rritje e indeksit të vëllimit të qarkullimit. Sektorët që shënuan rritjen më të lartë të vëllimit të shitjeve ishin aktivitetet arkitekturorë dhe inxhinierike (23.6 përqind), hotelet (12.1 përqind), pasuar nga agjencitë e udhëtimit (8.5 përqind), restorantet (8.0 përqind), tregtia (5.7 përqind), si dhe informacioni dhe komunikimi (1.8 përqind). Mesatarisht, indeksi i vëllimit të qarkullimit në sektorin e shërbimeve shënoi rritje prej 7.8 përqind në vitin 2023, ndërsa indeksi mesatar i numrit të punësuarve u rrit për 2.6 përqind (Grafik 6).

Grafik 6. Indekset e shitjeve dhe të punësuarëve në sektorin e shërbimeve (2015=100)



Burimi: ASK.

Sa i përket vitit 2024, është vërejtur përmirësim i kushteve makroekonomike në mjedisin e brendshëm, ku vlerësimet preliminare të ASK-së sugjerojnë për rritje ekonomike prej 4.9 përqind në gjysmën e parë të vitit. Gjithashtu, është shënuar ngadalësim i ndjeshëm i inflacionit dhe përmirësimi i pozicionit fiskal. Këto zhvillime pozitive në mjedisin e brendshëm, mbështetur nga stabilizimi i çmimeve

ndërkombëtare, pritet të mbështesin rritjen ekonomike dhe të ndikojnë pozitivisht në stabilitetin financiar të Kosovës.

Projeksionet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të shënojë rritje prej 4.3 përqind në vitin 2024. Kjo rritje pritet të mbështetet nga rritja e të ardhurave të familjeve, kërkesa e huaj dhe stabilizimi i çmimeve, të cilat pritet të ndikojnë në rritjen e besimit të konsumatorëve dhe investitorëve. Kërkesa e brendshme pritet të kontribuojë me 6.8 pikë përqindje në rritjen e BPV-së, ndërsa eksportet neto pritet të kontribuojnë negativisht me 2.6 pikë përqindje.

Rritja e të ardhurave reale të disponueshme, si rezultat i rritjes së remitencave, kompensimit të punëtorëve, kredive konsumuese dhe stabilizimit të çmimeve, pritet të mbështesë konsumin, i cili pritet të kontribuojë me 5.3 pikë përqindje në rritjen e BPV-së. Investimet pritet të kontribuojnë me 1.5 pikë përqindje në rritjen e BPV-së, me një ndikim të rëndësishëm nga investimet publike, dinamika pozitive e çmimeve dhe lehtësimi i politikës monetare në tregjet globale.

Eksporti i mallrave dhe shërbimeve pritet të ndikojë pozitivisht në rritjen e BPV-së me 4.4 pikë përqindje, mbështetur nga rritja e eksportit të shërbimeve, sidomos shpenzimeve të diasporës në Kosovë. Ndërsa, importi i mallrave dhe shërbimeve pritet të kontribuojë negativisht me 7.0 pikë përqindje, ndikuar më shumë nga importi i shërbimeve.

Megjithatë, pasiguritë rreth projeksioneve makroekonomike mbeten relativisht të larta për shkak të tensioneve gjeopolitike dhe rritjes së dobët të ekonomisë botërore, veçanërisht të Eurozonës, që mund të ndikojnë negativisht në investime dhe tregti me vendet e tjera. Luhatjet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, të shkaktuara nga këto tensione, rrisin pasiguritë rreth inflacionit dhe normave të interesit, duke ndikuar në besimin e konsumatorëve dhe investitorëve, çka mund të sjellë ngadalësim të aktivitetit ekonomik. Në situatë të tillë kur mund të kishte ngadalësim ekonomik në Eurozonë me pasoja në të ardhurat nga diaspora, së bashku me tensionet gjeopolitike dhe ndikimet në tregti dhe investime, përbëjnë sfida të rëndësishme për ekonominë e Kosovës.

Kutia 2. Pasqyrë e Sektorëve të Aktiviteteve me Pasuri të Paluajtshme dhe Ndërtimtarisë


Sektorët e aktiviteteve me pasuri të paluajtshme dhe ndërtimtarisë kanë tërhequr vëmendje të shtuar viteve të fundit, për shkak të luhatjeve të çmimeve të pasurive të paluajtshme në nivel global. Ndërlidhja e këtyre sektorëve me sistemin financiar i bën ata thelbësisht të rëndësishëm për stabilitetin makro-financiar. Për më shumë, natyra prociklike e këtyre sektorëve mund të amplifikojë luhatjet në ciklin ekonomik dhe financiar. Në këtë kontekst, një korrigjim i mundshëm i çmimeve të paluajtshmërive mund të ndikojë në sektorin bankar për shkak të ekspozimit ndaj këtyre sektorëve, duke ndikuar në performancën e portfoliove kreditore dhe vlerën e kolateralit, megjithë politikat prudente që bankat kanë dhe kërkesave të larta të kolateralit. Prandaj, është e nevojshme të vazhdojnë të monitorohen këta sektorë për të shmangur rreziqet dhe për të forcuar stabilitetin financiar për të përballuar me sukses goditjet potenciale.

Sektori i ndërtimit dhe ai i pasurive të paluajtshme përbëjnë rreth 15 përqind të bruto produktit vendor (BPV) dhe rreth 44 përqind të gjithsej investimeve në Kosovë, sipas të dhënave të ASK-së për dhjetë vitet e fundit. Në terma nominalë, bruto vlera e shtuar në këta sektorë arriti në 1.4 miliardë euro në vitin 2023. Për më shumë, sektori i ndërtimit dhe ai i paluajtshmërive janë ndër sektorët me numrin më të madh të të punësuarve në vend, me rreth 12 përqind të gjithsej të punësuarve në vitin 2023. Këta sektorë janë të ndërlidhur gjithashtu me sektorin e jashtëm, me 511.2 milionë euro investime të huaja direkte (IHD) në paluajtshmëri në vitin 2023, që financojnë një pjesë të aktivitetit ekonomik në ndërtim dhe afarizëm me paluajtshmëri.

Aktiviteti ekonomik në sektorin e ndërtimit dhe atë të paluajtshmërive ka shënuar rritjenë 10-të vitet e fundit, me normë mesatare të rritjes reale prej 2.2 përqind, me

përjashtim të viteve 2014, 2020 dhe 2022 (Grafik 1).

Grafik 1. Sektorët e ndërtimit dhe afarizmit me paluajtshmëri, rritja ekonomike dhe BPV



Burimi: BQK.

Kjo rritje u mbështet kryesisht nga kërkesa e qëndrueshme për paluajtshmëri. Një ndër faktorët më të rëndësishëm që kontribuan në këtë rritje janë ndryshimet socio-demografike në vend. Sipas të dhënave preliminare nga Regjistrimi i Popullsisë, në vitin 2024 u evidentua rritje e numrit të ekonomive familjare dhe rënie e numrit mesatar të personave për ekonomi familjare, që rezultoi në 4.5 në vitin 2024, kundrejt 6 në vitin 2011 (ASK, 2024). Për më shumë, si pasojë e mundësive të kufizuara për investime nga ekonomitë familjare, blerja e paluajtshmërive shihet si një ndër format më të përshtatshme të investimit. Kërkesa për paluajtshmëri gjithashtu mbështetet nga IHD-të, kryesisht nga diaspora, që shënuan rritje mesatare prej 41.8 përqind gjatë periudhës 2021-2023.


Dinamikat në këta sektorë janë reflektuar gjithashtu në treguesit e ofertës për paluajtshmëri. Sipas të dhënave të Komunës së Prishtinës, sipërfaqja e aprovuar për ndërtim arriti pikun në vitin 2021, ndikuar dukshëm edhe nga rihapja e ekonomisë pas pandemisë dhe vazhdimi i projekteve të ndërprera. Mirëpo, rritja e evidentuar në indeksin e kostos së ndërtimit (IKN) nga 12.1 përqind në 2021 në 20.1 përqind në vitin 2022 ndikoi në rënie të aktivitetit në ndërtim prej 3.1 përqind në vitin 2022. Në anën tjetër, sektori i paluajtshmërive shënoi rritje të

përshpejtuar prej 4.1 përqind në këtë periudhë, mbështetur nga rritja e IHD-ve në paluajtshmëri prej 37.9 përqind.

Kurse, në vitin 2023, përderisa aktiviteti ekonomik në ndërtimtari u rimëkëmb duke shënuar rritje prej 2.7 përqind, afarizmi me paluajtshmëri u ngadalësua dukshëm, ndikuar kryesisht nga rënia e IHD-ve në paluajtshmëri prej 3.4 përqind.

Kreditë bankare kanë luajtur rol të rëndësishëm në mbështetje të kërkesës për financim në sektorin e ndërtimit dhe për blerje të pasurive të paluajtshme përgjatë viteve. Në vitin 2023, si rezultat i projekteve ndërtimore dhe investimeve në infrastrukturë, kreditë për sektorin e ndërtimit shënuan rritje prej 15.9 përqind, ndërsa kreditë për sektorin e afarizmit me paluajtshmëri shënuan rritje prej 13.5 përqind, edhe pse normat e interesit shënuan rritje. Kjo rritje në sektorin e paluajtshmerive reflekton kërkesën e lartë për investime në këtë fushë. Njëkohësisht, përmirësimi i cilësisë së kredive dhe menaxhimi më i mirë i riskut kanë kontribuar në uljen e kredive jo performuese (KJP) në sektorin e ndërtimit, që ka arritur në 2.9 të gjithsej kredive për këtë sektor, ndërsa në sektorin e paluajtshmerive niveli i KJP-ve ishte 2.1 përqind (Grafik 2).

Grafik 2. Kreditë dhe KJP-të në sektorët e ndërtimit dhe afarizmit me paluajtshmëri



Burimi: BQK.


Përkunder nivelit të ulët të KJP-ve, mbulueshmëria e tyre me provizione është përmirësuar në të dy sektorët. Sektori i ndërtimit ka arritur një mbulueshmëri prej

152.8 përqind, ndërsa në sektorin e afarizmit me paluajtshmëri mbulueshmëria ishte 87.0 përqind. Kolaterali është rritur gjithashtu, me një rritje prej 21.0 përqind për sektorin e ndërtimit dhe 17.7 përqind për sektorin e paluajtshmerive. Mbuleshmëria e kredive në sektorin e ndërtimit me kolateral ishte 102.6 përqind në vitin 2023, që do të thotë se kolaterali mbulon më shumë se kreditë e ofruara për këtë sektor, ndërsa në sektorin e afarizmit me paluajtshmëri, kolaterali ishte 90.3 përqind, duke siguruar një mbulim të mirë ndaj kredive të ofruara. Në anën tjetër, stoku i kredive të ekonomive familjare, ku përfshihen kreditë hipotekare, arriti në 1.91 miliardë euro në fund të vitit 2023 duke shënuar rritje vjetore prej 17.3 përqind. Kurse, norma e KJP-ve të këtij segmenti mbeti e ulët me 1.4 përqind.

Rritja e kredive dhe përmirësimi i cilësisë së kredive në sektorët e ndërtimit dhe afarizmit me paluajtshmëri janë tregues pozitivë për stabilitetin financiar. Megjithatë, është e rëndësishme të vazhdohet monitorimi i kredive jo performuese, mbulueshmërisë së tyre, si dhe performancës së këtyre sektorëve për të menaxhuar rrezikun dhe për të ruajtur stabilitetin financiar. Instrumentet e përdorura nga bankat për të minimizuar goditjet nga rivlerësimi i çmimeve të paluajtshmerive si kolateral, mund të përfshijnë masa të bazuara në kredimarrës dhe/apo në kapital të bankave. Për të shmangur rreziqet nga kreditë e reja, kur është e nevojshme bankat mund të vendosin kufizime mbi vlerën e kredisë për blerje të patundshmërisë varësisht nga vlera e kolateralit (raporti kredi-vlerë), bazuar në raportin e borxhit ndaj të hyrave për huamarrës, dhe gjithashtu sipas tipareve të kredi marrësve në përpjekje për të ulur koston sociale dhe për të siguruar parandalimin e kreditimit të lartë në të ardhmen. Kjo megjithatë, nuk ka indikacione se mund të ndodh. Në anën tjetër, bankat kanë mundësi të minimizojnë rrezikun e humbjeve edhe në kreditë ekzistuese duke dedikuar kapital shtesë mbi kapitalin e kërkuar kur ekzistojnë shqetësime të bazuara rreth akumulimit të rreziqeve në këta sektorë me pasoja potenciale në kapacitetin ripagues.

Inflacioni në Kosovë u ngadalësua përgjatë vitit 2023, me normën mesatare vjetore që rezultoi 4.9 përqind, kundrejt 11.6 përqind në vitin paraprak (Grafik 7). Ky ngadalësim i atribuohet kryesisht ngadalësimit të çmimeve të ushqimit, falë përmirësimit të zinxhirëve global të furnizimit dhe rënies së çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare. Sa u përket shërbimeve, çmimet e shërbimeve të transportit dhe ato hoteliere, u ngadalësuan si pasojë e zbehjes së kërkesës së brendshme nga rënia e fuqisë blerëse të konsumatorëve. Kurse, presionet inflacioniste vazhduan të jenë të pranishme në çmimet e mallrave tjera, përfshirë veshmbathjen, duhanin dhe alkoolin.

Grafik 7. Inflacioni sipas kontributit të kategorive kryesore




Burimi: ASK (2024) dhe kalkulimet e BQK-së.

Stabilizimi i çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare kontribuoi në rënien e inflacionit të importuar, i cili kishte një kontribut prej 4.1 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm. Kurse, rënia e inflacionit të brendshëm në 0.8 pikë përqindje ishte kryesisht rezultat i ngadalësimit të çmimeve të shërbimeve hoteliere dhe energjisë elektrike si rezultat i një sërë faktorësh, përfshirë efektin e bazës, ecurinë e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare, kushtet më të lehta klimatike, si dhe masat për eficiencë të energjisë.

Ngadalësimi i inflacionit të përgjithshëm u evidentua edhe në ngushtimin e bazës së artikujve në shportën e konsumit me rritje vjetore të çmimeve mbi 3.0 përqind, që rezultoi në peshë mesatare vjetore prej 66.4 përqind të shportës së konsumit në vitin 2023, nga 75.5 përqind në vitin paraprak (Grafik 8).

Grafik 8. Peshë e artikujve në shportën e konsumit sipas normës së rritjes së çmimeve



Burimi: ASK (2024) dhe kalkulimet e BQK-së.

Zbutja e presioneve inflacioniste përgjatë vitit 2023 u evidentua edhe në inflacionin bazë, që rezultoi në normë mesatare vjetore prej 4.4 përqind, kundrejt 4.9 përqind në vitin paraprak. Rënia e inflacionit bazë u mbështet kryesisht nga ngadalësimi i çmimeve të shërbimeve të transportit dhe atyre hoteliere. Sidoqoftë, ritmi i rënies së inflacionit bazë mbeti më i ngadalshëm sesa ai i inflacionit të përgjithshëm.

Sipas parashikimeve të BQK-së, shkalla mesatare e inflacionit në vitin 2024 pritet të ngadalësohet në 1.6 përqind. Faktorët që pritet të kontribuojnë në këtë ngadalësim përfshijnë stabilizimin e çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare, trendin rënës të inflacionit në eurozonë, ndikimin e shtrëngimit të kushteve të financimit në aktivitet ekonomik, e të tjera. Projektionet për inflacionin shoqërohen nga rreziqe potenciale që anojnë nga kahu i lartë, duke përfshirë mundësinë e pengesave të reja në zinxhirët e furnizimit në rast të përshkallëzimit të tensioneve gjeopolitikeveçanërisht në Lindjen e Mesme, reduktimin e sasisë së prodhimit të naftës nga vendet eksportuese, zhvendosjen e pritjeve të konsumatorëve për inflacionin, dinamikat në tregun e punës në vend, e të tjera.

Sektori fiskal gjatë vitit 2023 u karakterizua me rritje të të hyrave buxhetore për 14.4 përqind dhe rritje të shpenzimeve buxhetore për 13.1 përqind. Rritja e të hyrave buxhetore ishte rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik, përpjekjeve për formalizimin e ekonomisë dhe normës së lartë të inflacionit. Si rezultat i kësaj rritje më të lartë të të hyrave buxhetore dhe performancës së përgjithshme fiskale, është shënuar bilanc

primar buxhetor pozitiv prej 0.2 përqind të BPV-së, kundrejt bilancit primar buxhetor negativ prej -0.2 përqind të BPV-së në vitin paraprak.

Borxhi publik si përqindje e BPV-së ra në 17.5 përqind, nga 20.0 përqind sa ishte në vitin 2022. Kjo ulje erdhi si rezultat i përmirësimit të bilancit buxhetor të qeverisë dhe rritjes së BPV-së nominale, duke ulur kështu raportin e borxhit ndaj BPV-së. Vlera nominale e borxhit publik arriti në 1.66 miliardë euro, që është për 5.1 përqind më e ulët krahasuar me vitin 2022. Rënia e borxhit publik i atribuohet uljes së borxhit të brendshëm publik për 12.8 përqind, duke arritur në 970.2 milionë euro. Në anën tjetër, borxhi i jashtëm publik shënoi rritje prej 8.1 përqind, duke arritur në 692.9 milionë euro ose 41.7 përqind të gjithsej borxhit publik.

Në përgjithësi, performanca fiskale gjatë vitit 2023 tregon për një menaxhim të kujdesshëm të financave publike, me fokus në rritjen e të ardhurave dhe kontrollin e shpenzimeve, gjë që ka ndihmuar në uljen e borxhit publik dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë fiskale të vendit. Kjo u evidentua gjithashtu gjerësisht edhe në Rangimin kreditor sovran që mori Republika e Kosovës.

Në vitin 2023, bilanci i pagesave shënoi përmirësim të deficitit në llogarinë rrjedhëse dhe financiare, ndërsa shënoi rritje të bilancit pozitiv të llogarisë kapitale. Deficiti i llogarisë rrjedhëse u ul për 20.5 përqind duke arritur në 729.4 milionë euro, ose 7.5 përqind e BPV-së (10.3 përqind e BPV-së në vitin 2022). Ky përmirësim u ndikua nga rritja prej 18.7 përqind e bilancit pozitiv të shërbimeve, si dhe nga rritja e të ardhurave parësore dhe dytësore me 72.2 përkatësisht 8.5 përqind krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa, rritja e deficitit tregtar të mallrave prej 7.3 përqind kishte ndikim negativ.

Eksporti i mallrave arriti vlerën prej 863.1 milionë euro, ose 8.9 përqind e BPV-së, duke shënuar rënie vjetore prej 6.2 përqind. Kjo rënie u ndikua kryesisht nga rënia e eksportit të produkteve minerale prej 52.5 përqind (54.5 milionë euro më pak kundrejt vitit paraprak), si pasojë e dobësimit

të kërkesës së jashtme dhe dinamikave të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Poashtu, artikujt tjerë të prodhuar shënuan rënie vjetore prej 24.9 përqind. Partnerët kryesorë për eksport të mallrave ishin vendet e Ballkanit Perëndimor, me 39.8 përqind, dhe vendet e BE-së, me 32.3 përqind të gjithsej eksportit. Për shkak të varësisë së Kosovës nga një numër i kufizuar i produkteve të eksportuara, eksporti i mallrave është më i ekspozuar ndaj goditjeve të jashtme si ngadalësimi i aktiviteti ekonomik global dhe tensionet gjeopolitike. Diversifikimi i eksportit mund të përmirësoj elasticitetin dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë ndaj këtyre dinamikave.

Importi i mallrave në vitin 2023 arriti vlerën prej 5.9 miliardë euro, ose 61.1 përqind e BPV-së, duke shënuar rritje vjetore prej 4.9 përqind. Rritja e importit i atribuohet dinamikave të çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe rritjes së kërkesës brenda vendit, ku sasia dhe pesha e mallrave të importuara shënuan rritje për 11.6 përkatësisht 8.3 përqind. Importi i mallrave u dominua nga produktet minerale, artikujt ushqimorë dhe makineritë përfshirë pajisjet shtëpiake. Mallrat e ndërmjetme kishin pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej mallrat e importuara me 46.4 përqind, ndjekur nga mallrat konsumuese me 32.5 përqind dhe mallrat kapitale me 10.3 përqind. Shtetet e BE-së përbënin 43.0 përqind të gjithsej mallrave të importuara, 15.7 përqind vendet e rajonit dhe 14.8 përqind Turqia.

Shërbimet vazhduan të kontribuojnë pozitivisht në llogarinë rrjedhëse, duke arritur vlerën prej 1.6 miliardë euro (16.8 përqind e BPV-së). Eksporti i shërbimeve shënoi rritje për 18.4 përqind, duke arritur vlerën prej 3.0 miliardë euro, me kontributin kryesor nga shërbimet e udhëtimit dhe shërbimet kompjuterike, përfshirë telekomunikacionin. Eksporti i shërbimeve të udhëtimit (me rritje vjetore prej 17.7 përqind) u rrit për shkak të rritjes së numrit të udhëtarëve, ndërsa shërbimet kompjuterike shënuan rritje prej 36.1 përqind, mbështetur nga rritja e kërkesës së jashtme. Në anën tjetër, importi i shërbimeve shënoi rritje

vjetore prej 18.2 përqind dhe arriti vlerën prej 1.3 miliardë euro, kryesisht nga shërbimet e udhëtimit, të cilat shënuan rritje vjetore prej 39.2 përqind e që përbënin rreth 46.8 përqind të gjithë importit të shërbimeve.

Bilanci i të ardhurave parësore arriti vlerën prej 198.9 milionë euro, me rritje vjetore prej 72.2 përqind. Dinamikat e të ardhurave parësore u ndikua kryesisht nga kompensimi i punëtorëve, bilanci i të cilave arriti vlerën prej 338.1 milionë euro, me rritje vjetore prej 18.0 përqind. Në anën tjetër, të ardhurat nga investimet shënuan bilanc negativ prej 140.0 milionë euro, kryesisht për shkak të fitimit të ri-investuar nga investimet e huaja direkte.

Vlera e remitencave të pranuar në vitin 2023 arriti në 1.3 miliardë euro (13.8 përqind e BPV-së), duke shënuar rritje vjetore prej 9.2 përqind. Shtetet kryesore prej nga vinin remitencat mbetën të pandryshuara, Gjermania me 38.2 përqind, Zvicra me 18.8 përqind dhe SHBA me 7.3 përqind të gjithë remitencave. Dërgesat e remitencave përmes kanaleve formale (bankat dhe institucione tjerat) shënuan rritje prej 6.6 përqind, ndërsa kanalet joformale shënuan rritje prej 16.9 përqind. Rritja e vizitave të kosovarëve në diasporë pas liberalizimit të vizave mund të ndikoi në rritjen edhe më të lartë të remitencave përmes kanaleve joformale.


Investimet e huaja direkte shënuan rritje vjetore prej 14.8 përqind dhe arritën vlerën prej 840.1 milionë euro (8.7 përqind e BPV-së). Sektori i patundshmërisë vazhdon të ketë pjesëmarrjen më të lartë me 61.2 përqind të gjithë IHD-ve, ndjekur nga sektori financiar përfshirë sigurimet me 21.3 përqind dhe furnizimi me energji elektrike me 6.2 përqind. Në anën tjetër, investimet direkte të rezidentëve nga Kosova në vendet tjera shënuan rritje prej 8.5 përqind, duke arritur vlerën prej 190.0 milionë euro (175.2 milionë euro në vitin 2022). Rreth 82.0 përqind janë investime në sektorin e patundshmërisë dhe të destinuar kryesisht në vendet e rajonit. Mirëpo, në vitet e fundit është shënuar rritje e investimeve direkte me origjinë nga Kosova

edhe në vendet e BE-së, veçanërisht në Gjermani, të cilat arritën vlerën prej 17.8 milionë euro, me 9.1 përqind rritje vjetore. Rritja e vazhdueshme e investimeve direkte jashtë vendit (mesatarisht 36.9 përqind rritje për periudhën 2019-2023) mund të ndikoi në rënien e investime private në vend, kryesisht në sektorin e patundshmërisë.

3.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve

Treguesit ekonomik dhe financiarë të ndërmarrjeve paraqesin një pasqyrë pozitive të rritjes ekonomike për vitin 2023, duke reflektuar përmirësimin e pozicionit financiar të sektorit të biznesit. Rritja e qarkullimit në sektorin e tregtisë prej 10.6 përqind, edhe pse më e ngadalësuar krahasuar me rritjen prej 21.4 përqind në vitin 2022, tregon për rritje të konsumit, si një tregues i rëndësishëm i rritjes ekonomike. Po ashtu, vlera e shtuar në këtë sektor shënoi rritje prej 6.9 përqind, duke e konsoliduar pozicionin e sektorit të tregtisë në ekonominë e përgjithshme. Në sektorin e industrisë përpunuese, qarkullimi shënoi rritje prej 8.7 përqind, ndërsa vlera e shtuar në këtë sektor gjithashtu shënoi rritje prej 7.0 përqind, duke sugjeruar përmirësim të kapaciteteve prodhuese dhe rritje të kërkesës për produkte të përpunuara.

Grafik 9. Ndryshimi vjetor në numrin e ndërmarrjeve të reja




Burimi: ASK.

Iniciativa ndërmarrëse ka shënuar gjithashtu rritje prej 3.6 përqind, me 11,422 ndërmarrje të reja të regjistruara, duke treguar një klimë pozitive për krijimin e bizneseve. Kjo rritje është një shenjë besimi në perspektivën e ekonomisë, ndërsa mbyllja e 1,617 ndërmarrjeve, që është për 9.4 përqind më pak

krahasuar me vitin paraprak, sugjeron për një stabilizim të aktivitetit ekonomik (Grafik 9).

Borxhi i ndërmarrjeve ndaj institucioneve financiare vendore dhe të jashtme ka vazhduar të rritet, por me një normë më të ulët krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2023, borxhi i ndërmarrjeve shënoi rritje vjetore prej 9.8 përqind (Grafik 10), duke arritur në 44.9 përqind të BPV-së.

Grafik 10. Borxhi i ndërmarrjeve



Burimi: BQK.


Borxhi i brendshëm i ndërmarrjeve ndaj institucioneve financiare është rritur për 10.7 përqind, duke reflektuar rritje prej 9.8 përqind në kreditë bankare dhe rritje prej 34.9 përqind në kreditë e lëshuara nga ndërmjetësit tjerë financiarë, të cilat kanë peshë më të vogël (4.5 përqind) në gjithsej borxhin e ndërmarrjeve ndaj sektorit financiar. Kryesisht si rezultat i rritjes së kredive tregtare, borxhi i jashtëm i ndërmarrjeve ka shënuar rritje prej 7.1 përqind dhe ka arritur në 28.6 përqind të gjithsej borxhit. **Rritja e kreditimit të ndërmarrjeve nga sektori bankar ka kontribuar në rritjen shkallës së ndërmjetësimit financiar, me raportin e kredive ndaj BPV-së që arriti në 32.1 përqind, nga 31.5 përqind në vitin 2022.** Kjo rritje ka rezultuar në një hendek pozitiv të kredisë ndaj BPV-së.⁴

Pozicioni neto debitor i ndërmarrjeve ndaj sektorit bankar shënoi rritje prej 9.4 përqind në vitin 2023, krahasuar me rritjen prej 14.9 përqind në vitin 2022. Depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 12.6 përqind, ndërsa kreditimi për sektorin e ndërmarrjeve shënoi rritje për 10.7 përqind.

Përkundër rritjes më të lartë të depozitave, volumi shumë më i madh i kredive për ndërmarrjet ka ndikuar në rritjen e pozicionit debitor të tyre ndaj sektorit bankar. Në valutë të huaj, sektori i ndërmarrjeve ka pozicion neto kreditor ndaj sektorit bankar për shkak të nivelit më të lartë të depozitave në valutë të huaj krahasuar me kreditë. Megjithatë, pozicioni në valutë të huaj mbetet i ulët, pasi pjesëmarrja e depozitave në valutë të huaj ndaj gjithsej depozitave ishte 3.0 përqind, ndërsa kreditë në valutë të huaj përbëjnë vetëm 0.4 përqind të gjithsej kredive.

Kostoja e huamarrjes për ndërmarrjet ka shënuar rritje të lehtë, duke arritur në mesatarisht 6.7 përqind, kryesisht si rezultat i shtrëngimeve në politikën monetare të BQE-së. Kjo rritje në normat e interesit mund të ketë ndikim negativ në vendimet e ndërmarrjeve për investime, duke e bërë më të kushtueshme huamarrjen për projekte të reja. Gjithashtu, norma mesatare e interesit në depozitat e afatizuara dhe ato të kursimit ka shënuar rritje (Grafik 11).

Grafik 11. Normat e interesit për ndërmarrjet




Burimi: BQK.

3.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare

Borxhi i ekonomive familjare është rritur më shpejt krahasuar me borxhin e ndërmarrjeve, duke arritur në 22.6 përqind të BPV-së në vitin 2023, me një rritje prej gati 18.0 përqind. Borxhi i brendshëm ndaj sektorit bankar dhe institucioneve mikrofinanciare shënoi rritje prej 17.2 përkatësisht 21.3 përqind, ndërsa borxhi i jashtëm, i cili përbën 2.4 përqind të totalit, shënoi rritje prej 37.0 përqind (Grafik 12).

⁴ Hendeku i kreditimit i kalkuluar me filterin Hodrick- Prescott.


Grafik 12. Borxhi i ekonomive familjare



Burimi: BQK.

Kreditë e reja për ekonomitë familjare, sidomos ato konsumuese/personale apo individuale, shënuan rritje të përshpejtuar prej 23.2 përqind dhe përbëjnë 67.5 përqind të kredive të reja për këtë sektor. Ndërkohë, kreditë hipotekare dhe ato investuese shënuan rënie për 11.3 përkatësisht 60.6 përqind (Grafik 13). Megjithatë, të dhënat tregojnë për rritje të një kategorie të kredive të natyrës investuese (jo-konsumuese) me një rang prej mbi 20 mijë euro (rreth 75% e tyre) por që nuk janë klasifikuar si hipotekare në kuptim të definicionit me rregullativë. Kjo megjithatë ka ndikuar pozitivisht në plotësim të hendekut të normës së ndërmjetësimit financiar tek individët.

Grafik 13. Depozitat e ekonomive familjare



Burimi: BQK.

Pozicioni kreditor i ekonomive familjare u përmirësua për shkak të rritjes së depozitave, që arritën vlerën prej 4.1 miliardë euro, me një rritje vjetore prej 11.4 përqind (Grafik 13).


Tabela 2. Borxhi ndaj bankave dhe performanca e ekonomive familjare

Përshkrimi	2020	2021	2022	2023
Borxhi i ekonomive familjare ndaj bankave (në milionë)	1,182.2	1,401.2	1,634.1	1,915.2
prej të cilave në valutë të huaj (në milionë)	2.3	2.2	1.7	1.3
Depozitat e ekonomive familjare në banka (në milionë)	2,937.1	3,366.1	3,643.5	4,060.5
prej të cilave në valutë të huaj (në milionë)	155.4	176.1	115.1	155.7
Neto pozicioni ndaj bankave (Pozicioni kreditor) në milionë	1,754.9	1,964.9	2,009.4	2,145.3
Mesatarja e vlerës së kredisë për të punësuar	3,406.3	3,655.7	4,046.6	4,432.9
Shkalla e varësisë ekonomike	275.0%	248.0%	230.0%	211.0%

Burimi: BQK.

Rritja e normave të interesit në depozitat e afatizuara ka nxitur rritjen e depozitave të afatizuara me 22.4 përqind, ndërsa ato të kursimit shënuan rënie prej 3.4 përqind. Kostoja e borxhit të ri për ekonomitë familjare shënoi rritje të lehtë, e cila është ndikuar nga rritja e normave të interesit në tregjet ndërkombëtare. Norma mesatare e interesit për kreditë e reja konsumuese arriti në 6.4 përqind, ndërsa ajo për kreditë hipotekare arriti në 5.3 përqind (Grafik 14).

Grafik 14. Normat e interesit për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Burimet e të ardhurave të ekonomive familjare treguan tendencë rritëse, me pagat që u rritën, remitentat që u rritën për 9.2 përqind ndërsa kompensimi i punëtorëve⁵ që shënoi rritje vjetore prej 13.7 përqind. Në tregun e punës, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore arriti në 40.7 përqind, që është 2.1 pikë përqindje më e lartë krahasuar me vitin 2022.

Shkalla e punësimit është rritur në 36.3 përqind, që është për 2.5 pikë përqindje më e lartë krahasuar me vitin 2022. Treguesi i varësisë ekonomike, që paraqet raportin ndërmjet popullsisë së përgjithshme joaktive (mbi 15 vjeç) dhe punësimit, është zvogëluar në 211 përqind nga 230 përqind sa ishte në vitin 2022. Në anën tjetër, shkalla e papunësisë u zvogëluar në 10.9 përqind, që është 1.7 pikë përqindje më e ulët krahasuar me vitin 2022.

⁵ Të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve - të ardhurat e punëtorëve sezonal jashtë vendit si dhe punëtorëve kosovarë jashtë kufirit për një periudhë më pak se një vit.

Kutia 3. Ngarkesa me Borxh e huamarrësëve Individual në Kosovë

Ngarkesa e borxhit për huamarrësit në Kosovë është vlerësuar duke u bazuar në popullacionin e përgjithshëm të klientëve individualë nga të gjitha institucionet bankare dhe mikrofinanciare në vend, përkatësisht huamarrësit me kredi aktive të raportuara në Regjistrin e Kredive të Kosovës (RKK) deri në fund të dhjetorit 2023. Popullacioni i përgjithshëm përfshin 346,490 klientë individualë me gjithsej 603,141 kredi aktive⁶.

Metodologjia e vlerësimit të ngarkesës është e njëjta me metodologjinë e përdorur në studimet

paraprake.⁷ Janë përdorur disa tregues të ndryshëm që vlerësojnë aspekte specifike të ngarkesës së borxhit. Këta tregues, të cilët respektojnë shumicën e parimeve të përmendura në studime të ndryshme të problematikës së ngarkesës me borxh: pjesëmarrjen e borxhit në raport me të ardhurat, vonesat në pagesë si dhe përdorimin e shpeshtë të kredive dhe perceptimi subjektiv i borxhit si një barrë e rëndë, përmes (tabela 1).

Tabela 1. Rezultatet e treguesve objektiv të ngarkesës me borxh

Kategoria	Treguesi	Vlerësimi/Treguesi	Rezultati
Kosto e servimit të borxhit: Borxhi ndaj të hyrave	Huamarrësit që shpenzojnë më shumë se 50% të hyrave bruto mujore në pagesën e borxhit (të siguruar dhe të pasiguruar)	<i>Indeksi i Ngarkesës me Borxh (shuma e kësteve mujore të të gjitha produkteve kreditore =>50% e të hyrave mujore të huamarrësit); (i kalkuluar për 270,597 huamarrës)</i>	28.1% e huamarrësve shfrytëzojnë mbi 50% të të hyrave në pagesën e kësteve kreditore
		<i>Indeksi i Ngarkesës me Borxh të Huave (shuma e kësteve mujore të huave aktive =>50% e të hyrave mujore të huamarrësit); (i kalkuluar për 213,534 huamarrës)</i>	25.9% e huamarrësve me hua aktive shfrytëzojnë mbi 50% të të hyrave në pagesën e kësteve kreditore vetëm për hua
Vonesat	Huamarrësit me vonesa më shumë se 2 muaj në pagesën e kontratave kreditore	<i>Huamarrësit me vonesa më shumë se 60 ditë (gjithsej 346,490 huamarrës)</i>	12.2% e huamarrësve kanë vonesa më shumë se 2 muaj në pagesën e kësteve kreditore. Ndërsa nga 193,034 huamarrës që kanë vetëm nga një kontratë kreditore 14.1% e tyre (apo 7.8% e gjithsej popullacionit të huamarrësve) janë në vonesë mbi 2 muaj .
Numri i kontratave kreditore	Ekonomitë familjare =>4 kontrata aktive kreditore	<i>Huamarrësit =>4 kontrata aktive kreditore (gjithsej 346,490 huamarrës)</i>	6.4% e huamarrësve kanë 4 apo më shumë se 4 kontrata aktive kreditore

Burimi: BQK.

Treguesi kyç për vlerësimin e ngarkesës me borxh “Indeksi i ngarkesës me borxh” të huamarrësve është përlogaritur si raport i shumës së kësteve mujore ndaj të hyrave mujore,⁸. Nivelet e ngarkesës janë klasifikuar në katër kategori bazuar në vlerën e indeksit:

- 1) Të pangarkuar (indeksi < 0.50): Shpenzime për këstet mujore më pak se 50% e të hyrave mujore.
- 2) Në rrezik (indeksi 0.50 – 0.75): Shpenzime për këstet mujore në shkallë 50-75% e të hyrave mujore.
- 3) Në fazë kritike (indeksi 0.75 – 1.0): Shpenzime për këste mujore në shkallë 75-100% e të hyrave mujore.
- 4) Jo-solvent (indeksi > 1.0): Shpenzime për këste mujore që tejkalojnë 100% e të hyrave mujore.

Për matjen sa më reale të nivelit të ngarkesës, paraprakisht janë bërë trajtimet e nevojshme në të dhënat për të hyrat si dhe këstet mujore. **Në rastin e të hyrave mujore** të huamarrësit, janë marrë për bazë të hyrat e fundit, përkatësisht të hyrat që janë raportuar në kredinë e fundit të lëshuar për huamarrësin përkatës. Në rastet kur ky informacion ka munguar, është konsideruar mesatarja e të hyrave të raportuara në të gjitha observimet (kreditë aktive). Mirëpo kishte raste që vlera e të hyrave të raportuara në kredinë e fundit të devijonte negativisht prej mesatares së të hyrave për klientin e njëjtë, si dhe raste kur këstet mujore tejkalonin dukshëm të hyrat e fundit të raportuara, të cilat nga një mostër e vlerësimit është vërejtur se kanë të bëjnë me kredi të lëshuara për sektorin e agrokulturës⁹, apo kredi të lëshuara tek profesionet si menaxher/pronar/drejtor etj., të cilët përveç të hyrave si individ, kanë edhe të hyra nga

⁶ Karakteristikat socio-demografike dhe socio-ekonomike janë të prezantuara në tabelën 3.

⁷ NGARKESA ME BORXH E KLIENTËVE BANKARË NË KOSOVË | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (bqk-kos.org) si dhe kutia ne FSR nr.19

⁸ NGARKESA ME BORXH E KLIENTËVE BANKARË NË KOSOVË | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (bqk-kos.org) si dhe kutia ne FSR nr.19

⁹ Kreditë për agro-kulturë në shumicën e rasteve kanë frekuencë jo të rregullt të pagesës, përkatësisht këste të larta të ndara në periudha më të rralla kohore.

bizneset individuale. Për të eliminuar këto raste kur devijimi i vlerës së fundit të raportuar të të hyrave dhe atyre mesatare për klientin e njejtë ishte negativ dhe shuma e kësteve tejkalonte dukshëm vlerën e të hyrave të fundit (ngase mund të rezultojnë me mbivlerësim të ngarkueshmërisë), atëherë janë marrë për bazë të hyrat maksimale, nën supozimin që ato paraqesin të hyrat më reale të huamarrësit (konsideruar që klientët e tillë kanë edhe të hyra që realizohen nga biznesi por që nuk janë raportuar në kredinë e fundit). Nga i gjithë popullacioni i klientëve me kredi aktive, pjesëmarrja e rasteve me mungesë të informacionit mbi të hyrat e fundit të raportuara ishte 17.2 përqind, ndërsa me përfshirjen e të hyrave mesatare apo maksimale aty ku mungonte informacioni (përkritazi me llojet e rasteve të elaboruara më lartë), pjesëmarrja e rasteve me mungesë të informacionit mbi të hyrat zbritet në 13.3 përqind.

Mungesa e informacionit mbi këstet kreditore është trajtuar specifikisht sipas produkteve kreditore. Në grupin e **produkteve kreditore hua (hua, lizing dhe kredi hipotekare)**, kësti mujor ka munguar në 4,764 raste (1.6 përqind e gjithësej portfolios së kredive hua). Për këto raste janë bërë kalkulimet përkritazi me informacionet në dispozicion për normat efektive të interesit. Mirëpo në disa prej observimeve, norma e interesit dukej të ishte e pasaktë prandaj, për të eliminuar rrezikun e mbingarkesës, në këto observime si dhe aty ku informacioni mbi normën e interesit mungonte në tërësi, kalkulimi i këstit është bazuar në normën mesatare të interesit në kreditë e ekonomive familjare, që korrespondon me llojin e kredisë, me vitin e disbursimit të asaj kredie, si dhe llojin e institucionit huadhënës (bankar ose mikrofinanciar). Për **produktin kreditor mbitërheqje**, kalkulimi i kësteve kreditore në observimet ku mungonte informacioni (në 36.5 përqind të rasteve me bilanc të shfrytëzuar të mbitërheqjeve), është realizuar duke aplikuar normën mesatare të interesit për mbitërheqje. Ndërsa për ato observime ku maturiteti i mbetur ishte më i ulët se një muaj nga data efektive dhjetor 2023 është trajtuar ashtu që e gjithë vlera e mbetur (outstanding) të konsiderohet si këst. Kjo megjithatë, paraqet qasje shumë konservatore dhe mund të kete ndikuar në rritje të këtij raporti,

përtej atij real (pra këstit mujor që paguhet çdo muaj). Për **produktin kreditor kreditkartelë**, mungesat e informacionit mbi këstet në 66.6 përqind të rasteve me bilanc të shfrytëzuar, janë trajtuar si në vijim: për kontratat kreditore të cilat nuk kishin vonesa në pagesë, si këst është konsideruar 15 përqind e shumës së borxhit, që përfaqëson nivelin minimal që një përdorues i kreditkartelës duhet ta paguaj në muajin vijues. Në rastet kur kishte vonesa në pagesë të këstit më shumë se 30 ditë dhe kur norma efektive e interesit ishte në dispozicion, atëherë janë kalkuluar këstet bazuar në shumën e mbetur borxh, ndërsa në rastet kur informacioni mbi normën efektive nuk posedohej, atëherë është konsideruar norma mesatare e interesit në të gjitha kreditkartelat e popullacionit në analizë. Me trajtimet përkatëse, informacioni mbi këstet kreditore ishte i disponueshëm për 88.5 përqind të huamarrësve, ndërsa në 11.5 përqind të rasteve, kësti ishte i barabartë me zero që reflekton bilancet e pashfrytëzuara të produktete kreditore si kreditkartelat dhe mbitërheqjet.


Si pasojë e mungesës së informacioneve rreth të hyrave të huamarrësve dhe vlerës zero të kësteve kreditore në disa observime, indeksi i ngarkesës ka munguar në 13.3 përqind të rasteve ose ka rezultuar me vlerë zero në 8.6 përqind të rasteve (që janë rastet e kësteve zero). Rrjedhimisht, bazuar në disponueshmërinë e të dhënave dhe trajtimeve përkatëse të realizuara si më lartë, **vlerësimi i nivelit të ngarkesës më borxh është arritur të kalkulohet për 78.1 përqind të gjithësej huamarrësve.**

Rezultatet e vlerësimit të ngarkesës me borxh sugjerojnë që 28.1 përqind e huamarrësve janë të mbingarkuar me borxh.¹⁰ Në fazën e parë të mbingarkesës – pra në rrezik për mbingarkesë ngase kësti mujor përbën 50 përqind deri në 75 përqind të të hyrave mujore - janë 17.0 përqind të huamarrësve. Në fazën kritike rezultojnë 7.3 përqind e huamarrësve. Rastet kur shpenzimet e kësteve të huamarrësit tejkalojnë plotësisht të hyrat mujore bruto duke kaluar në **gjendje jo-solvente**, paraqiten në **3.8 përqind të mostrës së huamarrësve** (Grafik 1). Megjithatë, kufizimi i të dhënave mund të jete një faktor që objektivist mund të paraqes pengësë në këto përfundime.


¹⁰ Mbingarkesa përfshinë rastet kur niveli i borxhit mujor për të gjitha produktet kreditore (shuma e kësteve mujore të huave, lizingjeve, mbitërheqjeve, dhe kreditkartelave aktive me disa

përshatje) tejkalon 50 përqind së të hyrave mujore të paraqitura apo përshatura.

Grafik 1. Shpërndarja e huamarrësve fizik sipas indeksit të ngarkesës



Grafik 2. Huamarrësit sipas produktit kreditiv (246,430 huamarrës)



Pjesëmarrja e huamarrësve të mbingarkuar (duke konsideruar vetëm produktet kreditore si huatë, lizingjet dhe kreditë hipotekare)

ngarkesës u analizua edhe për ekonomitë familjare, duke integruar të dhënat nga RKK me ato të siguruara nga institucionet financiare për

Indikatori është kalkuluar edhe ndaras për produkte kreditore. Në përbërjen e gjithë huamarrësve nga sektori bankar dhe mikrofinanciar, 70.6 përqind rezultojnë të kenë hua aktive (244,468 huamarrës). Mbitërheqje me bilanc të shfrytëzuar kanë 11.0 përqind e huamarrësve (38,027 huamarrës), ndërsa kreditë kartelë me bilanc të shfrytëzuar kanë 38.4 përqind e gjithë huamarrësve (133,004 huamarrës) (grafik 2).

Niveli i ngarkesës me borxh vetëm për produktin kreditor hua (hua, lizing, kredi hipotekare), duke përfshirë produktet tjera kreditore si kreditë kartelë dhe mbitërheqjet, është kalkuluar për 61.6 përqind të gjithë popullacionit të huamarrësve. Në këtë rast, pjesëmarrja e huamarrësve të mbingarkuar ka rezultuar në 25.9 përqind.,

Vlerësimi i ngarkesës për huamarrësit që posedojnë produktin kreditor mbitërheqje me bilanc të shfrytëzuar është realizuar në popullacionin prej 36,477 klientëve apo 10.5 përqind e të gjithë popullacionit të huamarrësve, duke rezultuar se të mbingarkuar me borxh janë 4.1 përqind e këtyre huamarrësve.


Ndërsa indeksi i ngarkesës për huamarrësit që shfrytëzojnë kreditë kartelë është kalkuluar veçmas vetëm për huamarrësit e sektorit bankar (246,801 huamarrës) duke përfshirë huamarrësit që kanë produkte kreditore në institucione mikrofinanciare (marrë parasysh faktin se mikrofinanciat nuk ofrojnë produkt kreditor kredit-kartelë). Përqindja e huamarrësve të bankave që posedojnë të paktën një kreditë kartelë (133,004 huamarrës) përfaqëson 53.9 përqind të gjithë huamarrësve në banka, ndërsa indeksi është kalkuluar për 51.2 përqind të tyre, për shkak se një pjesë iu mungojnë informacionet e nevojshme. Në këtë rast, rezultatet sugjerojnë se vetëm 1.3 përqind (1,656 huamarrës) e këtyre huamarrësve janë të mbingarkuar me borxh.

rezulton e ngjashme me dy vitet paraprake, me tendencë të lehtë rënëse. Në dhjetor 2023, 25.9 përqind e huamarrësve rezultojnë të mbingarkuar me borxh, ndërsa në vitin 2022, pjesëmarrja e huamarrësve të mbingarkuar ishte 26.1 përqind. Në studimin e vitit 2021, i realizuar në mostër prej 1,805 huamarrësve pjesëmarrja e të mbingarkuarve me borxh ishte 27.4 përqind. pasi analiza është bazuar vetëm në të dhënat e RKK-së që përmbajnë informacione për huamarrësin. Në studimin e vitit 2021, niveli i

të hyrat e anëtarëve të tjerë të familjes së huamarrësit përkatës (Grafik 3).

Përkundër rënies së pjesëmarrjes së huamarrësve të mbingarkuar (shuma e kështit kreditor më e madhe se 50% e të hyrave), pjesëmarrja e huamarrësve në dy kategoritë e fundit, në fazë kritike dhe atyre që kanë borxh më të lartë se niveli i të hyrave, ka treguar tendencë të lehtë rritëse (grafik 3).

Grafik 3. Ngarkesa me borxh e huamarrësve individualë, për produktin kreditor hua



Burimi: BQK.

Është e rëndësishme të theksohet se niveli i vlerësuar i mbingarkesës bazohet vetëm në të hyrat e huamarrësit individual, dhe rrjedhimisht mund të jetë subjekt i mbivlerësimit të gjendjes së mbingarkesës për faktin se nuk konsiderohen të hyrat e njësisë familjare apo bashkëhuamarrësit, të cilat mund të jenë marrë për bazë për vlerësimin e kapacitetit ripagues. Faktorë tjetër me ndikim potencial në subjektivitet të mbingarkesës është mungesa e informacionit për burimet tjera¹¹ financiare të huamarrësve, të cilat nuk raportohen aktualisht në RKK, por të cilat konsiderohen nga sektori si faktorë në vlerësimin e kapacitetit ripagues.

Në tabelën 2 janë paraqitur të hyrat dhe shuma mesatare e kësteve kreditore, në të cilat raste rezultojnë rritje e lehtë e mesatares së të hyrave dhe njëkohësisht kësteve kreditore, por rënie e mesatares të hyrave prej prej 6.4 përqind dhe kësteve kreditore prej 10.4 përqind. Gjithashtu, ka rritje në mesataren e shumës së aprovuar të kredive prej 9.3 përqind si dhe mesataren e borxhit të mbetur prej 12.4 përqind (tabela 4). Probabiliteti i **mbingarkesës** mbetet më i lartë te huamarrësit që kanë tri ose më shumë kontrata aktive kreditore, si dhe te ata që kanë kredi në të dy sektorët – bankar dhe mikrofinanciar njëkohësisht. Kjo tregon se niveli më i lartë i ngarkesës me borxh asocohet me huamarrjen e shumëfishtë, pra me posedimin e shumë kontratave aktive kreditore në disa institucione të ndryshme (tabela 2), proporcion i reduktuar për 1.4 pikë përqindje nga viti i kaluar.

Huamarrësit me kredi në institucione të ndryshme kishin 45.9 përqind të rasteve të mbingarkesës, krahasuar me 39.7 përqind të huamarrësve me disa kontrata kreditore por vetëm në një institucion. Në vitin e kaluar, këto raporte ishin përkatësisht 47.3 dhe 38.9 përqind. Duke krahasuar nivelin e ngarkesës sipas sektorëve, tendencat për

mbingarkesë ishin më të larta në mesin e huamarrësve me kredi aktive në sektorin bankar, ku 28.6 përqind e huamarrësve ishin të mbingarkuar, krahasuar me 18.0 përqind të huamarrësve të mbingarkuar me kredi vetëm në sektorin mikrofinanciar. Ky raport qëndron i ngjashëm me vitin e kaluar, ku në sektorin bankar mbingarkueshmëria është ulur me 0.5 pikë përqindjeje ndërsa është rritur për 0.3 pikë përqindjeje në sektorin mikrofinanciar.

Të pasurit histori kreditore dhe kontrata kreditore të mbështetura në kolateral mund të asocohen me nivele më të larta të ngarkesës me borxh. Problemet eventuale në performancën e pagesës mund të jenë poashtu të jenë të ndërlidhura me nivelin më të lartë të ngarkesës me borxh, me ç'rast niveli më i lartë i rasteve të mbingarkesës është i shprehur në mesin e huamarrësve me vonesa më shumë se 180 ditë në pagesën e kësteve kreditore (tabela 2). Megjithatë, treguesi i kredive jo-performuese është stabil nder vite madje dhe i përmirësuar (1.4%), ndaj edhe nuk ka shqetësime reale në nivel portofoli. Tabela 4. Statistikat mbi të hyrat, kestin, shumën e aprovuar dhe të mbetur

Tabela 4. Statistikat mbi të hyrat, kestin, shumën e aprovuar dhe të mbetur

Të hyrat dhe kësti (në euro)	Mesatarja		Mediana	
	2022	2023	2022	2023
Të hyrat	787	837	488	502
Kësti gjithsej	203	224	127	140
Kësti hua	169	185	106	117
Shuma e aprovuar në hua	11,498	994	5,600	600
Shuma e mbetur aktive në hua (outstanding amount)	8,334	12,572	3,432	6,070

Burimi: RKK-BQK.

Nga **karakteristikat socio-demografike** që kishin dallime statistikisht të rëndësishme në mbingarkesën me borxh, **statusi martesor** rezultojnë të jetë një faktor i rëndësishëm (huamarrësit e martuar janë më të mbingarkuar me borxh). Kjo mbingarkesë më e lartë në mesin e huamarrësve të martuar ndërlidhet me faktin se shpesh ata marrin kredi me bashkëhuamarrje – një aspekt që nuk është konsideruar gjatë vlerësimit të ngarkesës në këtë analizë, për shkak të të dhënave jo të plota mbi bashkëhuamarrjet, duke çuar kështu në mbivlerësim të mundshëm të gjendjes së ngarkesës së kësaj kategorie, veçanërisht për shkak se mund të mos jene të deklaruar të hyrat nga të dy kredimarrësit/bashkëkredimarrësit. Gjithashtu, **rajoni** ka rëndësi statistikore në nivelin e mbingarkesës (rajonet e Prishtinës dhe Mitrovicës kanë më shumë raste të mbingarkesës); **mosha** (rastet më të shpeshta të mbingarkesës janë në grup-moshat 31-40 dhe 51-65 vjeç); dhe **niveli i të hyrave** (rastet më të shpeshta të mbingarkesës janë te huamarrësit me të hyra nga 170 deri në 250 euro). Raporti i pjesëmarrjes relative të huamarrësve të mbingarkuar në këto kategori është rritur nga viti i kaluar (tabela 3).

¹¹ Këto burime përfshijnë të hyrat nga remitencat, të hyrat jofornale (pjesa e pages e paguar jashtë sektorit bankar), të hyrat nga biznesi, shtesë pages mujore.


Tabela 3. Ngarkesa me borxh e huamarrësve sipas karakteristikave socio-demografike dhe socio-ekonomike si dhe të modeleve të huamarrjes

Karakteristikat	Të pa ngarkuar (kësti mujor <50% e të hyrave të EF)	Të mbingarkuar (kësti mujor > 50% e të hyrave të EF)		
		Në rrezik (borxh/të hyra = 50%-75%)	Në fazë kritike (borxh/të hyra = 75%-100%)	Josolvent (borxh/të hyra = mbi 100%)
KARAKTERISTIKAT SOCIO-DEMOGRAFIKE DHE SOCIO-EKONOMIKE TË HUAMARRËSIT INDIVIDUAL				
Gjinia e huamarrësit				
Grua	71.8%	17.3%	7.5%	3.5%
Burrë	71.8%	17.0%	7.2%	4.0%
Statusi martesor i huamarrësit respektiv				
E/l pamartuar	76.6%	15.0%	5.7%	2.7%
Martuar	69.2%	18.2%	8.2%	4.4%
Ve ndarë	75.4%	14.7%	6.0%	3.9%
Lloji i huamarrësit				
Fizik rezident	71.9%	17.0%	7.3%	3.8%
Fizik jo-rezident	82.1%	8.2%	5.0%	4.7%
Rajoni i huamarrësit respektiv				
Prishtinë	69.8%	18.5%	7.6%	4.1%
Mitrovicë	71.1%	17.9%	7.5%	3.5%
Prizren	75.4%	15.0%	6.6%	3.1%
Ferizaj	73.8%	15.7%	7.0%	3.5%
Gjilan	74.2%	15.3%	6.8%	3.7%
Gjakovë	71.7%	16.7%	7.3%	4.3%
Pejë	71.9%	16.5%	7.6%	4.1%
Mosha e huamarrësit respektiv				
< 30 vjet	79.3%	13.3%	5.1%	2.4%
30 - 40 vjet	69.5%	18.4%	7.9%	4.2%
40 - 50 vjet	68.6%	18.6%	8.5%	4.3%
50- 60 vjet	68.7%	18.9%	8.1%	4.3%
> 60 vjet	82.6%	8.8%	4.3%	4.3%
Niveli i të hyrave të huamarrësit				
deri në 170 euro	31.5%	23.5%	21.8%	23.2%
170-249 euro	61.9%	17.8%	12.1%	8.1%
250-449 euro	68.4%	18.9%	8.7%	4.0%
450-749 euro	68.9%	20.5%	7.5%	3.0%
750-999 euro	77.4%	15.5%	4.9%	2.3%
1000-2000 euro	85.0%	9.5%	3.2%	2.4%
mbi 2000 euro	91.8%	4.6%	1.7%	2.0%
MODELET E HUAMARRJES				
Ngarkesa me borxh sipas numrit të kontratave kreditore				
Një kontratë aktive kreditore	88.5%	7.0%	2.8%	1.7%
Dy kontrata aktive	68.2%	21.0%	7.2%	3.6%
Tri kontrata aktive	52.1%	30.1%	12.3%	5.6%
Katër e më shumë kontrata aktive kreditore	33.9%	31.7%	21.8%	12.5%
Ngarkesa sipas llojit të kontratave kreditore				
Hua, lizing, kredi hipotekare	65.3%	21.1%	9.0%	4.7%
Mbitërheqje me bilanc të shfrytëzuar	74.7%	15.7%	6.4%	3.3%
Kreditkartelë me bilanc pozitiv të shfrytëzuar	75.4%	14.6%	6.4%	3.6%
Ngarkesa sipas llojit të institucionit huadhënës				
Bankë	71.4%	19.0%	6.4%	3.2%
Mikrofinancë	82.0%	9.7%	5.2%	3.1%
Bankë dhe Mikrofinancë njëkohësisht	50.5%	24.2%	16.4%	9.0%
Ngarkesa sipas huamarrjes së shumfishtë dhe në institucione të ndryshme				
Shumë kontrata - një institucion kredidhënës	60.3%	27.2%	8.5%	4.0%
Shumë kontrata - disa institucione kredidhënëse	54.1%	24.0%	14.3%	7.7%
Ngarkesa sipas historisë kreditore				
Asnjë kontratë të mbyllur	84.1%	10.1%	3.8%	2.1%
Të paktën një kontratë të mbyllur	67.6%	19.5%	8.5%	4.4%
Ngarkesa sipas kontratave të kolateralizuara				
Asnjë kontratë aktive të kolateralizuar	75.5%	14.4%	6.4%	3.7%
Të paktën një kontratë të kolateralizuar	71.1%	17.6%	7.5%	3.8%
Ngarkesa me borxh sipas klasifikimeve kreditore (vonesave në pagesën e obligimeve kreditore)				
Në kohë, apo me vonesë <30 ditë	72.0%	17.2%	7.2%	3.6%
Vonesë 30- 60 ditë	71.5%	15.6%	8.2%	4.6%
Vonesë 60-90 ditë	70.1%	16.7%	7.9%	5.4%
Vonesë 90 - 180 ditë	71.9%	15.8%	7.4%	4.9%
Vonesë > 180 ditë	70.7%	15.0%	7.8%	6.5%
Shlyerjet	76.0%	13.5%	6.6%	3.9%

Burimi: BQK.


Tendencat për vonesë në pagesën e kësteve mujore dallojnë sipas karakteristikave të njejta sociodemografike me ato të mbingarkesës, përjashtuar rastin e **statusit martesor** ku në tendencat për vonesë në pagesën e kësteve më të shpeshta janë rastet e huamarrësve në grupin me status martesor ‘të pa-martuar’, atë të **rajonit** ku rastet më të shpeshta të mbingarkesës paraqiten në rajonin e Prishtinës dhe Prizrenit si dhe **grupmosha 31-40 vite** ka pjesëmarrje më të lartë të rasteve të vonesës krahasuar me grup moshat e tjera.

Grafik 4a. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas numrit të kontratave kreditore



Në kuadër të modeleve të huamarrjes, të rëndësishme statistikiht në tendencat për vonesë rezultuan numri i kontratave kreditore, kolateralizimi, lloji i institucionit huadhënës, historia kreditore, dhe huamarrja e shumëfishtë. Rastet më të shpeshta të vonesave paraqiten në grupin e huamarrësve me një dhe dy kontrata kreditore (Grafik 4a).


Grafik 4b. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas kolateralizimit



Rastet më të shpeshta të vonesave paraqiten tek kontratat e kolateralizuara (Grafik 4b).


Tendencat më të larta të vonesave paraqiten tek huamarrësit me kredi vetëm në mikrofinanca (Grafik 4c).

Grafik 4.c. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas llojit të institucionit huadhënës




Vonesat më të shpeshta paraqiten tek grupi i huamarrësve me histori kreditore me të paktën një kontratë të mbyllur (Grafik 4d).

Grafik 4.d. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas historisë kreditore



Po ashtu tendencat më të larta të vonesave në pagesën e kredive ishin në mesin e huamarrësve me më shumë se një kontratë kreditore aktive dhe nga institucione të ndryshme.


Grafik 4.e. Performanca e pagesës sipas numrit të kontratave kreditore dhe institucioneve huadhënëse



Rreth 18.3 përqind e huamarrësve me disa produkte kreditore në institucione të ndryshme, janë në vonesë, krahasuar me vetëm 3.4 përqind të huamarrësve me disa kontrata kreditore por në të njëjtin institucion (Grafik 4e).

Krahasuar me vitin e kaluar, është rritur pjesëmarrja e huamarrësve me shfrytëzueshmëri të mbitërheqjeve dhe kreditkartelave (grafik 5). Po ashtu edhe niveli i ngarkesë me borxh është rritur për produktin kreditor mbitërheqje krahasuar me të dhënat e vitit paraprak, por që është në linjë me rritjen e kreditimit.

Grafik 5. Produktet tjera kreditore dhe bilancet e shfrytëzuara



Burimi: BQK.

Përfundimisht mbingarkesa me borxh është tentuar të vlerësohet përmes tre treguesve, si indeksi i ngarkesës, vonesat në pagesën e kësteve dhe posedimi i shumë kontratave kreditore, të cilat së bashku japin informacion të rëndësishëm mbi nivelin e ngarkueshmërisë me borxh të huamarrësve të sektorit financiar në Kosovë. **Megjithëse rezultatet sugjerojnë se mbingarkesa asocohet me huamarrje me disa produkte kreditore dhe performancë më të dobët të pagesës**, relacioni shkak-pasojë ndërmjet këtyre faktorëve nuk është i përcaktuar, dhe mund të zhvillohet në kahje të ndryshme. Posedimi i më shumë kontratave kreditore patjetër ndikon në rritjen e borxhit mujor për pagesë dhe ka ndikim në rritjen e nivelit të ngarkesës me borxh të huamarrësve. Megjithatë, këtu rol mund të ketë edhe aspekti i elaboruar më sipër i mosposedimit i të të dhënave të plota për të gjitha llojet e të hyrave që ka kredimarrësi/bashkredimarrësi (përtej pagës).

Gjithsesi, rezultatet e studimit mund të jenë subjekt i disa kufizimeve në aspekt të kualitetit të të dhënave në dispozicion dhe supozimeve të bëra për shkak të mungesave të hasura. **Përkatesisht** janë evidentuar rastet si: mungesa e informacionit mbi të hyrat në disa observime si dhe diferenca të theksueshme ndërmjet të hyrave të huamarrësit (të raportuara nga institucionet e ndryshme apo edhe institucioni i njejtë). Kjo mund të jetë e ndikuar nga mos-konsistenca e mundshme e azhurnimit të të dhënave për huamarrësin, apo nga mos-evidentimi i të gjitha burimeve të të hyrave të huamarrësit (të hyrat nga biznesi privat, remitencat, të hyra e anëtarëve të tjerë të ekonomisë familjare), të cilat janë konsideruar gjatë shqyrtimit të aplikacionit për kredi, por që nuk kanë qenë të dokumentuara me kontratë apo qarkullim bankar. Këto kufizime si dhe mungesa e informacionit të plotë për bashkëhuamarrjet mund të kenë ndikuar në nën-vlerësimin, respektivisht mbi-vlerësim të ngarkesës së huamarrësit. **Në aspekt të cilësisë**, janë evidentuar rastet e raportimeve të vlerave ekstreme, të hyra shumë të larta apo me vlerë zero, norma shumë të larta apo të ulëta të interesit (që janë të nevojshme për kalkulim të këstit në observimet ku ka munguar), këste shumë të larta që në raste tejkalonin dukshëm të hyrat mujore të huamarrësit e që për pasojë e mbivlerësojnë ngarkesën me borxh. Megjithatë, disa nga rastet e tilla janë trajtuar përkitazi me mundësitë dhe të dhënat e disponueshme, të cilat janë të elaboruara në fillim të kësaj analize.

Kufizimet në disponueshmërinë dhe kualitetin e të dhënave, dhe natyra komplekse dhe shumë e rëndësishme e dukurisë së mbingarkueshmërisë, theksojnë rëndësinë për raportime sa më cilësore të të dhënave, duke avansuar në raportime të informacioneve shtesë dhe sa më të plota, ashtu sic është rekomanduar edhe në analizat e mëparshme të ngarkesës me borxh.

Tabela 4. Karakteristikat socio-demografike dhe socio-ekonomike dhe të modeleve të huamarrjes së huamarrësve individual fizik

Karakteristikat socio-demografike dhe socio-ekonomike të huamarrësit individual	Pjesëmarrja(%)	Numri/Frekuenca
Numri i huamarrësve: 346,490		
Numri i kontratave aktive kreditore: 603,141		
KARAKTERISTIKAT SOCIO-DEMOGRAFIKE DHE SOCIO-EKONOMIKE TË HUAMARRËSIT INDIVIDUAL		
Gjinia e huamarrësit		
Grua	32.9%	111,873
Burrë	67.1%	228,237
Statusi martesor i huamarrësit respektiv		
E/l pamartuar	40.0%	137,418
Martuar	59.5%	204,466
Ve ndarë	0.5%	1,724
Lloji i huamarrësit		
Fizik rezident	98.5%	341,346
Fizik jo-rezident	1.5%	5,144
Rajoni i huamarrësit respektiv		
Prishtinë	36.8%	127,471
Mitrovicë	11.7%	40,299
Prizren	14.3%	49,623
Ferizaj	9.6%	33,125
Gjilan	8.9%	30,661
Gjakovë	9.1%	31,478
Pejë	9.6%	33,358
Mosha e huamarrësit respektiv		
< 30 vjet	23.6%	81,588
30 - 40 vjet	26.7%	92,636
40 - 50 vjet	22.5%	77,813
50- 60 vjet	23.3%	80,645
> 60 vjet	4.0%	13,806
Niveli i të hyrave të huamarrësit		
deri në 170 euro	1.9%	5,567
170-249 euro	6.7%	20,036
250-449 euro	31.6%	94,997
450-749 euro	31.8%	95,315
750-999 euro	9.6%	28,777
1000-2000 euro	12.7%	38,057
mbi 2000 euro	5.8%	17,497
MODELET E HUAMARRJES		
Numri huamarrësve sipas numrit të kontratave kreditore		
Një kontratë aktive kreditore	55.7%	193,034
Dy kontrata aktive	23.4%	81,050
Tri kontrata aktive	14.5%	50,156
Katër e më shumë kontrata aktive kreditore	6.4%	22,250
Numri huamarrësve sipas llojit të kontratave kreditore		
Hua, lizing, kredi hipotekare	70.6%	244,468
Mbitërheqje me bilanc pozitiv	11.0%	38,027
Kreditkartelë me bilanc pozitiv	38.4%	133,004
Produkte tjera kreditore	0.05%	178
Numri huamarrësve sipas numrit të institucioneve		
Klient me kontratë në vetëm një institucion	80.8%	279,859
Klient me kontrata në disa institucione	19.2%	66,631
Numri huamarrësve sipas llojit të institucionit huadhënës		
Bankë	62.0%	214,690
Mikrofinancë	28.8%	99,689
Bankë dhe Mikrofinancë njëkohësisht	9.3%	32,110
Numri huamarrësve sipas historisë kreditore		
Asnjë kontratë të mbyllur	30.0%	104,038
Të paktën një kontratë të mbyllur	70.0%	242,452
Numri huamarrësve sipas kontratave të kolateralizuara		
Asnjë kontratë aktive të kolateralizuar	16.0%	55,592
Të paktën një kontratë të kolateralizuar	84.0%	290,898


Burimi: BQK.

4. Zhvillimet në sistemin financiar

Sistemi financiar vazhdoi zgjerimin, duke mbyllur vitin me rritje të përshpejtuar vjetore të asetëve, përkundër operimit në ambient me rreziqe dhe pasiguri më të larta të nxitura nga shkalla e lartë e inflacionit dhe masat për luftimin e tij.

Në dhjetor 2023, vlera e asetëve të sistemit financiar arriti në 11.1 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 12.4 përqind nga 10.8 përqind në vitin 2022. Rritja më e lartë e asetëve të sistemit financiar krahasuar me rritjen e BPV-së nominale ndikoi në zgjerimin e shkallës së ndërmjetësimit financiar për 3.6 pikë përqindje, në 114.8 përqind në dhjetor 2023 (Grafik 15).


Grafik 15. Peshat e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së



Sektori bankar përfaqësoi 67.9 përqind të asetëve të sistemit financiar dhe, për shkak të peshës së tij të lartë, kishte kontributin kryesor në zgjerimin e sistemit, pavarësisht rritjes vjetore më të ngadalësuar. Sektori pensional, i dyti për nga peshat në sistemin financiar, shënoi rritje të përshpejtuar të asetëve krahasuar me një vit më parë. Sektori mikrofinanciar u karakterizua me rritje të theksuar të aktivitetit për të dytin vit me radhë, duke rritur peshën në sistem në 4.9 përqind në nga 4.1 përqind në vitin paraprak (Grafik 16). Ndërsa sektori i sigurimeve dhe ndërmjetësve financiar, për shkak të peshës më të ulët, kishin ndikim më të kufizuar në

strukturën e përgjithshme të asetëve të sistemit. Sektori i sigurimeve shënoi rritje dyshifrore në asete për vitin e pestë me radhë, ndërsa ndihmësit financiarë shënuan rënie vjetore, të ndikuar nga ri-klasifikimi i dy institucioneve financiare.¹²

Grafik 16. Pjesëmarrja e sektorëve përkatës në asetet e sistemit financiar



Numri i institucioneve financiare u rrit në 136 nga 131 sa ishte një vit më parë, me fillimin e operimit të dy institucioneve financiare jo bankare, dy ndihmësve financiar dhe një ndërmjetësuesi në sigurime (tabela 3).

Kapitali i huaj vazhdon të dominojë pjesën më të madhe të sektorëve të sistemit financiar, veçanërisht sektorët që merren me aktivitet kredidhënës. Njëri nga institucionet financiare jobankare që iu shtua tregut të Kosovë gjatë vitit 2023 ishte me kapital të huaj, ndërsa në sektorët tjerë numrin i institucioneve të huaja mbeti i njëjtë me një vit më parë. Në dhjetor 2023, bankat me kapital vendor përfaqësuan 15.7 përqind të gjithsej asetëve të sektorit, një rritje vjetore për 0.5 pikë përqindje. Kurse, në sektorin e sigurimeve dhe atë mikrofinanciar/financiar jo-bankar kishte rënie të pjesëmarrjes në treg të institucioneve vendore, për 1.9 dhe 0.4 pikë përqindje, duke zbritur në 46.4 dhe 21.3 përqind përkatësisht.

¹² Nga nëntor 2023 dy institucione financiare janë ri-klasifikuar nga ndihmës financiar në ndërmjetës tjerë financiar (IMF&IFJB). Kjo ka


ndikuar që të rris vlerën e asetëve në sektorin mikrofinanciar (ka ndikuar kryesisht në rritje të zërit të bilancit me bankat tjera).

Tabela 3. Numri i institucioneve financiare

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Bankat komerciale	10	10	10	10	11	11	12	12
Siguruesit	15	15	14	13	13	12	12	12
Fondet pensionale	2	2	2	2	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	40	43	50	50	57	53	59	61
Ndërmjetësuesit në sigurime	16	16	16	18	18	19	16	17
Institucionet mikrofinanciare dhe financiare jobankare	22	25	29	29	29	30	30	32

Burimi: BQK.

Grafik 17. Pronësia e sektorëve përbërës të sistemit financiar, dhjetor 2023




Burimi: BQK.

Sektorin bankar dominohet nga kapitali me prejardhje nga BE, që përfshinë dy nga gjithsej tri bankat me pjesëmarrjen më të lartë të aseteve në treg. Rritja e konkurrencës nga bankat tjera, përfshirë operimin e dy bankave relativisht të reja që filluan aktivitetin në tregun vendor në vitin 2020 dhe 2022, ka ndikuar në ulje të shkallës së koncentrimin në asete si dhe zvogëlim të peshës të bankave me origjinë nga vendet e Bashkimit Evropian, në 51.1 përqind nga 51.9 përqind në vitin e kaluar. Hyrja në treg e një banke të re me kapital vendor në vitin 2022 ndikoi që pesha e bankave vendore në gjithsej asetet e tregut të rritet më tej, në 15.7 përqind nga 15.1 përqind në dhjetor 2022. Bankat me origjinë nga Shqipëria rritën pjesëmarrjen në 17.0 përqind nga 16.1 përqind një vit më parë, ndërsa bankat turke, për të dytin vit me radhë, shënuan rënie të peshës në sektor, në 15.0 përqind nga 15.2 përqind në dhjetor 2022. Sektorin mikrofinanciar gjithashtu dominohet nga institucionet me kapital të huaj (Grafik 17), dhe karakterizohet nga shkalla e lartë e koncentrimin. Raporti i aseteve të tre institucioneve më të mëdha ndaj gjithsej

aseteve të sektorit në dhjetor 2023 ishte 52.7 përqind, që paraqat një rënie për 3.5 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Sektorin e sigurimeve vazhdon të ketë nivel më të ulët të koncentrimin, për shkak të shpërndarjes më të baraspeshuar të aseteve në treg. Megjithatë, në katër vitet e fundit është vërejtur një tendencë e rritjes së koncentrimin të aseteve të sektorit të sigurimeve, kryesisht nga revokimi i licencës së dy siguruesve (një në vitin 2019 dhe një në vitin 2021).

Kompanitë e sigurimit me kapital vendor përbëjnë 46.4 përqind të gjithsej aseteve të sektorit, nga 48.3 përqind në vitin e kaluar. Ndërsa, kompanitë me kapital të huaj, me një pjesëmarrje prej 53.6 përqind, kanë vend të origjinës Austrinë, Slloveninë dhe Shqipërinë.

Figura 1. Ndërlidhjet institucionale të Sistemit Financiar të Kosovës



Burimi: BQK.

Shënim: madhësia e secilës nyje (rrethi) reflekton totalin e aseteve të secilit institucion, përjashtuar Qeverinë Qendrore për të cilën janë marrë për bazë gjithsej detyrimet që qeveria i ka në formë të letrave me vlerë ndaj këtyre institucioneve. Drejtimi i shigjetave nënkupton kërkesa ndaj institucionit të cilit i drejtohet shigjeta ndërsa trashësia e vizë-lidhësës dhe shigjetës reflekton nivelin apo madhësinë e ndërlidhjes. Gjendja është me dhjetor 2023.

Dinamikat në ndërlidhjet mes akterëve të sistemit financiar në vitin 2023 kanë pësuar ndryshime të parëndësishme krahasuar me


vitin paraprak. Lidhja kryesore me ndryshimin më të lartë ishte rënia e ekspozimit të sektorit bankar ndaj Qeverisë Qendrore, përkatësisht rënie e investimeve në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës, kryesisht si rrjedhojë e ofertës më të ulët nga qeveria (figura 1). Ndërlidhja ndërmjet bankave dhe fondit pensional shënoi po ashtu ulje, si rezultat i rënies së plasmanëve të fondit pensional në bankat në vend për shkak të orientimit në investime në tregun e jashtëm në rrethanat e normave të larta të kthimit. Kurse ndërlidhja e sektorit pensional me BQK-në shënoi rritje krahasuar me një vit më parë, por kjo rritje është zakonisht e përkohshme deri në vendimin për investim të tyre. Ndërlidhja e sektorit bankar me sektorët tjerë financiar si sektori pensional, sektori i sigurimeve dhe sektori mikrofinanciar në përgjithësi mbetet i ulët, analizuar nga perspektiva e sektorit bankar (kërkesa e bankave komerciale ndaj këtyre sektorëve përbënë vetëm 0.2 përqind të aseteve të sektorit bankar). Sidoqoftë, depozitat që institucionet financiare jo-bankare mbajnë në banka komerciale paraqesin ekspozim të lartë ndër-institucional për disa nga këto institucione, ndaj dhe kjo ndërvarësi thekson rëndësinë e monitorimit dhe kuptimit të efekteve të përhapjes së rreziqeve brenda sistemit financiar.

Në kuadër të ndërlidhjeve ndër-bankare, me nivel më të lartë vazhdon të qëndroj ndërlidhja në mes të bankave me kapital të huaj që operojnë në Kosovë dhe bankave të tyre amë.

Bankat e mëdha ekspozimet kryesore i kanë në tregjet e jashtme, ndaj bankave amë apo bankave / institucioneve të tjera financiare (figura 2). Bankat relativisht më të vogla kanë ekspozime në nivel më të ulët ndërmjet tyre por në nivel më të theksuar ndaj bankave më të mëdha. Bankat me origjinë turke shfaqin ndërlidhje më të mëdha ndërmjet vete.

Kryesisht ndërlidhjet ndërmjet bankave janë në formë të depozitave, të huazimeve afatshkurtra dhe në nivel më të ulët, huave. Krahasuar me një vit më parë, në sektorin bankar në përgjithësi ka rënie të ndërveprimit të bankave me kapital të huaj me bankat vendore, kurse rritje të ndërveprimit me bankat e huaja. Bankat me kapital të huaj që operojnë në vend kanë zvogëluar konsiderueshëm huadhënien për bankat amë, kurse rritur lehtësisht huamarrjen prej këtyre institucioneve.

Figura 2. Ndërlidhjet bankare të sektorit bankar të Kosovës



Burimi: BQK.

Shënim: madhësia e secilës nyje (rrethi) reflekton totalin e aseteve të secilit institucion bankar, përjashtuar bankat amë ku është marrë për bazë gjithsej kërkesat që i kanë bankat amë në formë të linjave kreditore apo borxhit të ndërvarur ndaj bankave përkatëse në vend. Drejtimi i shigjetave nënkupton kërkesa ndaj institucionit bankar të cilit i drejtohet shigjeta ndërsa trashësia e vizë-lidhëses dhe shigjetës reflekton nivelin apo madhësinë e ndërlidhjes. Gjendja është me dhjetor 2023.


4.1. Sektori bankar

Sektori bankar shënoi rritje dy shifrore por më të ngadalësuar të aktivitetit krahasuar me një vit më parë, zhvillim ky në linjë me ngadalësimin e aktivitetit ekonomik në vend, dhe në BE.

Asetet e sektorit bankar u rritën për 11.5 përqind, duke arritur vlerën prej 7.54 miliardë euro. Aktiviteti kreditor shënoi një ngadalësim të rritjes krahasuar me vitin paraprak prej 13.4 përqind, megjithatë mbajti një nivel rritjeje dyshifrore. Kategoria e dytë për nga kontributi në rritjen e gjithsej aseteve, investimet në letrat me vlerë shënuan rritje vjetore të konsiderueshme, prej 19.0 përqind nga 9.8 përqind një vit më parë; ndikuar nga normat e larta të interesit në tregjet ndërkombëtare - derivat i politikave monetare shtrënguese të BQE-së. Kjo, së bashku me rënie të ofertës nga Qeveria, ka ndikuar në rënie të investimeve në letra me vlerë vendore, përderisa letrat me vlerë në tregun e jashtëm shënuan rritje të theksuar prej 38.1 përqind. Kategoria e tretë për nga kontributi në rritjen e gjithsej aseteve, paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në, shënoi rritje vjetore më të ngadalësuar, prej 3.9 përqind nga 4.5 përqind në vitin paraprak, tregues që sugjeron orientimin e mjeteve në instrumente financiare me kthim më të lartë. Edhe

komponenta e bilancit me bankat tjera shënoi ngadalësim të rritjes krahasuar me vitin e kaluar, prej 4.3 përqind nga 15.9 përqind rritje në vitin 2022 - mjetet të cilat u orientuan po ashtu drejt instrumenteve me kthim më të lartë, siç janë kreditimi dhe veçanërisht letrat me vlerë.

Grafik 18. Pjesëmarrja në strukturën e aseteve




Struktura e sektorit bankar ka mbetur e ngjashme me periudhat paraprake; ku kreditimi dhe investimet në letrat me vlerë përbëjnë 77.0 përqind të aseteve bankare kurse depozitat dhe burimet vetanake përbëjnë 92.7 përqind të detyrimeve dhe ekuitetit. Në dy vitet e fundit, investimet e sektorit bankar në letra me vlerë të qeverisë së Kosovës shënuan rënie vjetore prej 15.1 dhe 16.1 përqind përkatësisht, ndikuar kryesisht nga oferta më e ulët dhe normat e kthimit të lakmueshme në tregjet e jashtme

Burimi kryesorë i financimit të sektorit bankar mbesin depozitat, të cilat vazhduan trendin dyshifror të rritjes vjetore, por me ritëm më të ngadalësuar. Gjithsej depozitat arritën vlerën në 6.1 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 10.4 përqind nga 13.3 përqind në dhjetor 2022). Depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje të përsheptuar vjetore, ndërsa me ngadalësim të rritjes u karakterizuan depozitat e korporatave financiare (kryesisht fondeve pensionale) dhe korporatave jofinanciare (ndërmarrjeve). Depozitat e korporatave tjera publike (ndërmarrjeve publike) ishin të vetmet që u karakterizuan me rënie vjetore, e që ndër tjerash është si rezultat i rritjes së investimeve në letrat me vlerë, pasi që ofrojnë norma më të larta të kthimit se sa

interesi i fituar prej bankave si depozitë. Në fund të vitit 2023, gjithsej depozitat përfaqësuan 81.3 përqind të burimeve të financimit të sektorit bankar (Grafik 19).

Grafik 19. Pjesëmarrja në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake



Depozitat e ekonomive familjare, me pjesëmarrje 66.2 përqind në gjithsej depozitat, shënuan rritje vjetore prej 11.3 përqind nga 8.2 përqind rritje një vit më parë.

Faktorët me ndikim në këtë rritje ishin ngritja e nivelit të pagave, si dhe rritja vjetore e përsheptuar e remitencave në 9.9 përqind nga 6.0 përqind rritje në vitin 2022. Depozitat e korporatave jofinanciare, të dytat për nga pjesëmarrja në strukturën e depozitave, shënuan rritje vjetore më të ngadalësuar, prej 12.9 përqind nga 18.9 përqind në vitin 2022.


Depozitat e korporatave jofinanciare, të dytat për nga pjesëmarrja në strukturën e depozitave, shënuan rritje vjetore më të ngadalësuar, prej 12.9 përqind nga 18.9 përqind në vitin 2022.

Depozitat e korporatave tjera financiare shënuan rritje vjetore dukshëm më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë, prej 5.9 përqind rritje (54.0 përqind rritje në vitin 2022). Ky zhvillim u ndikua nga fondet pensionale, të cilat zvogëluan depozitat në sektorin bankar në vend dhe rritën ekspozimet në tregun e jashtëm, kryesisht në fonde të përbashkëta, të cilat ofrojnë kthime më të lartë në investime krahasuar me normën e fituar prej depozitave në bankat komerciale. Depozitat nga institucionet e tjera financiare, si kompanitë e sigurimeve, institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiarë, shënuan rritje, por për shkak të peshës më të

ulët ndikimi i tyre në dinamikën e gjithsej depozitave të korporatave të tjera financiare ishte i limituar.

Depozitat e reja, që përfshijnë vetëm depozitat e afatizuara, shënuan rritje vjetore prej 11.3 përqind si rezultat i rritjes së lartë të depozitave të afatizuara nga ekonomitë familjare, përderisa afatizimet nga korporatat jo-financiare shënuan rënie. Kampanjat atraktive të bankave me norma të rritura të interesit për afatizim të mjeteve vazhduan edhe në vitin 2023, por ritmi i rritjes vjetore të afatizimeve ishte më i ngadalshëm për shkak të rritjes së lartë prej 74.3 përqind në vitin paraprak kur filloi rritja e normave të interesit. Konkretisht, ngadalësimi i përgjithshëm i rritjes së depozitave të reja buroi prej segmentit të korporatave jofinanciare, depozitat e reja të së cilit në vitin 2023 ishin në vlerë prej 290.5 milionë euro kundrejt vlerës prej 356.2 milionë euro një vit më parë.

Grafik 20. Stoku i gjithsej depozitave dhe depozitave të reja, në milionë euro



Burimi: BQK.


Ndërsa, depozitat e reja të investuara nga ekonomitë familjare përshpejtuan rritjen vjetore në 36.4 përqind nga 24.0 përqind, duke arritur vlerën prej 574.9 milionë euro (Grafik 20).

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit të jashtëm shënoi rritje të lartë për të dytin vit me radhë si rezultat i rritjes së investimeve të mjeteve në letrat me vlerë, ndikuar prej kthimit më të lartë në investime krahasuar me vitet paraprake, por në aspekt të pjesëmarrjes ekspozimi vazhdon të jetë relativisht i ulët. Pozicioni neto kreditor ndaj sektorit të jashtëm arriti në 949.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore

prej 28.4 përqind krahasuar me rritjen prej 26.4 përqind një vit më parë (Grafik 21 dhe 22). Rritja e pozicionit neto kreditor në dy vitet e fundit i atribuohet kryesisht rritjes së theksuar të investimeve në letra me vlerë në sektorin e jashtëm, si dhe rritjes, megjithëse më të ngadalësuar, të plasmanëve/depozitave në sektorin e jashtëm.


Kërkesat ndaj jo rezidentëve përbëjnë 16.8 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar, ku 91.0 përqind e tyre janë depozita dhe investime në letra me vlerë. Detyrimet e sektorit bankar ndaj jo rezidentëve zënë 4.2 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit bankar, në formë të linjave kreditore dhe depozitave të sektorit të jashtëm të mbajtura në vend. Këto dy zëra përbëjnë 99.0 përqind të gjithsej detyrimeve ndaj jo-rezidentëve.

Grafik 21. Pozicioni neto ndaj jorezidentëve



Sektori bankar vazhdon të ketë një ekspozim të ulët ndaj sektorit të jashtëm. Niveli i ulët i aseteve në valutë të huaj zvogëlon më tej efektet e mundshme të bartjes së problemeve nga sektori i jashtëm dhe shmang humbjet e mundshme nga ndryshimet jo të favorshme në kurset e këmbimit kundrejt euros.

Grafik 22. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktivitetit me jorezidentët




Burimi: BQK.

4.1.1 Zhvillimet kreditore

Aktiviteti kreditues i sektorit shënoi rritje vjetore prej 13.0 përqind, për 3 pikë përqindje më ulët se viti paraprak. Ky zhvillim pasqyron trendin më të ngadalësuar të rritjes së kreditimit për korporatat jofinanciare - në linjë me ngadalësimin e aktivitetit ekonomik, si dhe ndikuar edhe nga ri-aranzhimi dhe reduktimi i një pjese të kredive të ekspozimeve të mëdha kreditore. Ndërkohë, kreditë për ekonomitë familjare përsheptuan trendin e rritjes vjetore.

Sipas Anketës së Kreditimit Bankar të Kosovës (AKBK), dinamikat e kreditimit në tremujorin e katërt të vitit 2023, ashtu si gjatë pjesës tjetër të vitit, u ndikuan kryesisht nga kërkesa kreditore, ndërkohë që oferta kreditore kishte ndryshime të vogla.

Grafik 23. Rritja vjetore e kredive për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare




Stoku i kredive aktive në bankat e vendit arriti në 4.91 miliardë euro. Segmenti i korporatave jofinanciare shënoi rritje vjetore të stokut të kredive prej 10.1 përqind, për 5.6 pikë përqindje më ulët se viti paraprak. Kurse, stoku i kredive për ekonomitë familjare shënoi rritje vjetore të përsheptuar prej 17.3 përqind nga 16.7 përqind rritje në vitin paraprak (Grafik 23).

Kreditë e reja përsheptuan ritmin e rritjes vjetore në 9.9 përqind nga 6.5 përqind në vitin paraprak, të ndikuar nga përsheptimi i rritjes së kredive konsumuese të ekonomive familjare¹³.

Në vitin 2023, gjithsej kreditë e reja për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 14.1 përqind, për 11.7 pikë përqindje më lartë se viti paraprak. Rritja e lartë e kredive të reja konsumuese prej 23.2 përqind, nga rënia prej 6.3 përqind një vit më parë, kishte kontributin kryesor në rritje të këtij segmenti. Ndërkohë, kreditë e reja hipotekare gjatë kësaj periudhe kanë shënuar rënie vjetore për herë të parë që nga fillimi i evidentimit të tyre, përkatësisht rënie prej 11.3 përqind nga rritja prej 13.5 përqind një vit më parë. Rënia e kësaj kategorie të kredive të reja, ndër tjera, mund të jetë rezultat i çmimeve të larta të patundshmërive, duke dekurajuar individët që të blejnë patundshmëri, apo duke ndikuar që t'i shtyjnë blerjet në një periudhë tjetër. Për më tepër, të dhënat e publikuara nga ASK-ja për Indeksin e Kostos së Ndërtimit, në dy vitet e fundit tregojnë për rritje të kostos së përgjithshme të ndërtimit, veçanërisht materialeve ndërtimore, pagave dhe transportit, faktorë ky që ka ndikuar në rritjen e çmimit të patundshmërive.

Grafik 24. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të reja për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare, në milionë euro




Kreditë e reja të korporatave jofinanciare u rritën për 7.1 përqind nga 9.6 përqind në vitin 2022 (Grafik 24). Ngadalësimi i rritjes kryesisht buroi nga kreditë për qëllime investuese, të cilat kanë dhe pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej kreditë e reja të këtij segmenti, përderisa kreditë e reja jo-investuese (jo hipotekare) shënuan rritje (kryesisht me qëllim investues) shënuan rritje të përsheptuar vjetore.

¹³ Kreditë personale/individuale, për qëllime konsumi dhe investimi.

Ngadalësimi i përgjithshëm i gjithsej kreditimit për korporata jofinanciare në vitin 2023 është në linjë me zhvillimet e përgjithshme ekonomike në vend, përkatësisht me ngadalësimin e investimeve private si dhe ngadalësimin e qarkullimit të ndërmarrjeve në sektorët me peshën më të lartë në kreditim (grafik 25). Investimet private, në vlerë nominale për vitin 2023 kanë shënuar rritje dukshëm më të ngadalësuar vjetore, prej 1.3 përqind nga 11.2 përqind në vitin paraprak. Gjithashtu, qarkullimi vjetor i ndërmarrjeve ka shënuar rritje më të ulët vjetore prej 7.4 përqind nga 22.3 përqind rritje një vit më parë, kryesisht si rezultat i ngadalësimit në sektorin e tregtisë, prodhimitarisë dhe ndërtimitarisë. Këto zhvillime, rrjedhimisht, janë reflektuar në kërkesën më të ulët për kredi nga ndërmarrjet në sektorët përkatëse.

Grafik 25. Stoku i kredive sipas sektorëve të ekonomisë




Burimi: BQK.

Kreditimi ndaj sektorit të prodhimitarisë kishte kontributin më të lartë në ngadalësimin e gjithsej kredive për segmentin e korporatave jofinanciare, si rezultat i rritjes së ulët vjetore prej 5.9 përqind nga 29.4 përqind rritje në vitin 2022. Sektori i tregtisë shënoi rritje vjetore prej 8.3 përqind në vitin 2023 nga rritja prej 11.8 përqind në vitin e kaluar, dhe ishte i dyti për nga kontributi në ngadalësimin e kredive për korporatat jofinanciare. Sektori i ndërtimitarisë shënoi rritje të ngadalësuar prej 15.9 përqind nga 25.8 përqind një vit më parë. **Sektori i bujqësisë këtë vit u karakterizua me rritje të përsheptuar prej 25.8 përqind, për dallim nga rritja prej 9.9 përqind në vitin paraprak.**

Mbështetës i rëndësishëm i kreditimit ndaj ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme,

konfirmuar edhe nga rezultatet e Anketës së Kreditimit Bankar të Kosovës, vazhdon të jetë Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë, duke kontribuar pozitivisht në ofertë më të mirë kreditorë nga bankat për bizneset të cilat kualifikohen për përkrahje.

Grafik 26. Kreditë e aprovuara dhe të garantuara nga FKGK



Burimi: FKGK.

Shfrytëzimi i fondit nga bankat është rritur gradualisht, krahas rritjes së mundësive për shfrytëzim përmes dritareve të reja garantuese. Gjatë vitit 2023 u krijuan edhe dy dritare të reja: Gratë në Biznes dhe Dritarja për Eksport, që kanë për qëllim mbështetjen e grave në biznes, si dhe sipërmarrësve të orientuar në eksport të mallrave dhe shërbimeve. Numri kumulativ i kredive të bankave për NVM-të, të garantuara nga FKGK, në fund të vitit 2023 arriti në 14,3 mijë, me shumë totale prej 626.4 milionë euro, që përbënë 21.2 përqind të gjithsej kredive bankare për segmentin e korporatave jofinanciare.


Kryesisht, struktura e kredive të garantuara nga FKGK është përfaqësim i strukturës së përgjithshme të kredive të sektorit bankar. Kreditë e garantuara dominohen nga sektori i tregtisë, me një pjesëmarrje prej 42.0 përqind në gjithsej portofolin garantues, pasuar nga sektori i shërbimeve me 23.0 përqind dhe prodhimitaria me 20.0 përqind. Pjesa e mbetur përbëhet nga sektori i ndërtimitarisë dhe bujqësisë, të cilët kanë një pjesëmarrje pothuajse të barabartë, me 7 përkatësisht 8 përqind të gjithsej portofolios garantuese (Grafik 26).

Kreditë afatgjata, ndër vite kanë rritur gradualisht pjesëmarrjen në gjithsej stokun e kreditimit, duke dominuar

pjesëmarrjen në gjithsej strukturën e kredive sipas maturitetit.¹⁴ Gjatë vitit 2023, sidoqoftë, trendi i rritjes së kredive afatgjata u ngadalësua, i ndikuar nga rënia vjetore e kredive hipotekare.

Në dhjetor 2023, kreditë me maturitet afatgjatë shënuan rritje vjetore prej 13.4 përqind, për 9.4 pikë përqindje më ulët se vitin paraprak. Pjesëmarrja e tyre në gjithsej kreditë, sidoqoftë mbeti më e larta, në 55.3 përqind të gjithsej kredive. Në ngadalësimin e rritjes së këtyre kredive ka ndikuar rënia vjetore e kredive të reja hipotekare prej ekonomive familjare, pasi që kryesisht janë kredi me afat të gjatë maturiteti. Kreditë me maturitet afatmesëm shënuan rritje vjetore të përsheptuar, prej 16.3 përqind nga 7.9 përqind rritje vjetore në vitin 2022, dhe zgjeruan pjesëmarrjen në 35.2 përqind, për 1.1 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar.


Grafik 27. Kreditë e ndërmarrjeve, pjesëmarrja sipas maturitetit



Në zgjerimin e kësaj kategorie të maturitetit të kredive ka ndikuar edhe rritja e theksuar e kredive të reja konsumuese, pasi që kryesisht kanë afat të mesëm maturiteti. Ndërsa kreditë afatshkurtëra në vitin 2023 shënuan rënie vjetore prej 1.1 përqind nga rritja vjetore prej 11.5 përqind një vit më parë, dhe zvogëluan pjesëmarrjen për 1.3 pikë përqindje, përkatësisht përfaqësuan 9.5 përqind të gjithsej kredive.

Shpërndarja e kredive të korporatave jofinanciare sipas maturitetit ka pësuar ndryshim të lehtë, me dominimin e kredive afatmesme në fund të vitit 2023, pas tkurrjes graduale ndërvite në favor të zgjerimit të kredive afatgjata (Grafik 27).

Grafik 28. Kreditë e ekonomive familjare, pjesëmarrja sipas maturitetit



Tek ekonomitë familjare, rritja më e theksuar e kredive konsumuese në vitin 2023 ka frenuar trendin e theksuar të rritjes ndërvite të kredive afatgjata, të cilat në dhjetor 2023 përfaqësuan 78.5 përqind të gjithsej portofolios kreditorë të këtij segmenti (Grafik 28).

¹⁴ Periudha afatshkurtër përfshinë maturitetin deri në 1 vit, afatmesme përfshinë maturitetin prej 1 deri në 5 vite, dhe periudha afatgjatë përfshinë maturitetin mbi 5 vite.

Kutia 4. Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës¹⁵


Rezultatet e Anketës së Kreditimit Bankar të Kosovës¹⁶ pasqyrojnë zhvillimet në aktivitetin e kreditimit bankar gjatë periudhës TM1 2023 – TM4 2023 (referuar si viti 2023), si dhe pritjet për aktivitetin kreditues në periudhën janar - qershor 2024 (referuar si gjashtëmujori i parë i vitit vijues - 6M1).

Dinamika e aktivitetit kreditues për ndërmarrjet gjatë vitit 2023 është ndikuar pozitivisht kryesisht nga rritja e kërkesës për kredi, ndërsa oferta kreditore nuk ka pësuar ndryshime të

rëndësishme. Këto zhvillime janë në përputhje me zhvillimet makroekonomike të përgjithshme në vend, përkatësisht rritjes më të ngadalësuar ekonomike si dhe qarkullimit më të ulët të bizneseve krahasuar me një vit më parë.

Sa i përket vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve, në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan lehtësime të mëtejme të standardeve kreditore në vitin 2023. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, bankat deklaruan se do të aplikojnë ndryshime marginale në standardet kreditore në drejtim negativ për ndërmarrjet e mëdha, kurse lehtësim për NVM-të (grafik 1).

Grafik 1. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve të ndërmarrjeve



Faktorët të cilët ndikuan negativisht në standardet kreditore të aplikuara nga bankat gjatë vitit 2023 kishin të bëjnë me rreziqet e lidhura me perspektivën jo të mirë në tregjet globale dhe ecurinë e normave të interesit. Në anën tjetër, faktorët kryesorë që ndikuan pozitivisht në standardet kreditore ishte mbështetja nga FKGK-ja, presioni konkurrues mes bankave dhe pozita e kënaqshme me likuiditet.

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kushtet dhe rregullat e aplikuara me rastin e dhënies së kredive për të dy segmentet e ndërmarrjeve kishin lëvizje negative në normën e interesit në kredi, kurse pozitive në kërkesën mbi kolateral. Konkretisht, u aplikua shtrëngim i lehtë në normën e interesit në kredi si për NVM-të dhe

ndërmarrjet e mëdha. Kurse, sa i përket kërkesës mbi kolateral, kishte lehtësim por me theks të veçantë për NVM-të (grafik 2).


Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat pritet të ketë lëvizje marginale në të dy kahjet. Konkretisht, lehtësim marginal për të dy kategoritë e ndërmarrjeve në madhësinë mesatare të kredisë dhe kërkesën mbi kolateral. Faktorët që mbështetën lehtësimi e kushteve janë mbështetja e FKGK-së, presioni konkurrues mes bankave dhe pozita e kënaqshme me likuiditet. Kurse, pritet një shtrëngim marginal në maturitetin e kredive dhe në normën e interesit si për NVM-të dhe ndërmarrjet e mëdha.

¹⁵ Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës realizohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me 11 bankat që operojnë në Kosovë. Anketa realizohet në baza tremujore. Kjo anketë përfshinë të dhënat e agreguara të secilit kuartal të vitit 2023 si dhe pritjeve për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024.

¹⁶ Përgjigjet e bankave individuale janë agreguar duke përdorur peshën përkatëse të çdo banke në gjithsej portofolin kreditore të

sektorit bankar. Vlerat pozitive e indeksit të standardeve kreditore tregojnë lehtësim dhe vlerat negative tregojnë shtrëngim. Gjithashtu, vlerat pozitive e indeksit të kërkesës për kredi tregojnë rritje të kërkesës dhe vlerat negative tregojnë rënie. Më gjerësisht metodologjinë e përdorur mund ta gjeni në Raportin e Anketës së Kreditimit Bankar në ëeb faqen e BQK.

Grafik 2. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ndërmarrjeve




Gjatë periudhës raportuese, në përgjithësi kishte një rritje deri në një masë të kërkesës për kredi bankare nga ndërmarrjet, ngjashëm me dinamikën e vitit të kaluar. Kërkesa për kredi ishte lehtësisht më e lartë nga NVM-të, krahasuar me ndërmarrjet e mëdha (grafik 3). Kjo rritje e kërkesës u nxit kryesisht nga rritja e kërkesës për financimin e inventarëve - kapitalit punues dhe investimeve fikse. Raporti i kredive jo-performuese të ndërmarrjeve u përmirësua gjatë vitit 2023, duke gjeneruar një indeks të ulët negativ.

Pritjet për zbutje të presioneve inflacioniste në vitin e ardhshëm, që do të ketë efekt në reduktim të

pasigurisë për investime, rrjedhimisht rritje më të lartë ekonomike, do të ndikojnë në rritjen e kërkesës për investime nga bizneset. Pra, në gjashtëmuorin e parë të vitit 2024, bankat presin një rritje të kërkesës për kredi nga të dy kategoritë e ndërmarrjeve. Këto pritje iu atribuuan rritjes së pritur të kërkesës për financimin e inventarëve - kapitalit punues dhe investimeve fikse, në përputhje me ciklin e biznesit.

Sa i përket cilësisë së portofolios kreditore të ndërmarrjeve, bankat për gjashtëmuorin e parë të vitit 2024 presin që raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive të mbetet po thuaj i njëjtë.

Grafik 3. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet



Në kontekst të maturitetit të kredive, rezultatet e anketës tregojnë se kërkesa më e madhe nga ndërmarrjet gjatë kësaj periudhe ishte për kreditë afatshkurtra, ndërsa kërkesa për kredi afatgjata kishte një rritje më të ulët. Oferta kreditore, e ndarë sipas maturitetit të kredive, tregoi shtrëngim marginal për kreditë afatgjata, kurse lehtësim marginal për kreditë afatshkurtra, si dhe pritet të mbetet ngjashëm edhe në gjashtëmuorin e parë të vitit 2024. Ndërsa, sa i përket kërkesës, bankat presin rritje më të lartë të kërkesës si për kreditë me maturitet afatshkurtër, ashtu edhe për ato afatgjata (grafik 7).

Dinamikat e aktivitetit kreditues për ekonomitë familjare gjatë periudhës raportuese, sipas anketës, u mbështetën kryesisht nga kërkesa kreditore, pasi që oferta kreditore në përgjithësi nuk pësoi ndryshime të theksuara, konkretisht lehtësime marginale.


Standardet kreditore të aplikuara gjatë shqyrtimit të aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare u lehtësuan deri në një masë për kreditë për investime dhe blerje të patundshmërive. Ndërsa, standardet kreditore për kreditë konsumuese mbetën të pandryshuara (grafik 4).

Presioni nga konkurrenca, lehtësimi në qasje të financimit nga bankat vendore dhe pozita e kënaqshme me likuiditet ishin faktorët që kontribuan në lehtësim të standardeve kreditore për blerje të patundshmërive; ndërsa rritja potenciale e kredive me probleme ndikoi që standardet e aplikuara për kreditë konsumuese, që

dominojnë strukturën e kreditimit për segmentin ekonomi familjare të mbeten të pandryshuara.

Pritjet e bankave për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024 nuk parashikojnë ndryshime të rëndësishme të standardeve kreditore, me lëvizje pozitive për të dy llojet e kredive për segmentin e ekonomive familjare.

Grafik 4. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve nga ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

*Vlera e pritur për periudhën janar-qershor 2024

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare përgjithësisht u shtrënguan në nivele marginale. Konkretisht, bankat aplikuan shtrëngime përmes rritjes së normës së interesit,

ndërsa aplikuan lehtësime në kërkesat për kolateral. Faktori kryesor në rritjen e normës së interesit ishte rritja e normës së EURIBOR-it, e cila kryesisht aplikohet në kreditë me normë variabile të interesit (grafik 5).

Grafik 5. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ekonomive familjare




Burimi: BQK.

*Vlera e pritur për periudhën janar-qershor 2024

Për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024, bankat prisnin lëvizje marginale pozitive në kushtet dhe rregullat për kreditë e ekonomive familjare, përfshirë rritjen e maturitetit të kredisë për blerje të

shtëpive dhe uljen e kërkesës për kolateral për kreditë me qëllim konsumi. Lehtësim në normën e interesit pritet të ketë për të dy kategoritë e ekonomive familjare në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024.

Grafik 6. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK.


Bankat deklaruan rritje të kërkesës për kredi të ekonomive familjare për të dy kategoritë, por rritja ishte më e evidente për kreditë konsumuese – personale dhe jo hipotekare (grafik 6). Nevoja për financim ishin kryesisht të natyrës investuese, renovuese, apo tjera jashtë konsumit (sipas të dhënave që merren nga shumat e kredive, të cilat dominoheshin nga ato mbi 10,000 euro) duke dhënë kështu kontributin kryesor në rritje të kërkesës për kreditë konsumuese. Për kreditë për blerje të patundshmërive (kreditë hipotekare në kuptim të definicionit rregullativ), si faktorë me ndikim në rritje të kërkesës u deklarua perspektiva pozitive në

tregun e patundshmërive, si dhe financimi i kombinuar (i pjesshëm) nga bankat dhe fondet e kredimarrësit, që nuk kualifikohen si hipotekare.

Sipas anketës, raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive për ekonomitë familjare shënoi rritje, ndersa për vitin 2024 pritet të mbetet në nivele të ngjashme.

Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2024 kërkesa për kredi pritet të ketë rritje dukshëm më të lartë se sa përgjatë vitit aktual. Bankat presin rritje më të lartë të kërkesës për kreditë konsumuese, kurse rritje më të ulët për ato për blerje të patundshmërisë.

Grafik 7. Ndryshimi i standardeve kreditore dhe kërkesës për kredi sipas maturitetit




Burimi: BQK.

Sa i përket afatit kohor, rezultatet e anketës tregojnë se ekonomitë familjare gjatë vitit 2023 kishin rritje më të lartë të kërkesës për kredi me maturitet afatshkurtër, se sa për ato afatgjata.

Oferta kreditore për ekonomitë familjare e ndarë sipas maturitetit të kredive kishte ndryshime

negative marginale për kreditë afatshkurtra, kurse lehtësisht më të favorshme për kreditë afatgjata. Bankat presin në gjashtëmuorin e ardhshëm lehtësim në ofertën kreditore, që do të orientohet në nivel më të lartë drejt kredive afatgjata (grafik 7).

Grafik 8. Ndryshimi në financimin e sektorit bankar



Burimi: BQK.

*Vlera e pritur për periudhën janar-qershor 2024

Sa i përket dinamikave në financim, bankat raportuan rritje të konsiderueshme të **qasjes në financim** gjatë vitit 2023 krahasuar me një vit më parë. Depozitat e ekonomive familjare kishin rritjen më të madhe, ndërsa edhe financimi nga ndërmarrjet shënoi rritje, por në nivel më të ulët. Financimi nga bankat amë dhe prej institucioneve financiare ndërkombëtare mbeti i pandryshuar.

Sipas maturitetit, rritje shënuan si financimi afatshkurtër dhe ai afatgjatë.

Gjatë gjashtëmujorit të ardhshëm, disa banka presin rritje më të ngadalësuar të qasjes në financim, dinamikë që pritet të ndikohet nga pritjet për ngadalësim të depozitave prej ekonomive familjare (grafik 8). Sa i përket maturitetit të financimit, bankat presin që rritja e financimit të jetë kryesisht nga financimi afatshkurtër, përderisa ai afatgjatë do të ketë kontribut marginal pozitiv në financim.

5. Rreziqet e sektorit bankar

Sektori bankar ka treguar qëndrueshmëri përballë faktorëve të shtuar të rrezikut ndaj të cilëve ka qenë i ekspozuar, veçanërisht gjatë viteve të fundit. Aktiviteti ekonomik i dobësuar në eurozonë, pasiguritë makroekonomike dhe veçanërisht ato gjeopolitike nuk kanë ndikuar në rritjen të theksuar të rreziqeve të sektorit bankar në vend. Sidoqoftë, pasiguritë mbesin të larta, duke rritur nevojën për qasje prudente dhe mirëmbajtje të kapacitetit absorbues të sektorit përkitazi me zgjerimin e bilancit të sektorit.


Adresimi i inflacionit përmes rritjes së normave të interesit që nga gjysma e dytë e vitit 2022 dhe në gjysmën e parë të vitit 2023, ka krijuar disa presione për bankat në Kosovë në aspektin e financimit të aktivitetit të tyre kreditor për shkak të rritjes së kostos së financimit, veçanërisht për shkak të rritjes së konkurrencës si dhe apetitit të lartë të zgjerimit të bilancit të gjendjes (kreditimit dhe investimeve).

Nën këto rrethana, struktura e investimeve, e financimit dhe hendeku i ri-çmimit (rifinancimi dhe riinvestimi i pozicioneve bilancore) janë prekur më ndjeshëm. Ndryshimet në strukturën apo pozicionet e investimeve dhe kreditimit janë nxitur nga dy faktorë kryesorë. Së pari, rritja e normave të interesit mund të ketë dekurajuar kërkesën për kredi duke ndikuar në ngadalësim të kreditimit për shkak të rritjes së kostos së borxhit, dhe rritja e konkurrencës mes bankave për tërheqjen e depozitave ka qenë sfiduese për disa banka, duke ndikuar në ofertën kreditorë për shkak të pamundësisë për të mbështetur mjaftueshëm kreditimin me depozitat në dispozicion. Së dyti, normat atraktive të kthimeve nga investimet në instrumente në tregjet e jashtme kanë favorizuar disa banka më të mëdha, të cilat kanë rritur kthimet dhe profitabilitetin përmes zhvendosjes së pozicioneve nga kreditimi drejt investimeve në letra me vlerë të huaja.

Kjo ka siguruar realizimin e profitit për disa banka, ndërsa për të tjera ka krijuar më shumë shpenzime për shkak të kostove më të larta financuese dhe hapsirës më të kufizuar për investime dhe financim, duke bërë që sektori të realizojë profit në një nivel pak më të ulët se në vitin paraprak.

Në këtë mënyrë, edhe struktura e financimit ka pësuar ndryshime, veçanërisht në aspektin e afateve të maturimit, të karakterizuara nga rritja e depozitave me afate më të gjata që ofrojnë norma më të larta interesi. Pavarësisht kësaj, hendeku i pozicioneve të rivlerësimit (ri-investimit dhe ri-financimit) është zgjeruar më tej, ndikuar nga rritjet më të theksuara të maturitetit në anën e investimeve.

Grafik 29. Indeksi i agreguar i stabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK.

Rreziku nga normat e interesit i perceptuar gjatë vitit u reduktua dhe perspektiva duket e qëndrueshme. Në këtë kontekst, me ndalimin e rritjes së normave të interesit, pritjet që bankat të fokusojnë sërish aktivitetin e tyre drejt rritjes më të lartë të ofertës kreditorë në vend. Megjithatë, një rënie eventuale e normave të interesit do të ndikojë negativisht në të ardhurat neto nga interesi dhe profitabilitetin e përgjithshëm të sektorit bankar.

Sipas indeksit të përgjithshëm të agreguar të stabilitetit të sektorit, është shënuar një rënie e lehtë vjetore e ndjeshmërisë ndaj rreziqeve (Grafik 29). Kjo rënie e përgjithshme e ekspozimit ndaj rreziqeve është ndikuar nga indikatorët e rrezikut në rënie, si solvenca dhe tregu. Ndërkohë, një rritje marginale e rrezikut është vërejtur te

indikatorët e rrezikut kreditor, profitabilitetit, dhe pak më shumë të likuiditetit. Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të solvencës i atribuohet nivelit më të lartë të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Përmirësimi në pozicionin e kapitalit i atribuohet performancës së mirë gjatë vitit por edhe qasjes kapitalizuese të BQK-së - shpërndarjes së dividendës në nivel shumë më të ulët se një vit më parë (Grafik 30). Indikator i që vlerëson ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut, i matur përmes pozicionit të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë, ka shënuar gjithashtu rënie. Megjithatë, ky indikator ka një peshë shumë të ulët në indeksin e përgjithshëm të stabilitetit financiar.

Grafik 30. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, sipas kriterëve të rreziqeve



Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut kreditor ishte rezultat i rritjes së vlerës së kredive jo-performuese. Megjithatë, rritja e kreditimit ndikoi që raporti i kredive jo-performuese të mbetet i njëjtë me fundin e vitit të kaluar. Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të profitabilitetit i atribuohet rënies së treguesit të kthimit në ekuitet. Kjo për shkak të rritjes më të lartë të ekuitetit nga fitimi i mbajtur nga vitet e kaluara, siç është përmendur më lart, krahas rritjes më të ngadalësuar vjetore të profitit neto gjatë këtij viti (Grafik 30).

Indeksi i përgjithshëm i agreguar sugjeron një rënie të ndjeshmërisë krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa ka një rritje të ndjeshmërisë ndaj rreziqeve në krahasim me vitin 2021 dhe me mesataren historike të indeksit (2008–2022), apo me mesataren e pesë viteve të fundit.

5.1. Rreziku kreditor


Dinamikat e përgjithshme që ndikuan dimensionin e rrezikut kreditor gjatë vitit 2023 u karakterizuan nga rritja e përgjithshme e nivelit të çmimeve, duke ndikuar potencialisht në kostot e financimit dhe eventualisht aftësinë paguese të huamarrësve. Ndërsa pritjet e bankave komerciale sugjeronin materializimin e rrezikut kreditor si pasojë e dinamikave makroekonomike, përkeqësimi i portofolit kreditor u evidentua vetëm në tremujorin e fundit të vitit, por që treguesi i KJP-ve mbeti i njëjtë, pra nuk u materializua ai rrezik i pritur. Ruajtja e performancës së mirë financiare dhe, rrjedhimisht, aftësisë ripaguese, i atribuohet deri në një masë bartjes së një pjesë të ndjeshme të kostove të rritura nga ndërmarrjet tek konsumatorët finalë, ndërsa kapaciteti absorbues i konsumatorëve është mbështetur nga rritja e pagave, të hyrat nga diaspora dhe rritja e aktivitetit ekonomik në disa sektorë.

Edhe pse treguesit kyç të cilësisë së portfolios kreditorë tregojnë për një rrezik të ulët kreditor, rritja e nivelit të çmimeve dhe rritja e vlerës së kredive jo-performuese e mbajtën rrezikun kreditor si rrezik të veçantë për sektorin bankar dhe stabilitetin financiar. Norma e kredive jo-performuese mbeti në të njëjtin nivel prej 2.0 përqind si një vit më parë, ndikuar nga rritja e përshpejtuar e kreditimit, duke qenë se vlera e kredive jo-performuese shënoi rritje vjetore prej 12.2 përqind duke arritur në 98.5 milionë euro (Grafik 31). Rritja e presioneve inflacioniste nxiti bankat për një menaxhim më të kujdesshëm të kreditimit. Në këtë drejtim, bankat u treguan më konservative në ndarjen e rezervave dhe klasifikimin e sektorëve më të prekur, si dhe shtrënguan kriteret për kreditë e reja. Sipas rezultateve të anketës së kreditimit bankar, përkundër besimit në klientë, bankat duke u bazuar në rritjen e vazhdueshme të presioneve inflacioniste gjatë vitit, kishin deklaruar se presin përkeqësim të aftësisë ripaguese të klientëve në gjysmën e dytë të vitit.

Këto pritje u materializuan në tremujorin e katërt, ku vlera e kredive jo-performuese shënoi rritje më të theksuar në krahasim me tre tremujorët paraprakë ndërsa bankat ndanë rezervat e duhura si masa mbrojtëse.

Gjithashtu, kreditë e kategorizuara në shtyllën e dytë shënuan një rritje më të theksuar se kreditë në shtyllën e tretë, dhe kjo rritje erdhi kryesisht nga disa banka. Këto banka kanë kategorizuar disa sektorë ekonomikë në shtyllën e dytë si një masë shtesë mbrojtëse, duke qenë më konservative ndaj sektorëve që kanë treguar ndjeshmëri më të lartë ndaj rrethanave si kriza energjetike në vitin 2022 dhe inflacioni gjatë vitit. Megjithatë, në vitin 2024, me përmirësimin e sentimentit të tregut, shumë prej tyre kanë filluar t'i riklasifikojnë në shtyllën e parë.

Grafik 31. Rritja vjetore e stokut të kredisë dhe kredive joperformuese



Burimi: BQK.


Njëkohësisht, edhe klientët individualë me të ardhura më të ulëta janë kategorizuar në shtyllën e dytë për shkak të rrezikut të perceptuar që efektet e inflacionit kanë në të ardhurat e tyre të disponueshme megjithëse të korrigjuar me rritje të pagave. Ndërkohë, korporatat dhe NVM-të në vend kanë raportuar në forume të ndryshme se një ndër rreziqet kryesore që po afekton performancën e tyre vjen nga tregu i punës (disponueshmëria e fuqisë punëtore dhe hendeku në kualifikimet e saj), rrezik që është paraparë të mbetet më tej në vitin 2024.

Gjatë dy viteve të fundit, bankat kanë marrë parasysh edhe rrezikun potencial nga migrimi, dhe megjithë aprovimin e lëvizjes së

lirë për qytetarët e Kosovës në shtetet e Shengenit që nga fillimi i vitit 2024, ky rrezik nuk u materializua bazuar në të dhënat deri në këtë fazë. Disbalanca në tregun e punës, me pasoja në performancën dhe profitabilitetin e bizneseve dhe, rrjedhimisht, në kapacitetin e tyre për të ripaguar borxhet, bën që dimensionin e rrezikut kreditor të jetë në fokus të veçantë, duke marrë parasysh edhe rritjen e faktorëve që kanë pasoja direkte në përkeqësimin e tij.

Pjesëmarrja e kredive në shtyllën e dytë të klasifikimit kreditor u rrit në 8.3 përqind nga 6.8 përqind një vit më parë, ndërsa kreditë në shtyllën e parë zvogëluan pjesëmarrjen në 89.7 përqind nga 91.2 përqind (Grafik 32).

Grafik 32. Kreditë sipas klasifikimit të ri kreditor në tri shtylla




Burimi: BQK.

Në dhjetor 2023, ekspozimet kreditore pa vonesa (me vonesa më pak se 30 ditë) kanë zvogëluar lehtësisht pjesëmarrjen në 97.4 përqind nga 97.6 përqind. Kreditë me vonesa nga 30 deri në 90 ditë kanë shënuar rritje marginale të pjesëmarrjes prej 0.2 pikë përqindje, duke arritur në 0.6 përqind të totalit të kredive. Ndërsa, kreditë jo-performuese (me probabilitet të ulët të pagesës dhe ato me vonesa mbi 90 ditë) ruajtën pjesëmarrjen e një viti më parë prej 2.0% (Grafik 33).

Ekonomitë familjare shënuan rritje marginale të raportit të kredive jo-performuese, ndërsa segmenti i ndërmarrjeve shënoi rënie të këtij raporti. Raporti i kredive jo-performuese për ekonomitë familjare u rrit në 1.4 përqind nga 1.2 përqind në vitin paraprak.

Grafik 33. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave, metoda e re




Kjo dinamikë është reflektuar në rritjen e vlerës së kredive jo-performuese gjatë vitit 2023, e cila u ngrit për 26.7 përqind mesatarisht përgjatë katër tremujorëve, me një rritje prej 36.1 përqind në fundin e vitit (Grafik 34).

Ndërsa segmenti i ndërmarrjeve shënoi rritje më të ngadalësuar kreditore se një vit më parë, ai arriti të mbajë raportin e kredive jo-performuese në 2.4 përqind, nga 2.5 përqind një vit më parë. Vlera e kredive jo-performuese të këtij sektori u rrit me 5.0 përqind (nga 4.3 përqind në fund të vitit 2023), ndërsa kreditë shënuan një rritje prej 10.1 përqind (nga 15.7 përqind një vit më parë). Sipas AKBK-së, performanca e qëndrueshme financiare dhe, rrjedhimisht, kapaciteti i mirë ripagues i segmentit të ndërmarrjeve i atribuohet bartjes së kostos shtesë të çmimeve furnizuese tek konsumatori përfundimtar.

Zhvillimet në cilësinë e portfolios kreditore, bazuar në raportin e kredive jo-performuese (KJP) të sektorëve ekonomikë, ishin pozitive, të ndikuara kryesisht nga rritja e kreditimit në shumicën e sektorëve ekonomikë, por edhe nga rënia e kredive jo-performuese, përjashtuar sektorin e energjisë (Grafik 35). Sektori i energjisë rezultoi këtë vit me normën më të lartë të KJP-ve, prej 9.4 përqind, një rritje prej 7.2 pikë përqindje. Sektori i prodhimit shënoi rritje më të theksuar të kredive jo-performuese, por për shkak të zgjerimit të kreditimit, norma e KJP-ve mbeti relativisht e qëndrueshme, duke u rritur vetëm me 0.8 pikë përqindje në nivelin 2.2 përqind.

Grafik 34. Kreditë joperformuese




Sektori i tregtisë, i cili përfaqëson sektorin më të kredituar, shënoi rritje të kreditimit prej 10.6 përqind dhe një rënie të vlerës së kredive jo-performuese prej 9.3 përqind. Si rezultat, norma e KJP-ve për këtë sektor u zvogëlua në 1.9 përqind nga 2.3 përqind. Rënie të normës së KJP-ve shënuan edhe sektori i bujqësisë dhe sektori i patundshmërive.

Rreziku i një përkeqësimi të cilësisë kreditore vazhdon të ekzistojë për shkak të rritjes së kostos së shërbimit të borxhit në dy vitet e fundit, duke qenë se përqindja e kredive me norma variable të interesit është rritur në 33.9 përqind nga 27.3 përqind një vit më parë. Megjithatë, pritjet e bankave në anketën e kreditimit lidhur me përkeqësimin e cilësisë kreditore u raportuan në nivele marginale për vitin 2024, bazuar në pritjet për shkallë më të ulët të inflacionit si dhe potencialisht përmirësimin e të ardhurave në dispozicion me rritjen e pagave në disa sektorë, si dhe qasjen më prudente që kanë pasur bankat gjatë vitit 2023 rreth kreditimit të grupeve më të ndjeshme. Po ashtu, sektori i prodhimit dhe i ndërtimit priten të ndikohen nga ndryshimet në strukturën e tregut të punës, i cili do të preket drejtpërdrejt nga migrimi.


Ndërkohë, ekonomitë familjare rezultojnë të jenë ndikuar më së shumti si segment, veçanërisht ato me të ardhura më të ulëta. Prandaj edhe grupet e ekonomive familjare me të ardhura më të ulëta janë ri-klasifikuar në shtyllën e dytë si masë mbrojtëse e disa bankave për ta menaxhuar rrezikun.

Grafik 35. Raporti i KJP-ve ndaj stokut të kredisë, sipas sektorëve



Krahasuar me rajonin, sektori bankar në vend vazhdon të tregojë një performancë shumë më të mirë në ripagimin e kredive. Gjatë viteve, Kosova ka pasur raportin më të ulët të kredive jo-performuese në krahasim me vendet e rajonit (Grafik 36).


Grafik 36. Raporti KJP/gjithsej kreditë në vende të rajonit



Raporti i mbulueshmërisë me provizione të sektorit shënoi rënie prej 4.6 pikë përqindje në nivelin 147.1 përqind. Kjo lëvizje rezultoi nga rritja më e lartë vjetore e vlerës së kredive jo-performuese prej 12.1 përqind se sa i stokut të provizioneve të ndara prej 8.7 përqind (Grafik 37).

Me rritjen e kredive jo-performuese edhe shpenzimet për provizione shënuan rritje prej 72.5 përqind. Megjithatë rritja e kreditimit ndikoi që shkalla e shpenzuar e provizioneve (shpenzimet për provizione ndaj kredive) për sektorin, të ishte lehtësisht më e ulët në dhjetor 2023 (-0.4 përqind) krahasuar me një vit më parë (-0.3 përqind).

Grafik 37. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione



5.1.1 Ekspozimet e mëdha kreditore

Shkalla e ekspozimit kreditor ka shënuar rritje, duke arritur në 69.3 përqind nga 67.7 përqind një vit më parë, megjithëse vazhdon të jetë dukshëm nën nivelin maksimal rregulator. Rritja vjetore e vlerës së ekspozimeve të mëdha prej 2.8 përqind, krahas një rritje më të ulët të kapitalit të klasit të parë prej 0.4 përqind (vetëm për bankat në analizë, përjashtuar degët bankare të cilat kanë ekspozime të mëdha), ndikoi në ngritjen e shkallës së ekspozimit kreditor (Grafik 38).


Koncentrimi i rrezikut kreditor, i shprehur si raport ndërmjet vlerës së ekspozimeve të mëdha ndaj numrit të këtyre ekspozimeve, vlerësohet të jetë i lartë. Vlera mesatare e ekspozimeve të mëdha¹⁷ u rrit në 8.9 milionë euro, nga 7.1 milionë euro, duke reflektuar rritjen e vlerës së ekspozimeve të mëdha dhe zvogëlimin e numrit të tyre. Raporti i tri ekspozimeve më të mëdha ndaj gjithsej ekspozimeve të mëdha kreditore u rrit në 55.2 përqind nga 50.8 përqind. Ky ndryshim u ndikua nga rritja më e lartë vjetore e tri ekspozimeve më të mëdha prej 11.8 përqind, krahas rritjes së përgjithshme të ekspozimeve të mëdha prej 2.8 përqind.

Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë së sektorit ndaj goditjeve në tri dhe pesë ekspozimet më të mëdha të bankave tregojnë ndjeshmëri të sektorit ndaj goditjeve në këto ekspozime. Prandaj, megjithëse sektori

¹⁷ Raporti i gjithsej ekspozimeve të mëdha ndaj numrit të ekspozimeve.

mbetet nën nivelin maksimal rregullator të ekspozimeve kreditore, ai është i ndjeshëm ndaj goditjeve të mundshme në këto pozicione, të cilat duhet të monitorohen nga afër.

Grafik 38. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK.

5.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit


Rritja e normave bazë të interesit nga bankat qendrore është përcjellur nga sektori përveç me rritjen e të hyrave dhe shpenzimeve edhe me ndryshimet në strukturën e investimeve dhe të financimit. Struktura e investimeve është ndikuar në kuptimin e rritjes së investimeve në letra me vlerë të qeverive të huaja, ndërsa financimi ka pësuar ndryshime në aspekt të rritjes së shpenzimeve për nxitje të depozitave dhe rritje të huazimeve në institucione të tjera financiare për të financuar aktivitetin.

Në këtë mënyrë efektet e zhvillimeve monetare e makroekonomike janë ndërë në të dy aspektet e marzhës së profitit të bankave në vend. Megjithëse qëndrueshmëria e profitit të sektorit ishte në favor nga situata e normave të larta të interesit, shpenzimet më të larta të krijuara nga disa banka krahasuar me rritjen e të hyrave ndikuan që profiti i sektorit të ketë rritje më të ngadalësuar prej 10.7 përqind se rritja në vitin paraprak që ishte 19.4 përqind.

Të hyrat nga interesi në kredi dhe letra me vlerë ishin kategoritë që kontribuan në rritjen e realizuar të profitit përderisa shpenzimet administrative dhe ato të

interesit për depozita ndikuan në ngadalësim e kësaj rritje.


Grafik 39. Struktura e profitit të sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK.

Vlera e profitit neto arriti në 155.3 milion euro nga 140.3 milion në vitin paraprak (Grafik 39). Rritja e normave të interesit, nga politika të shtrënguara monetare, përgjatë vitit 2022 dhe nëntë muajt e parë të vitit 2023 është reflektuar në rritjen e të hyrave nga interesi në kredi dhe të hyrave nga interesi në letra me vlerë. Në anën tjetër, edhe shpenzimet e interesit në depozita u afektuan së bashku me rritjen e shpenzimeve administrative dhe të personelit (Grafik 40).

Grafik 40. Kontribuesit kryesor në rritjen / zvogëlimin e profitit




Burimi: BQK.

Të hyrat u rritën për 17.4 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së të hyrave nga interesi në kredi dhe letra me vlerë. Të hyrat nga interesi u rriten për 60.8 milionë euro, gjegjësisht për 23.1 përqind. Të hyrat nga interesi në kredi u rritën për 54.0 milionë euro, apo 24.0 përqind rritje vjetore, dhe të hyrat nga investimet në letra me vlerë u rritën për 8.5 milionë euro apo 48.5 përqind rritje vjetore.

Rrjedhimisht, neto të hyrat nga interesi ishin kontribuesit që ndikuan në rritjen e profitit ndërsa të hyrat neto nga jo-interesi ishin më të ulëta krahasuar me një vit më parë. Të hyrat neto nga interesi u rritën për 19.4 përqind apo 46.0 milionë euro, ndërsa, nga jo-interesi u zvogëluar për 19.0 përqind apo 7.7 milion euro, si rezultat i rritjes së shpenzimeve për provizione.


Grafik 41. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit



Burimi: BQK.

Margjina neto e interesit mbeti e ngjashme, rritje vjetore për 0.1 pikë përqindje në 4.7 përqind, që i atribuohet më shumë efektit të normave të interesit – pra të hyrave neto nga interesi në pozicione që sjellin interes (19.4 përqind rritje vjetore) se i efektit sasior - rritjes së stokut të pozicioneve që sjellin interes (15.1 përqind rritje vjetore) (Grafik 41).

Grafik 42. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit




Burimi: BQK.

Rritja e të hyrave nga letrat me vlerë u ndikua nga kushtet e favorshme për investime në tregjet e jashtme, gjë që ka nxitur bankat e vendit të zgjerojnë portfolion e investimeve në këto instrumente. Investimet në tregjet e jashtme u rritën për

38.1 përqind, ndërsa investimet në letra me vlerë në vend shënuan rënie prej 16.1 përqind, ndikuar gjithashtu nga rëina e ofertës së Qeverisë.

Të hyrat nga jo-interesi (tarifat dhe komisionet si dhe të ardhurat tjera operative) shënuan rritje prej 3.2 përqind krahasuar me rritjen prej 8.0 përqind një vit më parë (Grafik 42 dhe 43).


Grafik 43. Struktura e të hyrave të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Të gjitha kategoritë e shpenzimeve janë rritur përgjatë vitit. Rritja e shpenzimeve prej 21.5 përqind (apo për 49.6 milionë euro) u ndikua kryesisht nga rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative prej 21.6 milionë euro, rritja e shpenzimeve për interesa në depozita prej 12.7 milionë euro dhe shpenzimeve për provizione për humbjet e kredive prej 8.5 milionë euro (Grafik 44).

Grafik 44. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Shpenzimet e jo-interesit janë rritur më shumë se në vitin e kaluar, e ndikuar nga shpenzimet për provizione, përderisa, shpenzimet për tarifa dhe komisione u rritën për 2.2 milionë euro.


Shpenzimet e interesit në depozita shënuan rritje prej 58.7 përqind, nga 10.7 përqind në vitin paraprak, dhe ndikimi i rritjes së kësaj kategorie bashkë me shpenzimet administrative, u transmetua në ngadalësim të rritjes së profitit për shkak të efekteve më të larta krahasuar me efektet pozitive të kategorive të tjera në realizimin e profitit.

Indikatorët e profitabilitetit u ndikuan nga dinamika e profitit. Kthimi mesatar në asete mbeti në nivelin e njëjtë të një viti më parë prej 2.5 përqind ndërsa kthimi mesatar në kapital u zvogëlua në 22.0 përqind, nga 23.0 përqind një vit më parë, për shkak se ekuiteti i mbajtur kishte rritje më të lartë se profiti i realizuar gjatë vitit (Grafik 45).

Këto nivele janë mbi mesataren e bankave të rajonit që shënuan normë të kthimit në asete prej mesatarisht 2.3 përqind dhe normë të kthimit në kapital prej 17.1 përqind. Të gjitha vendet e rajonit shënuan rritje në treguesit e profitabilitetit gjatë këtij viti, gjë që ka zvogëluar dallimin mes mesatares së Kosovës dhe këtyre vendeve.¹⁸

Profiti i sektorit bankar karakterizohet nga pasiguritë e rritura për bankat në aspekt të mundësive të tyre për të realizuar të hyra në nivelet aktuale, në rrethanat që normat e interesit janë duke marrë trend rënës. Në anën tjetër, konkurrenca në rritje pritet të shtoj presionin në kostot e financimit, përkundër rënies së përgjithshme të normave të interesit.

Grafik 45. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.

5.2.1 Rreziku ndaj luhatjeve të normave të interesit

Ekspozimi i sektorit bankar të Kosovës ndaj rrezikut të ndryshimeve në normat e interesit ka evoluar si rezultat i rritjes së pjesëmarrjes së kredive me normë variable të interesit. Ky zhvillim ka kontribuar në një shkallë në transferimin e këtij rreziku tek klientët, duke ulur në një masë ekspozimin direkt të bankave. Ndërkohë që ekspozimi direkt i sektorit ndaj ndryshimeve në norma të interesit është rritur për shkak të

zgjerimit të hendekut kumulativ të maturitetit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve që bartin interes. . Ky zhvillim është ndikuar nga rritja e investimeve në letra me vlerë me maturitet afatgjatë, ndërkohë që sektori bankar ende mbështetet në depozita me afat relativisht të shkurtër maturimi. Megjithatë, gjatë vitit 2023 është shënuar një rritje e konsiderueshme e depozitave në afate më të gjata, duke përmirësuar në një masë të caktuar hendekun në disa kategori të afateve të maturitetit ndërmjet burimeve dhe investimeve të sektorit bankar.

Hendeku kumulativ ndërmjet aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit në vitin 2023 është zgjeruar në 1,426.2 milionë euro (apo 0.17 përqind e ekuitetit), nga 1,068.4 milionë euro në vitin paraprak (0.15 përqind e ekuitetit). Asetet me ndjeshmëri ndaj normave të interesit dominojnë në shumicën e kategorive të maturimit, përveç afatit “1-5 vite”, ku detyrimet janë më të mëdha, sidomos për maturitetin 4-5 vite. Kjo është ndikuar nga rritja e afatizimit të depozitave, të cilat ofrojnë norma më të larta kthimi.

Asetet me ndjeshmëri ndaj normave të interesit kanë shënuar rritje më të lartë në periudhat e maturimit “31-365 ditë” dhe “1-30 ditë,” kryesisht për shkak të rritjes së

¹⁸ Në vendet e rajonit përfshihen Shqipëria, Serbia, Bosnja dhe Herzegovina, Maqedonia Veriore dhe Mali i Zi. Burimi i informacionit

është databaza e Treguesve të Shëndetit Financiar të FMN-së dhe bankat qendrore përkatëse.

parasë së gatshme në bilancet e bankave. Në të njëjtën kohë, detyrimet kanë shënuar rritje më të madhe në periudhën “1-5 vite”, për shkak të zgjerimit të afatizimit të depozitave.

Bilanci i gjendjes së sektorit bankar në Kosovë karakterizohet kryesisht me norma fikse interesi duke qenë i ndikuar nga lëvizjet e normave të interesit kryesisht në maturim të këtyre pozicioneve. Sidoqoftë, niveli i kredive me normë fikse ndër vite është në rënie, në favor të rritjes së kredive me norma variabile, veçanërisht në dy vitet e fundit ku nga 27.3 përqind e kredive që përbëhej me norma variabile të interesit, proporcioni është rritur në 33.9 përqind në vitin 2023.

Në anën tjetër rritja e normave të interesit ndikoj që rifinancimi i depozitave të bëhet me kosto më të lartë duke rritur presionin në shpenzimet e sektorit, meqë pjesa më e madhe e kategorisë kryesore të aseteve, kreditë, janë kontraktuar me normë fikse të interesit dhe kanë maturitet më të gjatë. Nëse analizojmë vetëm kreditë dhe depozitat, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të bilancit të bankave, hendeku kumulativ ndërmjet tyre për grupin me afat maturimi ‘1-5 vite’ rezulton negativ, si pasojë e nivelit më të lartë të depozitave.


Krahasuar me vitin paraprak, hendeku pozitiv ndërmjet aseteve dhe detyrimeve u zgjerua për të gjitha afatet e maturimit përveç hendekut në afat maturimi “mbi 5 vite”, ndërsa hendeku negativ për kategorinë me afat maturimi “1 deri në 5 vite” u thellua tutje si rezultat i rritjes më të lartë të detyrimeve me këtë afat maturimi krahasuar me rritjen e aseteve (Grafik 46).

Ky zgjerimi i hendekut mund të paraqes rritje të ekspozimit ndaj rrezikut në luhatjen e normave të interesit. Ndërsa, rritja e pjesëmarrjes së kredive me norma variabile e zhvendos një pjesë të rrezikut të normave të interesit nga bankat tek huamarrësit, duke e bërë sektorin bankar më të ndjeshëm ndaj rrezikut kreditor në menyre indirekte.

Në periudhën vijuese, rënia potenciale e normave të interesit mund të afektoj

negativisht të hyrat e sektorit menjëhershëm nga kreditë por edhe nga mundësitë e riinvestimit të këtyre mjeteve në maturim. Gjithashtu, megjithëse detyrimet e përshtatin më shpejt koston e fondeve me normat e tregut, rrethanat e rritjes së konkurrencës për financim nga depozitat mund të ndikojnë negativisht në shpenzimet e sektorit.

Grafik 46. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit



Burimi: BQK.


5.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të ndryshimeve në kurset valutore është zvogëluar dukshëm krahasuar me vitin paraprak. Pozicioni i agreguar neto i hapur për të gjitha valutat e huaja zbriti në 5.4 milion euro (ekuivalente) nga 14.9 milion euro, që konsiston në raport prej 0.7 përqind të kapitalit të klasit të parë krahasuar me 2.4 përqind sa ishte në vitin 2022 (Grafik 47). Rënia e pozicioneve të agreguara në valutë të huaj rezultoj nga reduktimi i ekspozimeve ndaj valutës britanike dhe dollarit amerikan.

Sipas valutave të veçanta, pozicioni neto ndaj kapitalit të klasit të parë për dollarin amerikan dhe funtën britanike rezulton në territor pozitiv, por më i ngushtuar në krahasim me vitin e kaluar si rezultat i rënies vjetore të pozicioneve të aseteve në këto valuta. Kjo do të thotë se sektorit bankar i është reduktuar beneficioni nga një zhvlerësim i mundshëm i euros ndaj këtyre valutave. Ndërsa frangu zviceran kaloi në territor negativ për shkak të nivelit më të lartë të rritjes së detyrimeve në këtë valutë.

Kjo do të thotë se sektorit bankar i është rritur ekspozimi ndaj rrezikut që efekti i zhvlerësimit të mundshëm të euros ndaj kësaj valutave mund të ketë në humbjet e sektorit.


Grafik 47. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë



Burimi: BQK.

Raporti i pozicioneve neto të hapura për çdo valutë individuale ndaj kapitalit të klasit të parë vazhdon të mbetet mjaft nën nivelin maksimal prej 15 përqind të lejuar sipas rregullores përkatëse.

Grafik 48. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj



Burimi: BQK.

Prandaj, luhatjet valutore kanë ndikim marginal në gjendjen financiare të sektorit, marrë parasysh nivelin mjaft të ulët të pozicioneve të hapura në valuta të huaja. Për më tepër, edhe rreziku i tërthortë kreditor nga ekspozimi në valutë mbetet i ulët duke qenë se kreditë në valutë mbeten në nivel marginal.

Kreditë në valutë të huaj kanë pjesëmarrje prej vetë 0.2 përqind, dhe shënuan rënie prej

1.1 milionë euro nga viti paraprak. Depozitat në valutë gjithashtu kanë pjesëmarrje të ulët, 3.4 përqind, ndërsa u rriten për 38.6 milionë euro nga viti paraprak (Grafik 48).

5.4. Kapitali

Performanca e mirë financiare e sektorit, mundësoi që raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit¹⁹ të jetë më i lartë se në vitin paraprak për shkak të kapitalizimit të sektorit, përkundër rritjes dyshifrore të kreditimit, përkatësisht të aseteve të peshura me rrezik.

Norma e kapitalit u rrit në 17.4 përqind, nga 15.5 përqind një vit më parë, ku kryesisht bankat me rëndësi sistematike, përfshirë edhe një bankë vendore, kanë normë më të lartë të kapitalizimit. Gjithsesi, varianca midis TMK-së së bankave individuale dhe mesatares së sektorit bankar ka shënuar rënie, duke treguar një përafrim të TMK-së ndaj mesatares së sektorit. Ky përmirësim ka ardhur kryesisht për shkak të fitimeve të realizuara dhe të mbajtura, si dhe nga shpërndarja më e ulët e dividendëve, duke ruajtur kapitalin brenda sektorit.

Në të njëjtën kohë, rreziqet makroekonomike dhe gjeopolitike që kanë krijuar një ambient pasigurie, dhe bëjnë edhe më të domosdoshme rritjen e rezistencës ndaj goditjeve potenciale. Tendencat globale sugjerojnë se, për shkak të sfidave në parashikimin e rreziqeve, është e rëndësishme që bankat të shfrytëzojnë periudhën aktuale të profitabilitetit të lartë për të rritur nivelet e kapitalit rregullator i cili, në rastin e Kosovës, është më i ulët në krahasim me rajonin dhe Bashkimin Evropian.


Sektori, duke qenë se burim kryesor të rritjes së kapitalit e ka fitimin e mbajtur, ka kualitet të lartë të kapitalit rregullativ ku 89.3 përqind e tij përbëhet nga kapitali i klasit të parë. Pjesën më të madhe të këtij

¹⁹ Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit duhet të jetë në çdo kohë mbi nivelin 12 përqind ndaj Aseteve të peshuara me rrezik. Kapitali bazë i klasit të parë duhet të jetë në çdo kohë së paku 4.9 përqind

të APR-ve, ndërsa Kapitali rregullativ i klasit të parë duhet të qëndrojë minimalisht në 9 përqind në raport me APR-të.

kapitali, 62.8 përqind, e përbën profiti i mbajtur. Treguesi i kapitalit të klasit të parë ndaj asetëve të peshuara me rrezik, në dhjetor 2023 qëndroi në 15.6 përqind, në nivel më të lartë se në vitin e kaluar (Grafik 49).


Grafik 49. Kapitalizimi i sektorit bankar



Burimi: BQK.

Rritja e asetëve me peshë rreziku kontribuoi me 1.8 pikë përqindje në rënien e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, ndërkohë që rritja e kapitalit rregullator kontribuoi në rritjen e TMK-së për 3.7 pikë përqindje (Grafik 50). Efekti më i lartë i rritjes së kapitalit se i rritjes së asetëve të peshuara me rrezik dha kontribut më të lartë rritës në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit, prej 1.9 pikë përqindje.

Grafik 50. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit




Burimi: BQK.

Të gjitha kategoritë e kapitalit rregullativ shënuan rritje. Rritjen më të lartë, pas fitimit

të mbajtur nga vitet paraprake, e shënuan fitimi i vitit aktual, vlera e emrit të mirë, kapitali aksionar, si dhe të ardhurat tjera dhe fondet rezervë²⁰ (Grafik 51). Në kategorinë e profitit, efektin më të madh e pati fitimi i mbajtur, i cili u rrit me 70.7 përqind, ndërsa fitimi i vitit aktual u rrit me 29.5 përqind.


Grafik 51. Struktura e kapitalit rregullator



Burimi: BQK.

Indikatori i levës financiare (raporti i kapitalit të klasit të parë ndaj ekspozimeve pas korigjimeve rregullative) në dhjetor 2023 qëndroi në 9.8 për qind, nga 9.3 për qind një vit më parë (Grafik 52).

Grafik 52. Norma e levës



Burimi: BQK.

Ky raport qëndron lart mbi minimumin prej 3.0 përqind sipas Rregullores së BQK-së për Treguesin e Leverazhit që bazohet në kornizën e Basel III për levën financiare.²¹


²⁰ Other Comprehensive Income - një shembull i zakonshëm i OCI (të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse) është një portfol i obligacioneve që ende nuk kanë maturuar dhe për rrjedhojë nuk janë shlyer. Fitimet ose humbet nga ndryshimi i vlerës së obligacioneve nuk mund të përcaktohen plotësisht deri në kohën e

²¹ Sipas Basel III, norma e levës llogaritet si raport ndërmjet kapitalit të klasit të parë dhe ekspozimeve pas ndryshimeve rregullative. Kjo normë duhet të jetë e barabartë apo mbi 3 përqind. BQK filloi llogaritjen e kësaj norme, sipas standardit të Basel III, nga viti 2020.

Në kuadër të aseteve të peshuara me rrezik, ato për rrezik kreditor shënuan normë të rritjes prej 13.4 përqind, krahasuar me rritjen prej 17.1 përqind një vit më parë, duke ndjekur ecurinë e rritjes më të ngadalësuar të kreditimit.

Asetet e peshuara për rrezik operacional shënuan rritje prej 12.6 përqind nga 7.4 përqind. Pjesëmarrja e aseteve të peshuara sipas rreziqeve mbetet e ngjashme, me 93.7 përqind të APR-ve të peshuara për rrezik kreditor, 6.3 përqind për rrezik operacional dhe pjesë shumë e ulët, 0.01 përqind për rrezik të tregut (Grafik 53).²²


Grafik 53. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej aseteve të sektorit



Burimi: BQK.

Asetet e peshuara për rrezikun kreditor (Grafik 54) shënuan vlerën 4.9 miliardë euro (4.3 miliardë në vitin 2022). Në kuadër të këtyre aseteve dominojnë kreditë individuale dhe të ndërmarrjeve me 54.6 përqind, pasuar nga ekspozimet ndaj korporatave me 15.8 përqind.

Grafik 54. Asetet e peshuara me rrezik kreditor, pjesëmarrja




Burimi: BQK.

Kreditë hipotekare të mbështetura me pronë të paluajtshme komerciale dhe me pronë të

paluajtshme rezidenciale kanë pjesëmarrje prej 10.3 dhe 6.4 përqind respektivisht. Ekspozimi ndaj bankave tjera, qeverive dhe bankave qendrore ishte relativisht i ulët prej 3.8 përqind dhe 1.8 përqind respektivisht.

Ekspozimet tjera të mbetura përbëjnë 7.4 përqind të ekspozimeve, që përfshijnë autoritetet lokale, sektorin publik, bankat zhvillimore, organizatat ndërkombëtare (Grafik 55).

Grafik 55. Klasat e aseteve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK.


Sipas peshës së rrezikut, kategoria e peshuar me 100 përqind, që përbën edhe kategorinë me peshën më të theksuar në gjithsej asetet me rrezik (79.3 përqind) dhe që përfshinë ekspozime ndaj individëve dhe NVM-ve (retail), kredi ndaj korporatave dhe kredi hipotekare të mbështetura me pronë komerciale, shënoi rritjen më të theksuar këtë periudhë prej 513.6 milionë euro (Grafik 55 dhe 56).

Kategoria e aseteve me peshë rreziku 50% që përfshinë kreditë hipotekare e mbështetur me pronë të paluajtshme rezidenciale dhe ekspozimin ndaj institucioneve financiare, shënoi rritje vjetore prej 87.0 përqind. Kategoria e aseteve me peshë rreziku 20 përqind që përfshinë kreditimin ndaj institucioneve financiare, qeverive dhe bankës qendrore, shënoi rritje për 27.7 përqind. Ky zhvillim sugjeron për rritje më të lartë të kreditimit në segmentin retail-për individët, korporatat si dhe kreditimin

²² Asetet e peshuara për rrezik të tregut u raportuan për herë të parë me fillim nga vitin 2020, sipas formatit të ri të raportimit të kërkuar nga BQK.

hipotekar të mbështetura me pronë komerciale (Grafik 55 dhe 56).

Grafik 56. Struktura e APR-ve për rrezik kreditor, sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK.

5.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit

Sistemi bankar mbetet i qëndrueshëm në aspektin e likuiditetit, me treguesit kryesorë brenda kërkesave rregullative, kryesisht të mbështetur nga rritja e depozitave të sektorit privat. Megjithatë, rritja e normave të interesit gjatë vitit ka krijuar sfida në lidhje me kostot e financimit dhe ruajtjen e pozicionit të likuiditetit.

Rritja e depozitave ishte më e theksuar në fillim të vitit 2023, krahasuar me vitin paraprak, por ky trend filloi të ngadalësohej drejt fundit të vitit, e ndikuar nga tërheqja e depozitave më të mëdha nga një numër i vogël i korporatave, si dhe tërheqja në shuma më të vogla nga individët. Kjo mund të ndërlikohet me nevojat e shtuara për financim të konsumit me kosto të rritur, si dhe potencialisht me pritshmëritë për mos-rritje të mëtejshme të normave të interesit.


Ndërsa treguesit e likuiditetit në nivel sektori tregojnë qëndrueshmëri, ekzistojnë ende dallime në tepricat e likuiditetit midis bankave individuale, dhe si rrjedhojë, në aftësinë e tyre për të përballuar pasojat e ndonjë materializimi të rrezikut të financimit.

Pozita e likuiditetit të sektorit përgjatë vitit u mbështet nga rritja e vazhdueshme e depozitave, veçanërisht të sektorit privat. Depozitat e ekonomive familjare, të cilat karakterizohen nga një natyrë më stabile për

shkak të qëllimit të tyre parësor si 'kursim/ruajtje' e mjeteve, kanë kontribuar në qëndrueshmëri të likuiditetit. Bankat gjithashtu kanë hapsirë të përmbushin nevojat e mundshme për likuiditet përmes mekanizmave të tjerë, si menaxhimi i rezervave të likuiditetit, marrëveshjet ndërbankare për likuiditet, dhe financimi nga bankat amë (Grafik 57).

Megjithë nivelin e lartë të likuiditetit në sektor, shumica e bankave kanë shënuar rënie të raportit të likuiditetit (LCR, NSFR) krahasuar me vitin e kaluar, përkundër se janë dukshëm mbi nivelin e kërkuar rregullator.

Grafik 57. Struktura e financimit



Burimi: BQK.

Kjo rënie rrjedhë nga rritja më e lartë e detyrimeve afatshkurtëra, e mbështetur edhe nga rritja më e përshpejtuar e depozitave në gjysmën e parë të vitit. Katër banka kanë raportuar rritje të raportit të likuiditetit, ndërsa disa të tjera mbeten më të ndjeshme për shkak të strukturës së bilancit dhe burimeve më të kufizuara të financimit, duke qenë më pak fleksibile për të vepruar në një ambient me norma të rritura të interesit. Nga ana tjetër, treguesi i mbulimit me likuiditet (LCR), i cili ka filluar të raportohet që nga viti 2023, qëndron në një nivel të lartë, megjithëse me dallime të theksuara ndërmjet bankave sa i përket nivelit të treguesit dhe tepricës së likuiditetit.


Depozitat e transferueshme kanë vazhduar të rriten dhe mbesin kategoria dominuese e depozitave. Ndërkohë, nën ndikimin e normave më të larta të interesit gjatë vitit, edhe pjesëmarrja e depozitave të afatizuara është zgjeruar, megjithëse me ritëm më të ngadalshëm se vitin paraprak.

Rritja e vazhdueshme e kreditimit afatgjatë dhe pjesëmarrja ende e lartë e depozitave me afat relativisht më të shkurtër të maturimit kanë kontribuar në theksimin e mospërputhjeve midis aseteve dhe detyrimeve në disa kategori të afateve të maturimit. Megjithatë, indikatorët kryesorë të likuiditetit²³ japin sinjale pozitive për gjendjen aktuale të likuiditetit bankar, ku niveli i lartë i rezervave të likuiditetit që bankat mbajnë në BQK, si dhe i gjithsej aseteve likuide, e bën sektorin rezistent ndaj efekteve të mundshme negative që mund të rezultojnë nga mospërputhjet e afateve të maturimit midis investimeve dhe financimit.

5.5.1 Financimi bankar

Këtë vit depozitat tejkaluan kreditë për 124.7 përqind, tregues që u zvogëlua për 3.0 pikë përqindje nga viti paraprak, për shkak të rritjes më të lartë të kreditimit krahasuar me rritjen e depozitave (Grafik 58).

Grafik 58. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar



Burimi: BQK.


Gjatë nëntë muajve të parë të vitit, rritja e gjithsej depozitave ishte e përsheptuar, e nxitur nga normat atraktive të interesit, por më pas ky trend u ngadalësua. Depozitat e ekonomive familjare u rritën më shpejtë, ndërsa depozitat e ndërmarrjeve ngadalësuan ritmin e tyre të rritjes, me një sezonalitet më të theksuar gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë, ku gushti pati nivelin më të lartë të depozitimit (Grafik 58).

Depozitat e institucioneve të tjera financiare dhe të qeverisë shënuan rritje, ndërsa ato të korporatave të tjera publike shënuan rënie.

Struktura e gjithsej depozitave sipas afatit të maturimit mbetet e demoniar nga depozitat e transferueshme, me pjesëmarrje 63.8 përqind, çka rritë ndjeshmërinë e sektorit ndaj rrezikut të likuiditetit si rezultat i mospërputhjeve të larta në afatet e maturimit.

Megjithatë, depozitat e afatizuara u karakterizuan me rritjen më të theksuar prej 15.9 përqind, një dinamikë që rezultoi në rritjen e pjesëmarrjes së këtyre depozitave në 26.1 përqind, nga 24.8 përqind që ishte vitin e kaluar (Grafik 59). Mospërputhjet midis afateve të maturimit të depozitave dhe kredive janë të theksuara veçanërisht për afatet 'deri në 1 vit' dhe 'mbi 2 vite'. Depozitat me maturim mbi 2 vite rritën pjesëmarrjen e tyre në strukturën e depozitave të afatizuara në 52.5 përqind, ndërsa kreditë me maturim prej 5-10 vitesh përbëjnë 37.7 përqind të gjithsej kredive (Grafik 59).

Grafik 59. Struktura e depozitave




Burimi: BQK.

Pjesëmarrja e lartë e depozitave të transferueshme dhe rritja e kërkesave për financim të qëndrueshëm e nënvizojnë rëndësinë e praktikave prudente të bankave rreth mundësive të tyre të financimit dhe kostove përcjellëse kundrejtë aktivitetit të tyre të rritur kreditor dhe financiar.


²³ Nga viti 2023, bankat kanë filluar të raportojnë edhe treguesin e mbulimit me likuiditet (LCR) si dhe treguesin e financimit të qëndrueshëm neto (NSFR) sipas Basel III.

Grafik 60. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit



Gjatë vitit, sektori rriti financimin nga borxhi i ndërvarur. Megjithatë, përderisa financimi nga jashtë është në nivel të ulët dhe konkurrenca për depozita e lartë, kostot e financimit mbesin sfidë për aktivitetin e bankave. Raporti i financimit të qëndrueshëm neto (NSFR) në fund të vitit ishte në nivelin 150.3 përqind, duke reflektuar se sektori megjithatë ka menaxhuar të mbajë raport të financimit të qëndrueshëm në dispozicion ndaj atij të nevojshëm më lartë se niveli minimal rregullator prej 100 përqind, me dallime më të theksuara ndërmjet bankave të mëdha dhe atyre më të vogla.

Grafik 61. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive



Treguesi qëndroi në nivele më të ulëta tek bankat të cilat janë në fillim të aktivitetit ose ishin të sfiduara në treg nga konkurrenca për depozita.


5.5.2 Rreziku i Likuiditetit

Në vitin 2023, raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra zbriti në 34.7 përqind, nga 36.5 përqind në vitin 2022. Ky rezultat u ndikua nga rritja më e lartë e

detyrimeve afatshkurtra krahasuar me rritjen e aseteve likuide, të cilat u rritën me 10.0 përqind (ose 490.7 milionë euro), ndërsa asetet likuide u rritën me 4.6 përqind (ose 82.0 milionë euro).

Kapaciteti i lartë për të mbuluar daljet neto të likuiditetit gjatë një periudhe stresi afatshkurtër është rritur deri në fund të vitit 2023. Raporti i mbulimit të likuiditetit (TML-LCR) u rrit me 23.8 pikë përqindjeje që nga gushti dhe 51.5 pikë përqindje nga fillimi i raportimit në janar 2023, duke arritur në 279.7 përqind në fund të vitit, dhe mbetet lartë mbi kërkesën rregullatore prej 100 përqind (Grafik 62).

Grafik 62. Treguesi i Mbulimit me Likuiditet - Liquidity Coverage Ratio (LCR)



Niveli i lartë i raportit TML-LCR mbështetet kryesisht nga rezerva e lartë e likuiditetit, e cila këtë vit përbëhet kryesisht nga letrat me vlerë të qeverive vendore dhe të huaja (41.5 përqind), si dhe nga paraja e gatshme dhe rezervat në bankën qendrore. Rritja e investimeve në letra me vlerë qeveritare, e nxitur nga normat më të larta dhe atraktive të kthimeve, rriti shtesën e likuiditetit më shumë sesa rritja e daljes neto të likuiditetit, që ishte një faktor kryesor në përmirësimin e LCR-së. Rezerva e likuiditetit u rrit me 23.6 përqind, dhe rrjedha dalëse neto u rrit për 0.8 përqind krahasuar me të dhënat në fillim të raportimit në muajin janar 2023.


Raporti i ngushtë i likuiditetit, i cili përfshin vetëm asetet shumë likuide (paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, llogaritë rrjedhëse dhe plasmanet), në raport me detyrimet afatshkurtra, zbriti lehtësisht në

27.6 përqind nga 29.3 përqind një vit më parë, për shkak të rritjes më të lartë të detyrimeve krahasuar me asetet shumë likuide.

Raporti i aseteve likuide ndaj gjithsej aseteve zbriti në 25.6 përqind nga 27.1 përqind në vitin 2022, pasi asetet u rritën më shpejtë se asetet likuide (Grafik 63).

Rritja e aseteve likuide gjatë periudhës u ndikua kryesisht nga rritja e investimeve në letra me vlerë të tregtueshme të qeverive të huaja për 92.1 milionë euro (një rritje prej 36.5 përqind) dhe depozitave me maturitet afatshkurtër deri në 30 ditë, të plasura në banka jashtë vendit, për 99.1 milionë euro. Gjithashtu, një kontribut të rëndësishëm dha edhe rritja prej 38.1 milionë euro e parasë së gatshme.

Grafik 63. Indikatorët e likuiditetit



Burimi: BQK.

Ndërsa, efekt zbritës në mjete likuide pati kategoria e investimeve në obligacione të qeverisë së Kosovës, e cila u zvogëlua për 40.6 milionë euro (rënie vjetore prej 20.9 përqind), llogaritë rrjedhëse me bankat, që u zvogëluan për 69.8 milionë euro apo 32.6 përqind, si dhe depozitat dhe plasmanët në bankat vendore, që u zvogëluan për 24.6 milionë euro apo 30.9 përqind.


Në fund të dhjetorit rezervat e likuiditetit të bankave vazhdojnë të jenë në nivele të larta, duke tejkaluar për 49.99% shumën e rezervës së obliguar (10%) që duhet të mbahet në formë likuide në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK)

Transmetimi i ndryshimeve në normat bazë të interesit nga BQE është reflektuar

pjesëshëm në segmente të tregut financiar në vend, duke ndikuar edhe normën e depozitave me të cilën BQK ngarkon depozituesit e saj. Niveli i normës varet nga normat që bankat e eurozonës aplikojnë për BQK-në, si dhe nga kthimet e investimeve në portfolion aktuale të investimeve. Rrjedhimisht, me rritjen e normave të interesit në nivel global, BQK ka filluar të aplikojë normë pozitive të interesit në vitin 2023 për bankat komerciale, e aplikueshme në rezervat minimale të mbajtura në BQK. Aktualisht, kjo normë qëndron në 0.3 përqind.

Niveli i tepricës së rezervave bankare nuk ka pësuar ndryshime të mëdha nga viti paraprak, duke tejkaluar rezervën minimale për 50.0 përqind nga niveli prej 49.2 përqind që ishte në vitin 2022. Ky nivel mbetet më i ulët se në vitin 2021, kur ishte 68.3 përqind, duke reflektuar dinamikat e rritjes së kreditimit dhe investimeve në letra me vlerë (Grafik 64).

Grafik 64. Rezervat e likuiditetit



Burimi: BQK.

Gjatë vitit 2023, afatizimi i depozitave u bë më atraktiv për shkak të normave më të larta të ofruara në treg, një zhvillim që rezultoi zgjerim shumë më të ulët të hendekut pozitiv në grupin me afat maturimi "1-5 vite", krahasuar me kategoritë tjera të afateve të maturimit. Ky zgjerim më i ulët u ndikua nga rritja më e lartë e detyrimeve prej 14.0 përqind dhe rritja më e ulët e aseteve prej 5.5 përqind në këtë kategori të afatit të maturimit.


Mospërputhjet e afateve të maturimit ndërmjet investimeve dhe financimit në disa

kategori të afateve të maturimit u rriten më tej, përderisa afatet e maturimit të depozitave po zgjerohen, dhe kreditimi afatgjatë është në rritje. Kjo lëvizje ka shtuar sfidat në menaxhimin e likuiditetit. Hendeku kumulativ i likuiditetit në vitin 2023 u zgjerua në 963.6 milionë euro, nga 709.6 milionë euro një vit më parë. Ky rezultat u ndikua kryesisht nga zgjerimi i hendekut pozitiv ndërmjet asetëve dhe detyrimeve në të gjitha afatet e maturimit, përveç grupit me maturitet “1-7 ditë”.

Hendek negativ ndërmjet asetëve dhe detyrimeve mbetet në afatin e maturimit “1-7 ditë”. Pjesëmarrja e lartë e depozitave të transferueshme në gjithsej detyrimet e sektorit bën që 71.3 përqind e detyrimeve të kategorizohen në afatin “1-7 ditë,” ndërsa asetet me këtë afat përbëjnë vetëm 20.0 përqind të gjithsej asetëve.

Ndërkohë, hendeku më i zgjeruar pozitiv mbetet në afatin e maturimit “1-5 vite,” ku rreth 36.2 përqind e asetëve kategorizohen me këtë afat, në krahasim me detyrimet e këtij afati të maturimit që përbëjnë 14.0 përqind të gjithsej detyrimeve. Megjithatë kjo kategori pati zgjerimin më të ulët krahasuar me kategoritë e tjera të maturimit të përmendur edhe më lartë. .

Grafik 65. Hendeku i likuiditetit



Burimi: BQK.

Mospërputhjet e afateve të maturimit të

zërave bilancor mbesin më të theksuara në kategoritë e maturimit “1-7 ditë” dhe “1-5 vite” (Grafik 65). Duke qenë se hendeku është zgjeruar në këto dy kategori krahasuar me vitin e kaluar, sfidat mbeten në sigurimin e financimit dhe atë më afatgjatë, në një ambient konkurrues për mbështetjen e kreditimit afatgjatë dhe të investimeve të tjera.

5.6. Kapaciteti absorbues i goditjeve - analiza Stress-Test²⁴


BQK është në proces tranzicioni në aspekt të kornizës së stress-testit të rrezikut kreditor dhe atij të likuiditetit, duke kaluar në një model më të avancuar për t’iu përshtatur nevojave të politikbërjes makroprudenciale dhe sinjalizimit të hershëm mbi rreziqet e ardhshme. Modeli paraprak i stress testit, përkatësisht komponenta e stress-testit për rrezikun kreditor, ka analizuar ndjeshmërinë e sektorit bankar ndaj tronditjeve përmes koeficientit të elasticitetit ndërmjet hendekut të BPV-së dhe rritjes së kredive joperformuese. Megjithatë, kjo qasje është e limituar në vlerësimin e tronditjeve të ndërlikuara makrofinanciare që lidhen me kushtet makroekonomike.

Ndaj, me asistencën teknike nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), BQK po punon në ndërtimin e një kornize të re stress-testi të rrezikut kreditor që përfshin qasje më të avancuar, duke përfshirë tri shtylla kryesore (Diagram 1), që produkt final kanë efektin në bilancin dhe pozitën kapitale të bankave. Kjo kornizë e re do të integrojë ndikimet e tronditjeve makrofinanciare për të dhënë një pamje më të plotë dhe të saktë të rreziqeve me të cilat përballet sistemi bankar. Me këtë ndryshim, BQK synon të forcojë mbikëqyrjen dhe qëndrueshmërinë e sektorit bankar në një mjedis gjithnjë e më kompleks financiar.

²⁴ Stress Test nuk përfaqëson një model parashikimi, por përmban skenarë të supozuar të goditjeve makroekonomike dhe financiare me qëllim të matjes së rezistencës së sektorit bankar ndaj këtyre

goditjeve negative, pa paragjykimë që situata të tilla mund të ndodhin apo priten të ndodhin në të ardhmen.

1. Bllok diagrami Korniza e Stress Testi Makroprudencial



Diagrami i adaptuar nga Henry and Kok; [A macro stress testing framework for assessing systemic risks in the banking sector \(europa.eu\)](#); ECB Occasional Paper 152

Shtylla e parë e kornizës së re përfshin ndërtimin e skenarëve makrofinanciarë, të cilët bazohen në parashikime për gjendjet e ardhshme të ekonomisë. Këto parashikime, që mbulojnë një horizont 3vjeçar, përfshijnë një skenar bazë me kushte të pritshme ekonomike dhe një skenar negativ me probabilitet më të ulët ndodhjeje, por të arsyeshëm dhe të shpjegueshëm. **Shtylla e dytë**, "Modelet Satelitore," përkthen skenarët makroekonomikë në ndikime në rrezikun kreditor (probabilitetin e dështimit – PDs), të ardhurat neto nga interesi dhe fitimet/humbjet nga tregu. Ky transmetim i goditjeve makroekonomike ndikon portofolin kreditor, performancën e bankave dhe instrumentet e tregut. **Shtylla e tretë** prezanton "Qarkun e Reagimit" (feedback loop), i cili përfshin kombinimin e fitimeve/humbjeve të parashikuara nga skenarët makrofinanciarë dhe efektet e tyre në pozicionin kapital të bankave. Përderisa komponenta e stress-testit të rrezikut kreditor është ende punë në process, komponenta e stress testit të likuiditetit është finalizuar, dhe shpjegimi i kornizës dhe rezultateve prezantohet në vijim.

Stress Test për Rrezikun e Likuiditetit

Me avancimin e kornizës rregullative mbikëqyrse sipas kërkesave të Basel III, në kuadër të së cilës ka filluar raportimi dhe monitorimi i Treguesit të Mbulimit me Likuiditet (LCR)²⁵ si indikator më adekuat i vlerësimit të pozicionit të likuiditetit, është avancuar edhe korniza e stress-tesitit për vlerësimin e qëndrueshmërisë së likuiditetit. Korniza e re bazohet në raportimin rregullator të LCR²⁶, i cili shprehë raportin ndërmjet rezervës së likuiditetit (liquidity buffer) të bankës ndaj neto rrjedhave dalëse të likuiditetit (net cash outflows) përgjatë 30 ditëve kalendarike të periudhës stresuese, të shprehur si përqindje, dhe kufiri minimal rregullator i së cilës duhet të jetë 100 përqind. Zhvillimi i metodologjisë si instrument me perspektivë mikro dhe makro-prudenciale, përmirëson kapacitetin për monitorim dhe testim të qëndrueshmërisë së pozicionit të likuiditetit.

²⁵ Raportimi rregullator për LCR në Kosovë ka hyrë në fuqi në janar 2023.

²⁶ Korniza e re e stress testit për likuiditetin është dizajnuar me ndihmën e asistencës teknike të ofruar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), dhe është në linjë me standardet ndërkombëtare të vlerësimit/stresimit të pozicionit të likuiditetit.

Tutje, objektivi është që të shqyrtohet mundësia e zgjerimit të kuadrit rregullues dhe analitik për të përfshirë modulën e Analizës së Rrjedhës së Parasë (Cash Flow Analysis) sipas maturimeve, i cili, duke ofruar planifikimet apo parashikimet e bankave rreth lëvizjeve të hyrjeve dhe daljeve të pozicioneve bilancore sipas afateve të maturimit, do të plotësonte gjykimin dhe vlerësimin në përcaktimin e peshave (angl: haircut) në platformën e stres testit të likuiditetit të bazuar në LCR. Në vijim do të elaborohet konteksti historik i krijimit dhe efektivitetit të treguesit LCR, narrativa e goditjeve/supozimet për përcaktimin e peshave në pozicionet bilancore për sektorin bankar të Kosovës, si dhe rezultatet përkatëse të stresimit të këtyre pozicioneve.

Gjatë Krizës Financiare Globale (GFC) të vitit 2008, shumë banka në botë janë përballur me dështimin për shkak të paaftësisë në përmbushjen e rrjedhave dalëse të detyrimeve që ishin shkaktuar nga mos-përputhjet e afateve të maturimit ndërmjet asetëve likuide dhe detyrimeve. Kjo situatë krijoi dukurinë e pasigurisë në treg duke ndikuar në rënie tutje të besimit në sistemin financiar dhe për rrjedhojë rënien tutje të likuiditetit në treg. Për ta menaxhuar dhe kontrolluar këtë fenomen Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare (BCBS) reagoj përmes reformimit të standardeve rregullatore në vitin 2013, duke prezantuar një masë të re që synon të sigurojë qëndrueshmërinë afatshkurtër të profilit të rrezikut të likuiditetit të bankave. Kjo masë e re rregullatore, Treguesi i Mbulueshmërisë me Likuiditet, ka për qëllim të jetë masë parashikuese (forward-looking) dhe kërkon nga bankat mbajtje të nivelit të mjaftueshëm të stokut të asetëve likuide me kualitet të lartë (High Quality Liquid Assets²⁷), për të përballuar një periudhë stresi të likuiditetit prej 30 ditë kalendarike. Bankat evropiane kanë filluar të zbatojnë treguesin TML (LCR) në përputhje me kërkesat e Kornizës së Bazelit duke aplikuar kërkesa minimale të këtij

raporti prej 100 përqind, me implementim nga Janar 2018. Rezerva e tillë e likuiditetit ka për qëllim përmirësimin e aftësisë së sektorit bankar për të absorbuar tronditjet e shkaktuara nga ndonjë goditje financiare apo ekonomike, gjë që do të mundësonte reduktimin e përhapjes së rrezikut nga sektori financiar në ekonominë reale. Vetë treguesi prej minimum 100 përqind është implementuar si shtesë/buffer likuiditeti me qëllim të mbrojtjes nga kriza e tërheqjeve. Ky nivel është përcaktuar bazuar në përvojën e krizës financiare globale rreth nivelit të tërheqjeve/rrjedhave dalëse, të cilat kanë probabilitet të lartë të ndodhjes.

Komiteti i Bazelit (BCBS) dhe Banka Qendrore Evropiane (BQE) kanë analizuar nëse ky tregues, gjatë periudhës së krizës pandemike, ka funksionuar për qëllimin për të cilin është aktivizuar. Për shkak të natyrës akute të krizës pandemike, si dhe masave mbështetëse fiskale dhe monetare që u ndërmorën, është e vështirë të konkludohet me saktësi për efektshmërinë e këtij treguesi gjatë asaj periudhe. Megjithatë, niveli i rezerves/buffer-it të LCR u dëshmuar i pamjaftueshëm gjatë krizës bankare të marsit 2023.²⁸ Tërheqjet e depozitave në bankat e prekura në SHBA (kryesisht depozita të pasiguruara) dhe Zvicër (kryesisht depozita të korporatave jo-financiare) ishin dukshëm më të larta se supozimet e bëra në LCR për ato depozita. Sipas raportit të Komitetit të Bazelit²⁹, Silicon Valley Bank humbi 85 përqind të totalit të depozitave të saj brenda një periudhe dy-ditore. Për First Republic Bank dhe Credit Suisse, tërheqjet e depozitave ishin 57 përqind dhe 21 përqind brenda 90 ditëve, respektivisht. Përhapja e panikut nuk u materializua tek bankat në eurozonë tek të cilat niveli i tërheqjes ndodhi në magnitudë shumë më të ulët prej mesatarisht 4.2 përqind të depozitave brenda 30 ditëve. Megjithatë, përhapja e panikut dhe magnituda e përhapjes janë të paparashikueshme, dhe për këtë arsye

²⁷ Lehtësisht të konvertueshme në para të gatshme

²⁸ Kriza bankare e marsit 2023 u shkaktua nga kolapsi i bankave amerikane Silicon Valley Bank dhe Signature Bank, së bashku me rënien e pothuajse të plotë të Credit Suisse të Zvicrës, duke sjellë

kështu shqetësime mbi likuiditetin, menaxhimin e rrezikut dhe mangësitë rregullatore në sektorin bankar.

²⁹ [Report on the 2023 banking turmoil \(bis.org\)](https://www.bis.org/press/pr230301.htm)

supozimet për LCR duhet të tejkalojnë përvojat e kaluara. Kjo veçanërisht që pritjet për tërheqje të shpejtë të depozitave janë shumë më realiste në një ambient të digjitalizimit dhe impaktit të menjehershëm që mediat dhe rrjetet sociale kanë në përhapje të panikut.

Të dyja situatat e krizave – kriza pandemike dhe kriza bankare e marsit 2023 – kanë rritur interesin dhe angazhimin për të analizuar nëse Treguesi i Mbulimit me Likuiditet (LCR) po kryen funksionin për të cilin është implementuar. Më e rëndësishmja, shqetësimi kryesor është nëse bankat do të jenë të gatshme të përdorin këtë buffer në rast të ndonjë krize specifike apo sistematike, duke zbritur nivelin e LCR nën 100 përqind në këto rrethana. Në anketimet e realizuara nga BQE³⁰ shumica e bankave që kanë zgjedhur të mos përdorin buffers të likuiditetit (pra, të mos ulin raportin LCR nën 100 përqind) kanë argumentuar se një veprim i tillë mund t'i stigmatizojë ato si institucione me probleme likuiditeti, duke dëmtuar reputacionin dhe përkeqësuar më tej pozitën e tyre të likuiditetit. Si rezultat, nëse kriza pandemike nuk ka mundur të japë një konkluzion të qartë mbi funksionimin e LCR për shkak të reagimeve të ndryshme nga bankat, ajo ka ngritur pyetje nëse bankat do të jenë në gjendje ta përdorin këtë buffer aktual të likuiditetit (mundësinë për rënie nën nivelin 100 përqind) gjatë një krize, apo të krijohen mekanizma të rinj të rezervave shtesë të likuiditetit.

Rrjedhimisht, modeli **stress test për rrezikun e likuiditetit** synon të vlerësoj reagimet e rezervës së likuiditetit në nivel bankave dhe në nivel sektori, në një situatë stresi e shkaktuar nga një goditje negative. Kjo provë vlerëson rezistencën e sektorit bankar ndaj situatës ku rrjedha dalëse e parasë është shumë më e lartë dhe për pasojë bankat nuk kanë aktive apo tepriçë likuiditetit të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet. Në këtë rast vlerësohet niveli i mungesës në raport me minimumin e kërkuar rregullator,

për të matur aftësinë e bankave në përballimin e streseve të caktuara.

Në linjë me praktikën dhe eksperiencën e bankave evropiane, dhe më konkretisht analizave të BQE-së dhe Komitetit të Bazelit, ndërtimi i hipotezave mbi nivelet e tërheqjeve të depozitave dhe ndërtimi i skenarëve për pozicione të tjera bilancore është bërë në nivelet më ekstreme të ndodhura në realitet (si ajo e bankave në Amerikë dhe bankës në Zvicër). Kjo qasje është përdorur vetëm për qëllim të matjes së ndjeshmërisë së pozicionit të likuiditetit të bankave në vend ndaj situatës më ekstreme negative por potencialisht të mundshme. Kriza bankare e marsit 2023 vëri në dukje ndikimin e ngjarjeve ekstreme (angl: tail events), për të cilat LCR nuk ishte i mjaftueshëm. Prandaj identifikimi i hershëm i rasteve të veçanta që reflektojnë rreziqet ekstreme është i domosdoshëm dhe ngritë nevojën për raportim dhe monitorim më të detajuar dhe me frekuencë më të lartë edhe gjatë periudhave normale.

SKENARËT

Skenarët e goditjeve në pozitën e likuiditetit janë bazuar në supozimet për krizë të mundshme gjeopolitike, me efekt zinxhir në ekonominë dhe sektorin financiar të Kosovës, si dhe në goditje të mundshme në sektor që rezulton nga ngjarje rreziku idiosinkratik i një banke me efekt zinxhir në sektorin bankar. Magnituda e shokut për sektorin bankar të Kosovës konsiderohet (supozohet) se amplifikohet për shkak të faktorëve si shkalla e ulët e sigurimit të depozitave në raport me vendet tjera, si dhe mekanizmat më të kufizuar për ndihmë emergjente me likuiditet. Efektet e skenarëve konservatorë janë klasifikuar në dy kategori të mundshme situatash, në dy nivele skenarësh: i rënduar si dhe ekstrem.

1) Efektet e rrezikut të tregut nga ndryshimet e normave të interesit në vlerën e mjeteve më likuide, më konkretisht të instrumenteve qeveritare. Në këtë skenar, rritja e normave të interesit mund të ulë vlerën e këtyre instrumenteve, duke bërë që bankat të përballen me rënie të vlerës në asetet e tyre likuide, gjë që ndikon drejtpërdrejt në aftësinë për të përmbushur detyrimet afatshkurtra.

³⁰ [Second EBA report on monitoring of LCR implementation in the EU.pdf \(europa.eu\)](#)

2) Efektet e rrezikut reputacional, që lidhen me situata si tërheqje masive të depozitave, ku paniku mund të ndikoj që besimi në sektorin bankar të dobësohet. Kjo mund të rezultojë në tërheqje të shpejtë dhe të lartë të depozitave, duke vënë presion

mbi likuiditetin e bankave dhe mundësinë për të përballuar kërkesat e papritura të likuiditetit.

Tabela 4. Skenarët dhe peshat (haircut) të përdorura në secilin skenar për kategoritë kryesore të TML - LCR

KATEGORITË KRYESORE TË TREGUESIT TË MBULIMIT ME LIKUIDITET (TML-LCR)	Skenari bazë - peshat rregullatore	Skenari i rënduar	Skenari ekstrem	Peshat e aplikuara nga bankat
REZERVA E LIKUIDITETIT (LIQUIDITY BUFFER)	98.6%	93.7%	88.9%	93.1%
Aktivët e qeverisë qendrore (Central government assets)	100%	90%	80%	100%
Aktivët e qeverive rajonale (Regional government)	100%	90%	80%	100%
Aktivët e njohura të qeverisë qendrore dhe bankave qendrore në monedha të brendshme dhe të huaja (Recognisable domestic and foreign currency central government and central bank assets)	100%	90%	80%	85%
RRJEDHA DALËSE (OUTFLOWS)	14.2%	22.7%	31.4%	13.8%
Depozitat e ekonomive familjare (Retail deposits)	8.3%	16.6%	23.6%	8.0%
depozita që i nënshtrohen rrjedhave më të larta dalëse (deposits subject to higher outflows)	17%	19%	27%	12%
depozita të qëndrueshme (stable deposits)	5%	7%	12%	5%
të tjera të ekonomive familjare (other retail deposits)	10%	25%	35%	10%
Depozita operacionale (Operational deposits)	15%	22%	31%	21%
të mbajtura për pastrim (clearing), kujdestari (custody), menaxhim parash ose shërbime të tjera të krahasueshme në kontekstin e një marrëveshjeje operacionale të vendosur (maintained for clearing, custody, cash management or other comparable services in the context of an established operational relationship)	24%	34%	49%	18%
Depozita jo-operacionale (Non-operational deposits)	25%	27%	34%	46%
nuk mbulohej me skemën për mbrojtje të depozitave (not covered by DGS)	40%	45%	60%	40%
Produkte dhe shërbime të tjera (Other products and services)	14%	30%	47%	14%
RRJEDHA HYRËSE (INFLOWS)	80.8%	70.3%	58.5%	80.7%
rrjedhat hyrëse nga klientët jo-financiarë (përveç bankave qendrore) (monies due from non-financial customers (except for central banks))	55%	48%	31%	55%
rrjedhat hyrëse nga ekonomitë familjare (monies due from retail customers)	50%	45%	30%	50%
rrjedhat hyrëse nga korporatat jo-financiare (monies due from non-financial corporates)	50%	40%	20%	50%
rrjedhat hyrëse nga bankat qendrore dhe klientët financiarë (monies due from central banks and financial customers)	99%	84%	70%	99%
rrjedhat hyrëse nga klientët financiarë (monies due from financial customers)	100%	85%	70%	100%
marreveshjet kreditore pa një datë përfundimi të përcaktuar (loans with an undefined contractual end date)	20%	10%	0%	20%

Burimi: Model i simuluar/hipotetik i BQK.

Që të dy situatat, ajo e ndryshimeve në vlerën e obligacioneve qeveritare si dhe tërheqja e depozitave janë bazuar në përvojat ndërkombëtare dhe do të aplikohen paralelisht në stresimin/goditjen e pozitës likuide të bankave. Duhet theksuar se nuk konsiderohen mundësi apo burime të tjera të rifinancimit dhe riinvestimit, që si rezultat, pasqyron pamundësinë e bankave për të ripërtërirë të njëjtin financimin që maturohet, e shprehur përmes aplikimit të peshave (haircut) specifike. Për të dy situatat janë përdorur nga dy skenarë (i rënduar dhe ekstrem) në aspekt të nivelit të përcaktuar të peshave (haircut) në pozicionet dominuese, të cilat janë paraqitur në tabelën 4.

1. Goditjet në shtesën e likuiditetit (Liquidity Buffer) dhe të hyrave rrjedhëse (Inflows)

Ky skenar është bazuar në peshat e aplikuar nga Autoriteti Bankar Evropian (EBA)³¹ lidhur me rënien e vlerës së kolateralit të letrave me vlerë të qeverisë, e cila mund të ulë rezervat e likuiditetit dhe të reduktoj aftësinë e bankave për të përmbushur detyrimet e tyre. Skenari analizon potencialin e rënies së rezervës së likuiditetit (liquidity buffer) si pasojë e rënies së vlerës së një pozicioni likuid, konkretisht të obligacioneve qeveritare me kualitet të nivelit të parë.

Bazuar në të dhënat që tregojnë për pjesëmarrje relativisht të lartë të letrave me vlerë të qeverive në gjithsej rezervën e likuiditetit (mesatarisht 44.2 përqind e rezervës së likuiditetit të sektorit bankar të Kosovës përbëhet nga investimet në letra me vlerë, ku për disa banka ky raport arrin deri në 62.1 përqind), supozimi i rënies së vlerës së këtyre asetëve, përkatësisht aplikimi i një marzhe reduktuese të vlerës (haircut), do të kishte një ndikim të konsiderueshëm në zvogëlimin e mjeteve likuide në dispozicion dhe një efekt në të njëjtën kahje (reduktim)

në aftësinë likuide të bankave dhe pozitën e tyre likuide.

Kombinimi i faktorëve me probabilitet të ndodhjes si rritja e normave të interesit, rritja e primit të rrezikut të vendit dhe ngadalësimi ekonomik mund të ndikojnë negativisht në vlerën e letrave qeveritare. Për pasojë, kjo ndikon në rënien e vlerës së kolateralit dhe, rrjedhimisht, uljen e rezervave likuide të bankave. Kjo situatë është e vlefshme poshtu kur këto letra me vlerë përdoren për financime REPO me bankat, pasi që çdo ulje në vlerën e tyre ndikon drejtpërdrejt në sasinë e fondeve që bankat mund të marrin nëpërmjet këtyre marrëveshjeve.

Këtu janë përdorur dy skenarë sipas nivelit të përcaktimit të peshave (haircut) në pozicione të caktuara. Në skenarin e rënduar, supozohet që aftësia për të përdorur këto instrumente në bankën qendrore do të dobësohet nga rënia e vlerës së kolateralit. Këto instrumente nuk do të konsiderohen më me rrezik zero dhe plotësisht likuide; vlera e tyre do të reduktohet në 90 përqind, që do të thotë se vetëm kjo përqindje mund të konsiderohet me likuiditet të lartë dhe e konvertueshme. Ky skenar do të kombinohet gjithashtu me rënien e rrjedhës hyrëse (inflows) në kategoritë dominuese të të hyrave rrjedhëse: të hyrat nga klientët financiarë (që përbëjnë 47.9 përqind të rrjedhës hyrëse), klientët jo-financiarë (18.3 përqind), dhe marrëveshjet kreditore pa një afat përfundimi të përcaktuar (13.2 përqind) (Tabela 4). Në skenarin ekstrem, supozohet se aftësia likuide instrumenteve financiare do të reduktohet në 80 përqind. Si rezultat, për gjithsej rezervat likuide që aktualisht kanë një aftësi likuide prej 98.6 përqind sipas peshave të standardizuara, likuiditeti do të reduktohet në 88.9 përqind në këtë skenar. Ky skenar kombinohet me një rritje të peshave të reduktimit në të hyrat rrjedhëse (inflows) nga klientët financiarë, të cilët në kushte normale nuk kanë vonesa dhe për të

³¹ Për të vlerësuar ndikimet e tilla, EBA në raportin e tretë mbi monitorimin e LCR, zhvilloi disa projeksione të përgjithshme të vlerave të LCR dhe NSFR për vitet 2023 dhe 2024, duke marrë në

konsideratë ngjarje kyçe si maturimet e financimeve të bankës qendrore, si dhe një skenar të mundshëm të rrezikut më të lartë të likuiditetit, që ndikon veçanërisht në obligacionet qeveritare, derivate dhe tregjet repo.

cilët nuk pritet përkeqësim i performancës paguese, prandaj zakonisht nuk aplikohet ndonjë peshë reduktuese (haircut). Megjithatë, në këtë skenar, të hyrave rrjedhëse nga kjo kategori do t'u aplikohet peshë reduktuese (haircut) për shkak të reduktimit të aktivitetit ekonomik, me pritshmërinë që do të realizohen vetëm vetëm 70 përqind. Për kategorinë tjetër të të hyrave, që vjen nga klientët jo-financiarë (ekonomitë familjare dhe korporatat jo-financiare), për të cilën zakonisht aplikohet një haircut standard rregullator prej 50 përqind, në këtë skenar supozohet se reduktohet aftësia për të pranuar mjetet në 30 përqind dhe 20 përqind, respektivisht. Të gjitha pozicionet e tjera mbeten të pandryshuara dhe në përputhje me kufizimet e standardizuara të rregullativës LCR.

2. Situata “dash for cash³²” bazuar në eksperiencën e krizës bankare në Amerikë dhe Zvicërr në mars 2023 (goditje në rrjedhën dalëse – Outflow)

Kriza bankare e marsit theksoi rëndësinë e pyetjes nëse treguesi i mbulimit me likuiditet po goditet dhe vlerësohet mjaftueshëm për të njohur me siguri aftësinë e bankave në përballimin e tërheqjeve të depozitave në nivele ekstreme. Shembulli i dështimit të bankës Credit Suisse, është konsideruar si një bazë për orientimin e përcaktimit të peshave të rrjedhave dalëse. Në vitin 2022, kjo bankë pati pasiguri rreth planit të saj të transformimit dhe u destabilizua nga fluksi i lajmeve negative. Në vitin 2023, dështimi i dy bankave amerikane rriti pasiguritë rreth likuiditetit në sektorin bankar në nivel global, duke përkeqësuar tutje përceptimin e tregut për Credit Suisse. Në këtë kontekst, deklarata për mos-kapitalizim ishte nxitësi i krizës, me ç'rast digjitalizimi i proceseve e përshpejtoi situatën, duke u ofruar klientëve akses të menjëhershëm në informacion dhe mundësi për të transferuar fonde shumë shpejt në llogari të tjera bankare.

Në adaptimin e kësaj narrative të goditjeve për skenarin e shokut idiosinkratik bankar në Kosovë, janë përdorur supozime të ngjashme për tërheqjet e depozitave nga sektori financiar dhe jo-financiar (ekonomitë familjare dhe korporatat jo-financiare) në kombinim me rrethanat specifike të sektorit në Kosovë.

Kategoria e depozitave të ekonomive familjare përfaqëson një burim mjaft të qëndrueshëm fondesh për bankat. Prandaj, vlerësimi për tërheqjet e këtyre depozitave brenda 30 ditëve ka një peshë standarde rregullatore në intervalin prej 5 -10 përqind, dhe vendosja e peshave reduktuese (haircut) të larta është e rrallë në sistemet financiare të avancuara për shkak të skemave të sigurimit të depozitave. Por, duke marrë parasysh që në Kosovë, vlera e mbulueshmërisë së depozitave të siguruara është relativisht e ulët, mbeshetet supozimin për shkallë më të lartë të tërheqjeve në rast të situatave shokuese. Gjithashtu, siç u tha më lartë, eksperiencia e marsit 2023 na shërben për të vlerësuar aftësinë likuide të bankës në rastet më të rënda të tërheqjeve. Prandaj, për depozitat që konsiderohen më stabile (stable deposits), për shkak të mbulimit nga skema e sigurimit të depozitave, është aplikuar një peshë më e lartë e daljeve prej 7 -12 përqind nga standardi 5 përqind, duke pasur parasysh se në gjendje paniku depozitorët nuk veprojnë në mënyrë racionale dhe çdo kategori mund të jetë subjekt i tërheqjeve të shpejta dhe të larta. Tutje, për kategoritë si depozitat e tjera të ekonomive familjare (other retail deposits), të cilat përbëjnë kategorinë kryesore të daljeve (38.2 përqind), gjithashtu është aplikuar një peshë më rigorozë, duke supozuar se niveli i tërheqjeve nga kjo kategori do të jetë 25 përqind në skenarin e rënduar dhe 35 përqind në skenarin ekstrem. Për pjesën e depozitave të ekonomive familjare që trajtohen nga korniza LCR si subjekt i tërheqjeve më të larta, është

³² Shprehja “dash for cash” është një term që përdoret në artikuj profesional për t'u referuar një situatë të pasigurisë ose krizës financiare ku investitorët tentojnë të konvertojnë pasuri në para të

gatshme apo të tërheqin para fizike nga bankat, për shkak të frikës nga pasiguria e tregjeve dhe qëndrueshmëria e bankave, gjë që mund të çojë në destabilizimin tutje të sistemit financiar.

supozuar se do të ketë tërheqje në nivelin me interval prej 19 – 27 përqind për të dy skenarët, krahasuar me 12 përqind që bankat kanë përdorur në raportimin e tyre (ngjashëm me peshën e standardizuar).

Në rastin e **depozitave të korporatave jo-financiare**, karakteri dinamik i këtyre subjekteve i bën ato më të ndjeshme, dhe më reaguese ndaj tronditjeve, duke përbërë një burim më të pasigurt fondesh për bankat. Rasti i dështimit të bankave në mars tregon se një nivel i lartë i tërheqjeve është realizuar nga korporatat jo-financiare. Prandaj, në skenarët e rënduar dhe ekstrem, është supozuar një nivel më i lartë i tërheqjeve, që lëviz në intervalin prej 22 deri në 34 përqind në të dy skenarët për të dy kategoritë e depozitave: ato për qëllime operacionale dhe jo-operacionale. Ky nivel i lartë i tërheqjeve të depozitave përkon me nivelin e tërheqjeve të ndodhura gjatë krizës së marsit 2023, që ishte rreth 21 përqind në Zvicërr dhe ekstremi prej 85 përqind në Amerikë.


Rezultatet sipas skenarëve

Peshat (haircut) e standardizuara, që janë të përcaktuara me rregullore, ofrojnë informacion dhe udhëzime për bankat për të stresuar/goditur pozicionet financiare, duke caktuar intervale brenda të cilave ato mund të operojnë, por pa devijime të theksuara nga peshat e aplikuar. Në përgjithësi, bankat kanë aplikuar peshat e referuara sipas standardeve, me variacione të vogla ndërmjet tyre. Sipas peshave të standardizuara³³, rezervat e likuiditetit janë likuide në shkallë prej 98.6 përqind, krahasuar me peshat e aplikuar nga bankat, të cilat rezultojnë të jenë më konservative në një nivel prej 93.1 përqind.

Ky raport është ndikuar nga bankat që kanë ekspozime në instrumente të cilat kategorizohen në grupin me likuiditet të nivelit të dytë, ku niveli likuid i tyre është 50 përqind (niveli 2B i kualitetit) dhe 85 përqind (niveli 2A i kualitetit). Për sa i përket

tërheqjeve të depozitave dhe të hyrave rrjedhëse, janë përdorur pothuajse të njëjtat peshat të rekomanduara. Për daljet apo tërheqjet, niveli i rekomanduar është 14.2 përqind, ndërsa bankat kanë supozuar 13.8 përqind. Për hyrjet, kanë aplikuar peshë 80.8 përqind kundrejt standardes prej 80.7 përqind. Treguesi i Mbulimit me Likuiditet (TML-LCR) sipas peshave standarde rezulton të jetë 281.03 përqind, shumë afër me atë të mbajtur nga bankat në dhjetor 2023.

Grafik 66. Rezultatet e TML të sektorit në bazë të skenarëve




Në **skenarin e rënduar**, niveli i gjithsej mjeteve likuide rezultoi të jetë 93.7 përqind, në bazë të supozimeve për marzhat reduktuese për kategoritë specifike sikurse në tabelën 4. Ndërsa niveli i tërheqjeve (outflows) rezultoi në gjithsej 22.7 përqind për sektorin, duke përkuar me nivelin e tërheqjes së ndodhur në bankën Credit Suisse, që ishte në raportin prej 21.0 përqind. Ndërkohë në anën e të hyrave (inflows), nga supozimet specifike për kategoritë e të hyrave (tabela 4), rezultoi që shkalla e përgjithshme e realizimit të të hyrave të pritura për periudhën 30 ditore të jetë vetëm 70.3 përqind. Sipas këtyre supozimeve, Treguesi i Mbulimit me Likuiditet (TML-LCR) do të zbrës në 117.65 përqind, nga niveli prej 280.01 përqind i sektorit në dhjetor 2023.

Në **skenarin ekstrem**, rezervat janë supozuar të jenë likuide në nivelin 88.9 përqind. Duke u nisur nga niveli i tërheqjeve të depozitave në bankat amerikane dhe zvicerane, që variojnë

³³ Peshat standarde dhe peshat e aplikuar nga bankat janë përlogaritur në raport me peshën e bilanceve në periudhën raportuese dhjetor 2023, për kategoritë përkatëse.

nga 21 përqind deri në 85 përqind, u realizua aplikimi i peshave më rigoroze në grupet përbërëse dominuese, duke rezultuar që niveli i tërheqjeve të jetë gjithsej 31.4 përqind. Shkalla e arkëtimit të të hyrave në këtë situatë u supozua në 58.5 përqind.

Grafik 67. Kategoritë e TML sipas skenarit të rënduar



Burimi: BQK.

Bazuar në këto supozime, Treguesi i Mbulimit me Likuiditet do të zbritet në 67.22 përqind, nën nivelin rregullator prej 100 përqind. Pothuajse të gjitha bankat rezultojnë rreth këtij niveli, me përjashtim të tri bankave që rezultojnë me LCR në nivel mbi 80 përqind.


Përfundim

Një nga mësimet nga dështimet e fundit të bankave në mars 2023, për shkak të mungesës së likuiditetit, është se bankave duhet t'u kërkohej të vlerësojnë nivelin e mjeteve që mund të përdoren si kolateral në bankë qendrore.³⁴ Gjithashtu, aspekti i kostos operacionale të bankës nuk merret parasysh gjatë realizimit të stres testit për likuiditetin. Në fakt, Treguesi i Mbulimit me Likuiditet (LCR) nuk përfshin dimensionin e rrezikut operacional, shtesë rrezikut të likuiditetit. Nevojat operacionale për likuiditet zakonisht janë më të larta gjatë një krize, pasi banka në vështirësi përpiqet të shlyejë pagesat. Për më tepër, kërkesat e klientëve për tërheqje të shpejtë të fondeve krijojnë mbingarkesë operacionale, duke rritur mundësitë për probleme teknike dhe dështime.

Gjithsesi, duhet pasur parasysh se Treguesi i Mbulimit me Likuiditet (LCR) është prezantuar si një instrument standardizues rregullator minimal për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. Për këtë arsye, nuk duhet pritur që

korniza LCR me peshë standarde rregullative të ketë cilësi të paralajmërimit të hershëm lidhur me situata negative të rënies së likuiditetit.

Grafik 68. Treguesi i Mbulimit me Likuiditet



Burimi: BQK.

LCR është krijuar për të mbrojtur bankat nga dështimet e mundshme të shkaktuara nga mospërputhjet e likuiditetit në bilanci të tyre, duke shërbyer njëkohësisht edhe si kornizë për testim të rezistencës.

Aspektet tjera të rrezikut të likuiditetit, si koncentrimi i financimit (zakonisht i depozitave), analiza e rrjedhës së parasë sipas afateve të maturimit ose likuiditetit ditor, si dhe transaksionet repo, nuk përfshihen eksplicit në treguesin e LCR, përkundër se janë mjaft të rëndësishëm në vlerësimin dhe monitorimin e këtij rreziku. Për këtë arsye, LCR duhet të monitorohet paralelisht me tregues të tjerë të likuiditetit dhe të stresohet në mënyrë që të prezantojë sa më qartë gjendjen e bankave dhe reagimin e tyre në situata stresi. Në veçanti, në kohët aktuale, tërheqjet e shpejta dhe të larta të depozitave janë shumë më reale, pasi dixhitalizimi dhe mediat kanë potencialin të ndikojnë në sjelljen e depozituesve, duke rritur goditjet në nivelet e tërheqjes së depozitave.

³⁴ Banka Nazionale Zvicereane, Raporti i Stabilitetit Financiar 2023

Kutia 5. Strategjia, Planet e Veprimit dhe Aktivitetet e deritashme të BQK-së në menaxhimin e rrezikut që ndërlidhet me ndryshimet e kushteve klimatike

“Ndryshimet klimatike përfaqësojnë një lloj të ri të rrezikut sistemik, i karakterizuar si "Mjellmë e Gjelbër" (Green Swan). Ndryshe nga ngjarjet e rralla të krizave, si të ashtuquajtura "Mjellmat e Zeza" e Krizës Globale Financiare, Mjellmat e Gjelbra janë të destinuara të ndodhin nëse nuk adresohen përmes politikave të përshtatshme” (Bolton et al., 2020, *The Green Swan: Central Banking and Financial Stability in the Age of Climate Change*).

Në dy publikimet paraprake të Raportit të Stabilitetit Financiar (RSF), BQK ka trajtuar dimensionin e rrezikut nga ndryshimet klimatike, duke filluar me analizimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike në mirëqenien sociale dhe stabilitetin e përgjithshëm financiar, dhe tutje, vlerësimin e integritit të menaxhimit të këtyre rreziqeve në sektorin bankar. Në kuadër të përkushtimit ndaj rolit monitorues, analizues dhe mbikëqyrës makroprudencial dhe mikroprudencial, BQK ka draftuar *Strategjinë për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen e Rreziqeve të Lidhura me Klimën dhe Mjedisin në sektorin financiar për vitet 2024-2026*.³⁵, strategji që pritet të aprovohet në fund të vitit 2024. Rrjedhimisht, në këtë edicion të RSF-së, analiza për këtë dimension rreziku do të fokusohet në objektivat, proceset dhe aktivitetet e ndërmarra nga BQK, dhe veprimet e pritura, konform strategjisë së aprovuar për adresimin e rreziqeve klimatike. Roli i BQK-së nuk mëton


të nxisë drejtpërdrejtë investimet e qëndrueshme, por përmes krijimit të kuadrit rregullues dhe mekanizmave mbikëqyrëse, të sigurojë identifikimin, menaxhimin dhe adresimin e duhur të rreziqeve klimatike, ndaj të cilave është i ekspozuar sistemi financiar.

Përpjekjet për të menaxhuar **rreziqet fizike** të ndryshimeve klimatike kërkojnë orientimin drejtë aktiviteteve që respektojnë parimet mjedisore, duke rritur kështu ekspozimin ndaj **rreziqeve të tranzicionit**, që bartin kosto dhe rreziqe shtesë. Kështu, ndryshimet klimatike dhe çështjet e qëndrueshmërisë krijojnë dy lloje kryesore rreziqesh për sistemin financiar: **rreziqet fizike**, që vijnë nga pasojat direkte të ndryshimeve klimatike, dhe **rreziqet e tranzicionit**, që rrjedhin nga veprimet e ndërmarra për të zbutur ndikimet e ndryshimeve klimatike.³⁶ (Diagrami 1).

³⁵ Strategjia është përgaditur me asistencë nga Banka Botërore me ekspertizë të Financial Sector Advisory Center (FinSAC)

³⁶ Për më tepër referojuni numrin 18 të RSF ku janë elaboruar detajisht rreziqet.

Diagrami 1: Kanalet e transimit të faktorëve mjedisor në ekonomi dhe stabilitetin financiar



Burimi: kombinuar nga NGFS (2023) dhe EBA (2021)

Në kuadër të iniciativave rajonale, Kosova ishte një ndër gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor që nënshkruan Deklaratën e Sofjes në nëntor 2020, duke pranuar Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane si pikënisje për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (GAWB). Më tej, në vitin 2021, pas diskutimeve me palët ndërkombëtare, Kosova përgatiti dhe shpali në fund të vitit 2023³⁷ Kontributin Vullnetar të Përcaktuar Kombëtar (NDC) sipas Marrëveshjes së Parisit, duke treguar përkushtimin e saj ndaj objektivave të agjendës së gjelbër (Diagrami 2). Për më tepër, veprimet e ndërmarra në nivel

shtetëror për adresimin e rreziqeve klimatike përfshijnë miratimin e Strategjisë për Energji, Strategjisë për Ndryshime Klimatike dhe aprovimin e Ligjit për Ndryshimet Klimatike (diagram 2).

Në përmbushjen e agjendës së gjelbër, sistemi financiar pritet të luajë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e tranzicionit drejtë rritjes së qëndrueshme (angazhim i përcaktuar në Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe në NDC-në vullnetare), por gjithashtu, në minimizimin e efekteve të rreziqeve fizike përmes identifikimit dhe zbatimit të duhur në kuadrin e tyre të menaxhimit të rrezikut.

Diagram 2. Marreveshjet dhe strategjitë për agjendën e gjelbërt, në nivel shtetëror



Strategjia e BQK-së për ndryshimet klimatike

Ndërkohë që roli i bankave qendrore në trajtimin e rreziqeve klimatike po zgjerohet, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) përgjatë vitit 2023/2024 ka ndërmarrë një sërë aktivitete për të ngritur kapacitetet brenda fushëveprimit të saj, për identifikimin, matjen, dhe menaxhimin e rreziqeve klimatike, duke përfshirë rreziqet fizike dhe ato të tranzicionit. Strategjia dhe veprimet e BQK-së janë në linjë me vizionin e BQE për veprimet që duhet ndërmarrë për menaxhimin e rreziqeve klimatike, të paraqitura në planin për klimën dhe natyrën për vitet 2024 dhe 2025.³⁸

Në kuadër të angazhimit dhe zotimit të politik-bërjes institucionale, BQK ka

integruar rreziqet klimatike dhe mjedisore në Planin Strategjik të BQK-së për periudhën 2024-2028.

Konform me planin strategjik, në kuadër të objektivave kryesore strategjike institucionale si ruajtja e stabilitetit financiar dhe rregullimi dhe mbikëqyrja financiare, janë integruar edhe parimet Mjedisore, Sociale dhe të Qeverisjes ESG (angl: Environmental, Social, and Governance) në operacionet dhe politikat e BQK-së (referuar në diagram 4).

Për të konkretizuar angazhimin në analizimin, monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve financiare të lidhura me klimën, BQK ka hartuar **Strategji trevjeçare për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen e**

³⁷ <https://president-ksgov.net/en/speech-by-president-osmani-at-the-presentation-of-kosovos-nationally-determined-contribution-ndc-at-cop-28/>


³⁸ [The ECB's climate and nature plan 2024-2025 \(europa.eu\)](https://www.ecb.europa.eu/press/pr/2024/01/20240124-climate-nature-plan-2024-2025.en.html)

Rreziqeve të Lidhura me Klimën dhe Mjedisin, e cila pritet të miratohet në fund të vitit 2024. Qëllimet e kësaj strategjie përfshijnë: ofrimin e një pasqyre të zotimeve ndërkombëtare për zbutjen e ndryshimeve klimatike, listimin e dinamikave dhe iniciativave ndërkombëtare, analizimin e pozicionit të sektorit financiar ndaj rreziqeve klimatike, shqyrtimin e praktikave aktuale të sektorit bankar dhe aplikimin e 10 parimeve që mbështesin udhërrëfyesin të strukturuar në pesë

dimensione të fushë-veprimeve: Rregullativë, Mbikëqyrje Bankare, Stabilitet Financiar, Angazhim Kombëtar/Ndërkombëtar dhe Kulturë/Njohuri, për të adresuar në mënyrë të plotë këto rreziqe (**Diagrami 3**).

Të gjitha aktivitetet e parashikuara nga kjo strategji dhe të përfshira në udhërrëfyes për monitorim dhe menaxhim të rreziqeve që rrjedhin nga ndryshimet klimatike, janë të klasifikuar në gjashtë dimensionet e fushave vepruese vijuese:

Diagram 3: Fushat e Veprimit për realizimin e aktiviteteve të përcaktuara drejtë menaxhimit të rreziqeve klimatike



BQK është zotuar të zbatoj në mënyrë aktive planet e veprimit si dhe zhvillimin e kuadrit të nevojshëm për menaxhim të rrezikut dhe financave të qëndrueshme duke zbatuar gradualisht veprimet e përcaktuara në Strategjinë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e rreziqeve të lidhura me klimën dhe mjedisin në sektorin financiar. **Aktivitetet e deri-tanishme strategjike të BQK-së për menaxhimin e Rreziqeve Klimatike.** Në kuadër të veprimeve strategjike për rreziqet klimatike, **BQK ka hartuar një Letër Këshilluese (Rekomandimet / Udhëzimet) për Bankat mbi Rreziqet Klimatike dhe Mjedisore.** Kjo letër synon të udhëzojë sektorin bankar në përcaktimin, matjen,


menaxhimin dhe kontrollimin e këtyre rreziqeve, duke integruar qëndrueshmërinë mjedisore në aktivitetet e biznesit të bankave. Për të avancuar kapacitetet lidhur me praktikën e financimit të qëndrueshëm dhe për të forcuar qëndrueshmërinë e sistemit financiar ndaj rreziqeve klimatike, BQK është anëtarësuar në **Rrjetin e Bankingut dhe Financimit të Qëndrueshëm (Sustainable Banking and Finance Network - SBFN)** në dhjetor 2023.

Ky anëtarësim ofron mundësi për ndërtimin e kapaciteteve, shkëmbimin e përvojave dhe rrjetëzimin për arritjen e objektivave të përbashkëta në financat e qëndrueshme. Në prill 2024, BQK ka publikuar një udhëzues për sektorin bankar, duke definuar praktikatat për monitorimin dhe raportimin e të dhënave mbi kompanitë e ekspozuara ndaj kostove të tranzicionit, e përfshirë në **Mekanizmin e Rregullimit të Kufirit të Karbonit (CBAM)**.

Në proces të adresimit të rreziqeve klimatike, në kuadër të veprimeve strategjike për këtë qëllim, BQK po bën ndryshime të Politikës së Investimeve të BQK-së, për të përfshirë mundësitë e investimeve në instrumente financiare si Obligacionet e Gjelbërta - Green

Bonds. Këto investime kanë për qëllim të mbështesin projekte që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe përballjen me sfidat që sjellin ndryshimet klimatike. BQK është angazhuar në ngritjen e kapaciteteve të saj institucionale duke zhvilluar aftësitë dhe njohuritë e stafit mbi çështjet mjedisore përmes bashkëpunimit me akterë vendorë, përfshirë Shoqatën e Bankave, dhe me partnerë ndërkombëtarë dhe banka të tjera qendrore. Në përpjekje për avancimin e agjendës së gjelbër, BQK ka aplikuar për anëtarësim në Rrjetin për Gjelbërimin e Sistemit Financiar (NGFS) dhe Platformën Ndërkombëtare për Financat e Qëndrueshme (IPSF), dhe është në pritje të konfirmimit të anëtarësimeve (Diagrami 4).

Diagram 4: Aktivitetet e deri tanishme të BQK-së




6. Institucionet financiare jo-bankare

6.1 Sektori Pensional

Asetet e sektorit pensional shënuan rritje të përshpejtuar në vitin 2023 pas ngadalësimit të theksuar një vit më parë. Përkundër pritjeve në nivel global për recesion ekonomik - të ndikuar nga normat e larta të interesit, presionet inflacioniste dhe tensionet gjeopolitike - fondet pensionale shënuan kthim pozitiv nga investimet në tregjet e jashtme, duke përfituar nga normat e larta të interesit dhe efektet e politikave monetare konservative për të kontrolluar inflacionin në rritje.

Grafik 69. Asetet e sektorit pensional




Burimi: BQK.

Vlera e asetëve arriti në 2.71 miliardë euro, që përkon me rritje vjetore prej 12.1 përqind nga 2.4 përqind në vitin 2022 (Grafik 69). Kjo rritje i atribuohet kthimit pozitiv në investime në vlerë prej 88.5 milionë euro, përdërisa humbjet në vitin paraprak shënuan vlerën 119.7 milionë euro. Numri i kontributdhënësve dhe vlera e kontributeve të paguara ka vazhduar trendin e rritjes duke kontribuar gjithashtu në zgjerim të asetëve. Faktorë me ndikim në rritjen e vlerës së arkëtimit ishte edhe rritja e përgjithshme e nivelit të pagave – përfshirë përshtatjen ndaj inflacionit, si dhe ngritja e pagave të shërbyesve civil në fillim të vitit 2023. Vlera e arkëtimit të reja për vitin 2023 arriti në 286.8 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 18.5 përqind nga 13.1 përqind në vitin e kaluar.

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), që ka pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej asetet e sektorit (99.7 përqind),

vazhdon të udhëheq zhvillimet në performancën e sektorit pensional. Pjesa e mbetur e asetëve prej 0.3 përqind menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP) dhe ka ndikim marginal në performancën e gjithsej sektorit.

Grafik 70. Struktura e investimeve të sektorit pensional



Burimi: BQK.

Asetet e FKPK-së arritën në 2.70 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 12.1 përqind nga 2.5 përqind një vit më parë. Për dallim nga viti i kaluar, investimet jashtë vendit kanë shënuar rritje të pjesëmarrjes për 4.3 pikë përqindje në gjithsej 74.5 përqind të asetëve, ndërsa ato brenda vendit shënuan rënie. Kjo si rezultat i rritjes së lartë vjetore prej 19.0 përqind të vlerës së portfolios investuese në tregjet e huaja, nga rënia vjetore prej 6.5 përqind në vitin e kaluar. Në fund të vitit 2023, vlera e gjithsej investimeve jashtë vendit arriti në 2.01 miliardë euro. Struktura e investimeve jashtë vendit përbëhet kryesisht nga investimet në aksioneve të fondeve të përbashkëta, me pjesëmarrje 99.98 përqind, dhe pjesa tjetër në plasmane të parasë së gatshme.

Ndërsa, vlera e investimeve brenda vendit zbriti në 689.2 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 4.2 përqind (Grafik 70). Me rënie u karakterizuan letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe certifikatat e depozitit, ndërsa paraja e mbajtur në BQK shënoi rritje. Letrat me vlerë zbritën pjesëmarrjen në 64.9 përqind në kuadër të investimeve brenda vendit, rënie për 12.1 pikë përqindje nga viti paraprak. Kategoria e certifikatave të depozitit zbriti pjesëmarrjen

në gjithsej investimet brenda vendit në 13.1 përqind, duke shënuar rënie për 6.0 pikë përqindje nga viti i kaluar. Ndërsa, pesha e parasë së mbajtur në BQK në gjithsej mjetet e investuara brenda vendit u rrit ndjeshëm në 22.0 përqind, rritje për 18.0 pikë përqindje nga viti i kaluar.

Arkëtimet e reja të FKPK-së për vitin 2023 shënuan vlerën 286.2 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 18.5 përqind nga 13.1 përqind në vitin paraprak.


Vlera e gjithsej aseteve të FSKP-së arriti në 9.4 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 9.9 përqind nga 2.4 përqind rritje një vit më parë. Arkëtimet e reja shënuan vlerën prej 667.0 mijë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 9.6 përqind, ecuri më e ngadalshme krahasuar me atë të FKPK-së (Grafik 71).

Për dallim nga ecuria e investimeve të FKPK-së përgjatë vitit 2023, FSKP-ja e rriti prezencën në tregun e brendshëm, duke e ulur nivelin e investimeve në sektorin e jashtëm në 79.6 përqind nga 81.0 përqind në dhjetor 2022. Struktura e investimeve jashtë vendit përbëhet kryesisht nga investimet në formë të aksioneve prej 97.0 përqind, dhe pjesa tjetër prej 3.0 përqind në formë të parasë së gatshme. Në anën tjetër, investimet në Kosovë u rritën për 1.4 pikë përqindje, me pjesëmarrje prej 20.4 përqind të gjithsej aseteve të FSKP-së. Investimet në tregun e brendshëm ishin të shpërndara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës (88.3 përqind), depozita në bankat komerciale (7.3 përqind) dhe para të gatshme në thezaur të FSKP-së (4.4 përqind).

6.1.1 Performanca financiare e sektorit pensional

Performanca e mirë e tregjeve financiare ndërkombëtare ndikoi pozitivisht në performancën e sektorit pensional në vend. Orientimi i investimeve drejt tregjeve ndërkombëtare dhe strategjia për rritje të mëtejme të pjesëmarrjes së investimeve të jashtme në kuadër të gjithsej investimeve, rezultoi me kthime të larta për sektorin.

Grafik 71. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës




Burimi: BQK.

*Çmimi bazë i aksionit është : 1.0 €

FKPK realizoi kthim pozitiv nga investimet në vlerë prej 87.7 milionë euro. Çmimi i njësisë së aksionit të FKPK-së arriti në 1.68 euro, nga 1.63 euro sa ishte në ditën e fundit të vitit paraprak (Grafik 72).

Grafik 72. Performanca financiare e Fondit Sllveno-Kosovar të Pensioneve



Burimi: BQK.

*Çmimi bazë i aksionit është: 100€

Ecuri të ngjashme kishte edhe FSKP-ja, që shënoi kthim pozitiv nga investimet në vlerë prej 0.8 milionë euro. Po ashtu, edhe çmimi i aksionit të FSKP-së shënoi rritje në 196.3 euro nga 181.2 euro sa ishte një vit më parë (Grafik 72).

Pasiguritë në ekonominë globale po vazhdojnë edhe në vitin 2024, ndikuar nga tensionet gjeopolitike dhe rritja më e ngadalte ekonomike. Inflacioni, edhe pse në përgjithësi ka shënuar rënie, mbetet akoma i lartë në disa ekonomi, duke shkaktuar ndikime të pabarabarta në tregje si dhe potencialisht veprime të ndryshme në politikat monetare të shteteve. Në përgjithësi, pritjet janë për lehtësim të kushteve të financimit në gjysmën e dytë të vitit, me efekt të mundshëm

në kthimin nga investimet për sektorin pensional të Kosovës.


6.2 Sektori i Sigurimeve

6.2.1 Aktiviteti i sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve vazhdoi trendin e rritjes, ndikuar kryesisht nga rritja më e lartë e primeve të shkruara nga policat e shitura.

Pesha e sigurimeve në kuadër të sistemit financiar mbetet e ulët, me pjesëmarrje prej vetëm 2.7 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar. Niveli i ndërmjetësimit dhe densitetit të sektorit të sigurimeve mbetet i ngjashëm me vitet paraprake, duke shënuar një rritje vjetore marginale (Grafik 73).

Grafik 73. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve



Shprehur përmes primeve të shkruara bruto në raport me BPV-në, ndërmjetësimi i sektorit vazhdon të qëndrojë në nivel relativisht të ulët krahasuar me mesataren e vendeve të Bashkimit Evropian, në 1.51 përqind ngjashëm me vitin e kaluar. Po ashtu edhe densiteti mbetet në nivel të ulët, i matur përmes primeve të shkruara për kokë banori, i cili në vitin 2023 arriti vlerën prej 92.3 euro (75.5 euro në vitin 2022).³⁹


³⁹ Sipas statistikave të fundit të publikuara në databazën e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (Organization for Economic Co-operation and Development (OECD), niveli i densitetit në vitin 2022 në 38 vende të kësaj organizate (27 evropiane, përfshirë SHBA-të, Japoninë, dhe Australinë) ishte 3,722 euro (prime të shkruara për kokë banori), kurse niveli i depërtimit (ndërmjetësimit) në treg gjatë kësaj periudhe qëndroi në 9.3 përqind.

⁴⁰ Indeksi Herfindahl është llogaritur me formulën në vijim: $HI = \sum_{i=1}^n \frac{1}{S} \left(\frac{s_i}{S} \right)^2$, ku S pjesëmarrjen e kompanisë në gjithsej

Struktura e sektorit të sigurimeve vazhdon të dominohet nga shërbimet e siguruesve 'Jo-Jetë', që përfaqësojnë 91.6 përqind të aseteve të tregut të sigurimeve, ndërsa pjesa e mbetur prej 8.4 përqind përfaqësohet nga asetet e siguruesve 'Jetë'.

Kompanitë me pronësi vendore kanë rritur me tej pjesëmarrjen në tregun e sigurimeve duke arritur në 61.8 përqind pjesëmarrje nga 56.5 përqind në vitin 2022. Në kuadër të kompanive me kapital të huaj, siguruesit nga Shqipëria vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në asete, pasuar nga siguruesit nga Sllovenia dhe Austria (Grafik 74).

Grafik 74. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë (dhjetor 2023)




Tregu i sigurimeve në Kosovë karakterizohet me një shkallë më të ulët të koncentrimin, mirëpo me tendencë rritëse gjatë kësaj periudhe. Indeksi Herfindahl⁴⁰ për primet e shkruara bruto (PSHB) ka arritur në 992 pikë. Po i njëjti indeks i kalkuluar duke marrë për bazë asetet e tregut të sigurimeve tregon vlera më të ulëta prej 954 pikë, por krahasuar me një vit më parë rezultojnë të jetë rritur për 27 pikë bazë. Në të njëjtën kohë, indeksi CR5⁴¹ për vitin 2023, i llogaritur në raport me PSHB për sektorin e sigurimeve, rezultojnë 59.6 përqind (58.2 përqind në vitin 2022), ndërsa i llogaritur në

mjetet (primet e shkruara bruto - PSHB) e tregut të sigurimeve, në është gjithsej numri i institucioneve në sektorin përkatës. Në qoftë se indeksi shtrihet ndërmjet intervallave 1,000 – 1,800 njësi, niveli i koncentrimin në sektorin e sigurimeve konsiderohet i pranueshëm.

⁴¹ Indeksi CR5 kombinon pjesëmarrjen në treg të 5 kompanive me vlerat më të larta të aseteve në raport me gjithsej asetet e sektorit dhe PSHB ndaj gjithsej PSHB të sektorit.

raport me asetet, rezulton 55.5 përqind (53.5 përqind në vitin 2022). Pra, rritja e lehtë e koncentrimin si në raport me asetet ashtu edhe primet e shkruara bruto reflekton zvogëlimin e operatorëve të sigurimit në vitet e fundit, ndërsa koncentrimi është më i lartë në tregun e siguruesve që ofrojnë shërbime të sigurimit ‘Jetë’ për shkak të numrit të ulët të tyre.


Grafik 75. Asetet e sektorit të sigurimeve



Vlera e asetëve të sektorit të sigurimeve arriti në 304.1 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 12.7 përqind (Grafik 75). Rritjen më të theksuar e shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, duke shënuar rritje vjetore prej 11.6 përqind në fund të vitit 2023, megjithëse më të ngadalësuar se vitin e kaluar (rritje vjetore 14.6 përqind). Rritje të lartë prej 11.5 përqind shënoi edhe kategoria e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, e cila përfaqëson 16.7 përqind të asetëve të sektorit pensional (Grafik 76). Rritja e këtyre dy kategorive në kuadër të asetëve kryesisht është ndikuar nga normat e favorshme të interesit në vitet e fundit. Zërat tjerë si paraja dhe depozitat në BQK, si dhe investimet në prona, që janë dy kategoritë me peshën më të ulët në kuadër të asetëve, shënuan rënie të njëjtë prej 11.8 përqind.

Asetet e segmentit të sigurimeve “Jo-Jetë” arritën në 278.7 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 12.8 përqind. Siguruesit ‘Jo-Jetë’ përfaqësuan 91.6 përqind të gjithë asetëve të sektorit. Ndërsa, segmenti i sigurimeve “Jetë” shënoi rritje vjetore prej 12.0 përqind dhe arriti vlerën 25.5 milionë euro.

Grafik 76. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve (dhjetor 2023)



Në kuadër të detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit, provizionet teknike përfaqësojnë pjesën më të madhe me gjithsej 66.2 përqind, pasuar nga kapitali i aksionarit me 24.7 përqind, dhe zërat tjerë bilancor me peshë më të ulët (Grafik 77).

Grafik 77. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve (dhjetor 2023)




Vlera e kapitalit ka shënuar rritje më të lartë krahasuar me një vit më parë si rrjedhojë e fitimit dukshëm më të lartë të realizuar në vitin 2023. Njëherit, operimi me fitim për vitin e katërt me radhë ka ndikuar në zvogëlim të mëtejshëm të humbjeve të bartura nga vitet e kaluara, të cilat zbritën në 39.6 milionë, për 2.6 milionë më ulët se në vitin 2022.

Trendi i rritjes së primeve të shkruara ka vazhduar edhe në vitin 2023, por me ritëm më të ngadalësuar si rezultat i ngadalësimit të rritjes së primeve vullnetare të sigurimit të shëndetit. Vlera e gjithë primeve të shkruara arriti në 146.5 milionë euro, rritje vjetore prej 9.4 përqind nga 14.1 përqind në vitin paraprak.

Struktura e primeve të shkruara vazhdon të dominohet nga primet e sigurimit “Jo-Jetë”, me pjesëmarrje prej 95.5 përqind. Vlera e këtyre primeve në vitin 2023 arriti në 139.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.7 përqind (Grafik 78). Në kaudër të këtyre primeve, vazhdojnë të dominojnë sigurimet e detyrueshme me një pjesëmarrje prej 59.0 përqind në gjithsej bruto primet e shkruara, ndërsa pjesa tjetër përfshinë sigurimet vullnetare.

Grafik 78. Primet bruto të arkëtuara



Burimi: BQK.

Produktet e sigurimeve të detyrueshme shënuan rritje vjetore prej 9.7 përqind nga 7.1 përqind, ndikuar kryesisht nga produktet “MTPL” (tabela 5). Ndërsa, në kuadër të sigurimit vullnetar, kategoria ‘Sigurimi i Sëmundjeve’, e cila është kategoria e dytë me peshën më të madhe në kuadër të gjithsej primeve të shkruara (20 përqind pjesëmarrje), u karakterizua me ngadalësim të rritjes vjetore në 6.5 përqind nga 31.0 përqind dhe arriti vlerën prej 28.6 milionë euro.

Kategoria tjetër e sigurimit vullnetar, ‘Sigurimi i mjeteve tokësore’ ka shënuar rritje për 20.8 përqind, duke arritur vlerën 10.4 milionë euro.

Rritje është shënuar edhe në kuadër të volumit të policave të shitura në vitin 2023, përkatësisht në 1.48 milionë sosh, një rritje vjetore prej 12.3 përqind.⁴² Numri i polisave

të shitura në vitin 2023 për kategorinë ‘Sigurimi i Sëmundjeve’ në kuadër të sigurimit vullnetar ka arritur në 293.2 mijë, duke shënuar rritje për 10.3 përqind. Për më tepër, niveli i primeve për kokë banori sa i përket sigurimit të shëndetit është rritur në 16.1 euro në vitin 2023, nga 15.1 euro sa ishte në vitin 2022.

Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi “Jetë” arriti në 6.6 milionë euro, rritje vjetore për 3.5 përqind. Primet ‘Jeta e kombinuar’ dhe ‘Jeta e debitorit’ (“sigurimi i jetës”) kishin kontributin kryesorë në gjithsej rritje, si rezultat i rritjes vjetore prej 3.9 përqind dhe 4.9 përqind, respektivisht.

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e siguruesve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rritje vjetore të përsheptuar, prej 11.6 përqind nga 5.4 përqind një vit më parë, duke arritur në 71.7 milionë euro në fund të vitit 2023. Raporti i dëmeve të paguara nga BKS-ja në kuadër të gjithsej dëmeve ka rënë në 8.5 përqind apo 5.3 pikë përqindje më e ulët se vitin paraprak. Kurse, pjesa tjetër prej 91.5 përqind mbulohet nga siguruesit, me pjesëmarrjen më të lartë të siguruesve ‘Jo-jetë’ (89.4 përqind).

Rritja vjetore më e lartë e gjithsej dëmeve kryesisht është rrjedhojë e rritjes vjetore prej 140.9 përqind e kategorisë “Sigurime në pronë” apo rritje për 3.5 milionë euro nga viti paraprak. Kategoria e radhës me kontributin më të madh në rritje ishin dëmet e sigurimeve vullnetare ‘Aksident dhe Shëndet’, si dhe ‘MTPL-së’ në kuadër të sigurimit të detyrueshëm (tabela 6). Vlera e dëmeve të paguara nga sigurimet vullnetare u rrit për 27.7 përqind krahasuar me vitin paraprak, dhe arriti në 29.5 milionë euro. Kurse, vlera e dëmeve të paguara nga sigurimi i detyrueshëm u rrit për 1.8 përqind, duke arritur në 40.8 milionë euro.

⁴² Përfshihet vetëm sigurimi i jo-jetës.

Tabela 5. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit (në miliona euro)

Aktiviteti	2022	2023	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja: 2022	Pjesëmarrja: 2023
<i>Gjithsej Jo-jetë</i>	127.7	139.9	9.5%	95.2%	95.5%
<i>Sigurimi i detyruar</i>					
MTPL	63.2	69.2	9.5%	47.1%	47.3%
TPL+	3.6	4.1	14.0%	2.7%	2.8%
Sigurime kufitare	8.4	9.2	9.6%	6.3%	6.3%
<i>Sigurimi vullnetar</i>					
Aksident dhe shëndet	28.4	30.3	6.9%	21.1%	20.7%
Kasko	8.6	10.4	20.8%	6.4%	7.1%
Kredi dhe garancione	7.6	8.7	13.7%	5.7%	5.9%
Zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë	6.0	6.6	10.2%	4.5%	4.5%
Përgjegjësi civile të përgjithshme	1.9	1.3	-31.6%	1.4%	0.9%
<i>Gjithsej jetë</i>	6.4	6.6	3.5%	4.8%	4.5%
Gjithsej tregu	134.0	146.5	9.4%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK.

Vlera e dëmeve të paguara nga sigurimet “Jetë” në vitin 2023 arriti në 1.49 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 29.53 përqind, dukshëm më e lartë se rritja prej 3.3 përqind në vitin e kaluar.

Dëmet e paguara nga risiguruesit marrin pjesë me 15.1 përqind në gjithsej shumën e paguar të dëmeve nga siguruesit⁴³ (12.9 përqind në vitin paraprak).

Tabela 6. Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit (në miliona euro)


Aktiviteti	2022	2023	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja: 2022	Pjesëmarrja: 2023
<i>Gjithsej Jo-jetë</i>	63.2	70.3	11.2%	98.2%	97.9%
<i>Sigurimi i detyruar</i>	0.0	0.0			
MTPL	30.9	34.4	11.3%	48.1%	47.9%
TPL+	0.3	0.3	-4.3%	0.5%	0.4%
Sigurime kufitare, FG, MoU	8.8	6.1	-31.2%	13.7%	8.5%
<i>Sigurimi vullnetar</i>	0.0	0.0			
Aksident dhe shëndet	13.0	15.7	20.3%	20.3%	21.8%
Kasko	5.5	6.3	15.5%	8.5%	8.8%
Kredi dhe garancione	1.8	0.9	-50.2%	2.9%	1.3%
Sigurime në pronë	2.7	6.5	140.9%	4.2%	9.1%
Sigurimi mallit në tranzit	0.0	0.0	36.0%	0.0%	0.0%
Përgjegjësi e përgjithshme	0.0	0.0	-45.4%	0.0%	0.0%
<i>Gjithsej jetë</i>	1.1	1.5	29.5%	1.8%	2.1%
Gjithsej tregu	64.3	71.7	11.6%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK.

Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara shënoi rritje marginale për 1.0 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 49.0 përqind (Grafik 79). Kjo erdhi

si rezultat i rritjes më të ulët në të hyra (prime të arkëtuara) krahasuar me normën e rritjes së shpenzimeve (dëme të paguara) në vitin 2023 krahasuar me një vit më parë (tabela 5 dhe 6).

⁴³ Nuk përfshihet BKS-ja.

Grafik 79. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara


Burimi: BQK.

6.2.2 Performanca financiare e sektorit të sigurimeve

Sektor i sigurimeve këtë vit e mbylli me rezultat pozitiv financiar prej 11.0 milionë euro, performancë dukshëm më e lartë në krahasim me fitimin neto prej 2.1 milionë euro në vitin paraprak (tabela 7). Siguruesit “jo-jetë” shënuan fitim neto prej 10.0 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 2.5 milionë euro në vitin 2022. Edhe siguruesit “jetë” performuan më mirë këtë vit duke realizuar fitim neto prej 1.0 milionë euro, për

Tabela 7. Rezultati financiar (në milionë euro)

Përshkrimi	2019	2020	2021	2022	2023
Sigurimet Jojetë	-5.1	2.0	5.8	2.5	10.0
Sigurimet Jetë	0.5	0.3	0.5	-0.4	1.0
Gjithsej tregu	-4.7	2.3	6.3	2.1	11.0

Burimi: BQK.

6.3. Sektori mikrofinanciar dhe ndihmësit financiar

6.3.1 Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar

Sektor i mikrofinanciar shënoi rritje të theksuar gjatë vitit 2023, kryesisht si rezultat i përshpejtimit të rritjes së kreditimit dhe lizingjeve, përkundër kostove të larta të financimit nga jashtë. Viti në vijim pritet të jetë më i favorshëm sa i përket normave të interesit në tregjet financiare globale, gjë e cila pritet të reflektoj në uljen e kostove të financimit dhe performancën e sektorit mikrofinanciar.

dallim nga humbja në vlerë prej 0.4 milionë euro në vitin paraprak. Rritja e fitimit të realizuar kundrejt vitit të kaluar kryesisht është rezultat i rritjes së të hyrave, përkatësisht rritjes në vlerë të arkëtimeve nga primet e shitura gjatë vitit. Po ashtu, krahasuar me vitin e kaluar, pagesa për primet e risiguruar është për 3.2 milionë euro më e ulët, gjë e cila ka kontribuar në fitimin neto të sektorit.


Niveli i likuiditetit në sektorin e sigurimeve u karakterizua me rënie të lehtë vjetore. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave zbriti në 97.4 përqind nga 102.5 përqind në vitin 2022. Kjo si rezultat i rritjes vjetore më të ngadalësuar të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 10.9 përqind, krahasuar me rritjen më të lartë prej 16.7 përqind të rezervave teknike të sektorit të sigurimeve. Ngjashëm edhe raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve zbriti në 85.6 përqind, nga 87.6 përqind sa ishte një vit më parë. Ecuria e trajtimit, rezervimit dhe pagesës së dëmeve mbetet në fokusin e lartë të BQK-së.

Sektor i mikrofinanciar vazhdon të financohet kryesisht nga huazimet nga sektori i jashtëm, ndërsa në masë më të vogël financohet nga kapitali vetanak, si dhe huazimet tjera brenda vendit (kryesisht sektorit bankar). Politikat monetare të shtrënguara në nivel global gjatë vitit 2023, për të frenuar dhe zbutur inflacionin, kishin ndikim direkt edhe në rritjen e kostos së financimit të aktivitetit të sektorit mikrofinanciar, marrë parasysh strukturën e financimit të sektorit. Kjo rritje në masë e shpenzimeve të sektorit u reflektua në mbajtje të normave të interesit në nivel të lartë për produktet kreditore kryesore (kreditim dhe lizing), përderisa zgjerimi i

aktivitetit të sektorit u përshpejtua si rezultat i kërkesës së lartë.

Asetet e sektorit arritën në 540.2 milionë euro, që përkon me rritje vjetore prej 34.8 përqind nga 17.9 përqind në vitin paraprak (Grafik 80).⁴⁴

Grafik 80. Asetet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Në tregun vendor operojnë 32 institucione mikrofinanciare,⁴⁵ nga të cilat 14 kanë pronësi të huaj dhe përfaqësojnë 78.7 përqind të gjithsej asetëve të sektorit. Indeksi Herfindahl-Hirschman për asetet rezultoi me 1,415 pikë në vitin 2023, që paraqet rënie të koncentrimin nga periudha e njëjtë e vitit paraprak (1,528 pikë). Poashtu, pjesëmarrja e asetëve të tri institucioneve më të mëdha në gjithsej asetet e sektorit u zvogëlua në 54.5 përqind, nga 56.1 përqind sa ishte në vitin 2022.

Ndonëse rritje shënuan të gjithë zërat e asetëve, rritja e nivelit të kreditimit dhe lizingjeve, janë kontribuuesit kryesor në rritjen e total asetëve. Kreditë vazhdojnë të jenë kategoria më e madhe për nga pesha në kuadër të asetëve të sektorit, pasuar nga ajo e lizingjeve dhe kategoria e bilancit të mbajtur në bankat komerciale (Grafik 81).

Grafik 81. Struktura e asetëve të sektorit mikrofinanciar (dhjetor 2023)



Sa i përket detyrimeve, aktiviteti i sektorit mikrofinanciar financohet kryesisht nga huamarrjet, që përbëjnë 63.9 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit, ndërsa vetëm financimi nga sektori i jashtëm përbën 61.3 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit. Përkundër kostove më të larta të financimit, sektori zgjeroi financimin nga jashtë në 326.1 milionë euro, rritje vjetore prej 31.9 përqind nga 21.0 përqind rritje në vitin e kaluar.


Stoku i kredive arriti në 360.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore të përshpejtuar prej 25.9 përqind nga 19.8 përqind në vitin 2022. Rritja e theksuar e kreditimit për të dytin vit me radhë reflekton kërkesën për kredi nga të dy segmentet, atë të ekonomive familjare (që kishin kontributin kryesor në rritjen e përgjithshme të kredive) dhe korporatave jofinanciare. Kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje për 21.1 përqind dhe arriti në 220.4 milionë euro. Kurse, kreditë ndaj korporatave jofinanciare shënuan rritje vjetore prej 34.2 përqind dhe arritën në 140.2 milionë euro. Sipas afatit të maturimit, kreditë e ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’ dominojnë strukturën e gjithsej kredive, pasuar nga ato me maturim “mbi 1 deri 2 vite” (Grafik 82).

⁴⁴ Ndikim të rëndësishëm në rritjen e asetëve të sektorit mikrofinanciar kishte edhe riklasifikimi i dy ndihmësve financiar në ndërmjetës tjerë financiar (IMF&IFJB), në nëntor 2023. Asetet e sektorit pa përfshirjen e këtyre dy institucioneve arrijnë vlerën 513.5 milionë euro apo rritje vjetore prej 28.1 përqind.

⁴⁵ Këtu përfshihen edhe institucionet financiare jo-bankare që kryejnë aktivitete të kredidhënies, lizingut dhe faktoringut. Po ashtu, nëse të dhënat krahasohen me vitet e kaluara mund të vëreni që ka dallim të theksuar në numrin e IMF-ve të raportuara këtë periudhë për shkak të ndryshimeve metodologjike. Në numrin e IMF-ve përfshihen edhe IFJB me aktivitet të transferit të parave/pagesave/këmbimit, e që kanë ndikuar në rritje të theksuar të numrit të institucioneve financiare në këtë sektor.


Kreditimi ndaj korporatave jofinanciare sipas sektorëve të ekonomisë ka vazhduar trendin e viteve të kaluara, duke shënuar rritje në të gjithë sektorët.

Grafik 82. Kreditë e sektorëve ekonomik sipas maturitetit



Stoku i kredive të bujqësisë ka peshën më të madhe në gjithsej kreditimin për korporatat jofinanciare të IMF/IFJB-të prej 25.0 përqind (Grafik 83). Në vitin 2023, kreditë për këtë sektor shënuan rritje vjetore të përsheptuar prej 30.0 përqind nga 25.4 përqind rritje vitin paraprak, duke arritur në 35.0 milionë euro (Grafik 84). Në rritjen e kreditimit për segmentin e bujqësisë ndikim kishte edhe garancia e ofruar nga FKGK-ja për të mbuluar rrezikun për kreditë në sektorin Agro për NMVM-të.⁴⁶


Grafik 83. Struktura e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik (dhjetor 2023)



Krahasuar me një vit më parë, shumta e miratuar e kredive nga FKGK-ja për institucionet mikrofinanciare arriti në 7.2 milionë euro, një rritje kundrejt vitit paraprak për 27.4 përqind. Si rrjedhojë e

garancive prej FKGK-së, veçanërisht në dy vitet e fundit, IMF-të i janë përgjigjur pozitivisht kërkesës për kredi për bujqësi, që vlerësohet si sektor që bartë rrezik më të lartë. Me rritje dyshifrore gjatë kësaj periudhe u karakterizuan edhe sektori i ndërtimtarisë, tregtisë dhe industrisë. Kreditimi ndaj sektorit të shërbimeve tjera⁴⁷ kishte kontributin dhe rritjen më të lartë gjatë kësaj periudhe.

Grafik 84. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik



Lizingjet vazhduan rritjen me ritëm të lartë në vitet e fundit, duke shënuar rritje vjetore prej 30.8 përqind në vitin 2023. Kontributin kryesor në rritje e kishin lizingjet për korporatat jofinanciare ndërkohë që kontributi i lizingjeve për ekonomitë familjare ishte dukshëm më i ulët (Grafik 85). Edhe në përbërje lizingjet ndaj korporatave jofinanciare kanë peshën kryesore, duke përfaqësuar 69.4 përqind të gjithsej vlerës së lizingjeve. Kjo kategori e lizingjeve ka arritur në 66.9 milionë euro duke shënuar rritje vjetore prej 47.9 përqind. Sipas maturitetit të lizingjeve për korporatat jofinanciare, pjesa më e madhe dominohet nga lizingjet afatmesme 'mbi 2 deri në 5 vite' me pjesëmarrje prej 58.4 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi 'më pak ose deri në 1 vit' me pjesëmarrje prej 33.1 përqind.


Kurse, lizingjet ndaj ekonomive familjare, shënuan rritje dukshëm më të ngadalësuar prej 3.5 përqind, apo vetëm 1.0 milion euro më shumë se vitin e kaluar dhe arritën vlerën prej 29.5 milionë euro. Në kuadër të lizingjeve për

⁴⁶ Ndërmarrjet mikro, të vogla, dhe të mesme (NMVM-të)

⁴⁷ Hotelet dhe Restorante, Tregti tjetër, Shfrytëzimi i shërbimeve financiare, patundshmëri, qera, Shërbime tjera etj.

ekonomitë familjare, ‘lizingu hipotekar’, që përfaqëson kategorinë dominuese, shënoi rënie vjetore prej 0.1 përqind nga 6.4 përqind rritje vjetore në vitin e kaluar. Ndërsa, kategoria ‘lizingu për paisje’ shënoi rritje vjetore prej 33.7 përqind dhe njëherësh ishte kategoria e lizingjeve që kishte kontributin kryesor në rritjen e lizingjeve të ekonomive familjare.


Grafik 85. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Lizingjet për ekonomitë familjare vazhdojnë të dominohen nga lizingjet afatgjata ‘mbi 10 vite’ të cilat kanë pjesëmarrje prej 48.9 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ me pjesëmarrje prej 44.1 përqind.

Grafik 86. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Normat e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar u ndikuan nga dinamikat e normave të interesit në nivel global. Ato ndërprejnë trendin e rënies graduale të viteve të fundit, duke shënuar rritje të lehtë në 18.62 përqind nga 18.59 përqind në vitin paraprak.

Me rritje të normës së interesit u karakterizuan si kreditë për ekonomi

familjare, ashtu edhe ato të korporatave jofinanciare. Norma e interesit për ekonomi familjare arriti në 21.7 përqind, duke shënuar rritje vjetore për 0.5 pikë përqindje. Norma e interesit për korporatat jofinanciare u rritë gjithashtu për 0.5 pikë përqindje dhe arriti në 15.9 përqind (Grafik 86).

Grafik 87. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.

Në kuadër të kredive ndaj korporatave jofinanciare, norma mesatare e interesit shënoi rënie të lehtë vetëm për sektorin e bujqësisë, duke zbritur në 17.0 përqind nga 17.3 përqind në dhjetor të vitit 2022 (Grafik 87). Kurse, për sektorin e industrisë dhe me theks të veçantë atë të shërbimeve, kishte rritje të normës mesatare të interesit për 0.6 dhe 1.3 pikë përqindje respektivisht, duke arritur në 17.9 dhe 15.1 përqind në dhjetor 2023.


6.3.2 Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar realizoi fitim neto prej 18.1 milionë euro, rritje vjetore më e ngadalësuar prej 6.4 përqind nga 20.6 përqind vitin e kaluar. Rritja e normave të interesit në tregjet globale nga financohet sektori në masën më të madhe ndikoi në rritje të theksuar të shpenzimeve, përderisa normat veçsetë larta të interesit në anën e aseteve (kredi dhe lizingje) kufizuan mundësitë për rritje të të hyrave nga interesi me të njëjtin magnitudë, gjë e cila ndikoi në rënie të treguesve të profitabilitetit për sektorin.

Të hyrat e sektorit mikrofinanciar arritën në 70.8 milionë euro, një rritje vjetore prej 26.1 përqind krahasuar me vitin e kaluar. Në

kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi paraqesin kategorinë dominuese të të hyrave (87.0 përqind), dhe shënuan rritje vjetore prej 11.0 përqind nga 10.7 përqind në vitin e kaluar

Grafik 88. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Rritja e të hyrave nga interesi është kryesisht si rezultat i rritjes së lartë të kreditimit dhe normave të interesit në dy vitet e fundit. Kategoria e të ardhurave nga jointerеси shënoi rritje vjetore për 23.4 përqind, por që kontributi i tyre në rritjen e gjithsej të hyrave ishte i limituar për shkak të peshës së ulët në gjithsej të hyrat (13.0 përqind).

Shpenzimet e sektorit u rritën ndjeshëm dhe arritën në 52.7 milionë euro apo rritje vjetore prej 34.7 përqind nga 12.6 përqind rritje vitin e kaluar. Në kuadër të shpenzimeve, rritjen me të theksuar ka shënuar kategoria e shpenzimeve të interesit, duke arritur në 14.2 milionë euro apo rritje vjetore prej 69.2 përqind nga viti i kaluar. Kjo rritje në nivel të lartë të shpenzimeve të interesit i atribuohet kryesisht rritjes në vazhdimësi të normave të interesit në nivel ndërkombëtar, nga edhe financohet në masën më të madhe sektori. Rritje shënoi edhe kategoria e shpenzimeve nga jointerеси për 20.5 përqind nga viti paraprak. Kryesisht kjo rritje erdhi si rezultat i rritjes së pagave dhe numrit të puntorëve në këtë sektor, të cilat ndikuan rritjen e nënkategorisë së shpenzimeve të personelit dhe administrative për 11.6 përqind. Poashtu, në rritjen e kësaj kategorie të shpenzimeve ka ndikuar edhe nënkategoria e provizioneve për humbje nga kreditë me rritje për 2.0 milionë euro nga viti i kaluar. Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit mikrofinanciar u përkeqësua nga viti paraprak, duke u rritur për 4.7 pikë

përqindje, si rrjedhojë e rritjes më të lartë të shpenzimeve kundrejt rritjes së të hyrave. Në vitin 2023, ky indikator arriti në 74.5 përqind (Grafik 88).

Grafik 89. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Krahas raportit të hyra/shpenzime, edhe treguesit e tjerë të profitabilitetit të sektorit shënuan rënie. Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) zbriti në 4.3 përqind nga 4.9 përqind në vitin 2022, ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) shënoi rënie më të theksuar për 1.8 pikë përqindje, duke zbritur në 14.8 përqind nga 16.5 përqind (Grafik 89).

Sektori mikrofinanciar ka arritur të ruaj nivelin e ulët të kredive joperformuese dhe të siguroj mbulueshmeri të mirë me provizione, përkundër rritjes së lartë të kreditimit dhe sfidave të fundit si kosto e lartë e jetesës dhe aktiviteti më i ngadalësuar ekonomik

Grafik 90. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK.

Raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive mbetet në nivel të njëjtë me vitin paraprak, prej 1.8 përqind. Ndërsa, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me

provizione shënoi rënie të lehtë në 149.7 përqind nga 153.2 përqind në fund të vitit 2022 përkundër rritjes së vlerës së provizioneve. Kjo për faktin se vlera e kredive joperformuese shënoi rritje më të lartë vjetore prej 20.6 përqind (Grafik 90).

Spektori i ndihmësve financiarë, i cili përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjencionet për transferim të parave (ATP), përmbanë numrin më të madh të institucioneve financiare në vend, megjithëse menaxhon vetëm 0.1 përqind të gjithsej aseteve. Gjatë vitit 2023, dy ndihmës financiar janë ri-klasifikuar në ndërmjetës tjerë financiar (IMF&IFJB), gjë që ka ndikuar pasqyrat financiare të sektorit. Rrjedhimisht, vlera e aseteve të këtij sektori shënoi rënie vjetore prej 63.7 përqind, duke zbritur në 13.3 milionë euro.

Struktura e aseteve të ndihmësve financiar dominohet kryesisht nga asetet e tjera, që përbëjnë rreth 58.6 përqind të gjithsej aseteve. Kategoria e dytë për nga pesha, ajo e bilancit me bankat komerciale shënoi rënie të theksuar prej 85.8 përqind, duke zbritur në 3.2 milionë euro nga 22.6 milionë vitin e kaluar. Spektori

kryesisht financohet nga kapitali vetanak dhe huamarrjet, që përbëjnë 67.0 përqind, përkatësisht 17.5 përqind të gjithsej detyrimeve.

Të hyrat e ndihmësve financiarë zbritën në 7.4 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 34.3 përqind. Të hyrat e ndihmësve financiar në masën më të madhe dominohen nga të hyrat nga shërbimet, me pjesëmarrje 95.7 përqind në gjithsej të hyrat. Përkundër rënies në nivel të përgjithshëm të të hyrave, nënkategoria e të hyrave nga shërbimet arriti në 7.1 milionë euro nga 6.7 milionë euro në vitin paraparacak. Kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha, ajo e të hyrave tjera, shënoi rënie për 93.1 përqind krahasuar me një vit më parë dhe zbriti në 0.3 milionë euro. Shpenzimet shënuan rënie vjetore prej 20.8 përqind (rritje 21.0 përqind në vitin 2022), duke zbritur në 6.6 milionë euro, e që është kryesisht rezultat i rënies së shpenzimeve tjera operative për 65.7 përqind. Ndërsa, kategoria e shpenzimeve të interesit shënoi rritje të theksuar, nga 0.8 milionë vitin e kaluar në 3.0 milionë euro në vitin 2023.

7. Infrastruktura financiare në Kosovë

7.1. Sistemi i pagesave

Sistemi i pagesave ndërbankare të Kosovës⁴⁸ gjatë vitit 2023 ka vazhduar operimin me nivelin më të lartë të qëndrueshmërisë, sigurisë, dhe efikasitetit, duke kontribuar në ruajtjen e stabilitetit financiar. Krahas rritjes graduale të përdorimit të sistemit, janë ndërmarrë veprime rregullative⁴⁹ dhe operacionale për zgjerimin e bazës së

përfshirjes, rritjen e digjitalizimit si dhe avancimin e sistemit drejt standardeve të aplikueshme ndërkombëtare.

Treguesit statistikor të aktivitetit të Sistemit të pagesave ndërbankare të Kosovës – SPNK, gjatë vitit 2023 kanë reflektuar një rritje të transaksioneve në vëllim për 9.5 përqind dhe në vlerë për 7.4 përqind në krahasim me vitin paraprak, ku janë procesuar mbi 19 milionë transaksione me vlerë totale mbi 21.8 miliardë euro. Pagesat masive përfaqësuan numrin më të madhë të transaksioneve me rreth 77.9 përqind pjesëmarrje (tabela 8).

Tabela 8. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së, në përqindje

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	2022	2023	2022	2023
Të rregullta	14.0%	14.8%	11.6%	12.6%
Prioritare	3.1%	3.3%	44.5%	44.2%
Të rregullta - masive (pagesat nga tatimet, taksat, dogana, etj)	32.1%	31.4%	5.5%	6.0%
Prioritare - masive (pagat dhe pensionet nga qeveria)	46.6%	46.5%	8.3%	8.7%
Pagesat xhiro	4.0%	3.8%	7.8%	7.8%
Letrat me vlerë	0.0%	0.0%	4.2%	2.7%
Debitim direkt	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Bankë-bankë	0.0%	0.0%	18.1%	18.0%
Te kthyera	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%

Burimi: BQK.

Sa i përket vlerës së transaksioneve, pagesat prioritare janë kategoria me pjesëmarrjen më të lartë në transaksionet e realizuara (44.2 përqind e gjithsej vlerës së transaksioneve), kategori që arriti vlerën në 9.64 miliardë euro, pasuar nga kategoria bankë – bankë, që arritën në 3.93 miliardë euro.

Numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare⁵⁰ arriti në 2.51 milionë, që paraqet një

rritje vjetore prej 5.9 përqind. Llogaritë rrjedhëse, kryesisht llogari individuale, kishin kontributin kryesorë, me 5.4 përqind rritje vjetore.

Trendi i rritjes së digjitalizimit të pagesave ka vazhduar me ritëm të shpejtë. Numri i llogarive bankare E-banking, përmes të cilave shërbimet bankare kryhen 'online', arriti në 851.6 mijë⁵¹ (tabela 9), që

⁴⁸ Në Kosovë funksionon një sistem i vetëm për pagesa ndërbankare, Sistemi i Pagesave Ndërbankare (SPN), operuar dhe mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

⁴⁹ Më 1 gusht 2023, ka hyrë në fuqi Rregullorja për Qasjen në Llogari Pagese me Shërbime Bazike, e cila kontribuon në rritjen e përfshirjes financiare, si dhe nxitë pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve në sektorin financiar pa marrë parasysh rrethanat financiare të tyre, statusin e punësimit apo nivelin e të ardhurave, që të marrin përfitimet që sjellë tregu financiar me shërbime bazike me kosto më të ulët.

Më 29 nëntor 2023, BQK miratoi Rregulloren për Strukturën dhe Përdorimin e Identifikuesit Unik të Llogarisë së Pagesës për Transaksionet Kombëtare dhe Ndërkombëtare, e cila mundëson pajisjen me kodin e identifikimit të llogarive të pagesave (IBAN) edhe për institucionet financiare jo-bankare të autorizuar nga BQK, për

ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe parave elektronike. Qëllimi i kësaj rregulloreje është krijimi e një tregu modern dhe gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël në Kosovë, të mbështetur me infrastrukturë të sigurtë dhe efikase të pagesave, si dhe me një gamë të gjerë të instrumenteve dhe shërbimeve të pagesave.

⁵⁰ Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë.

⁵¹ Me hyrjen në fuqi të 'Rregullores për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave' nga viti 2018 ka ndryshuar edhe metodologjia e raportimi të numrit të llogarive të qasshme (aksessueshme) nga interneti. Ky numër paraqet numrin e llogarive rrjedhëse që kanë qasje në e-banking, kurse sipas metodologjisë së mëhershme kanë qenë të raportuara të gjitha llogaritë, duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, të kursimit dhe të afatizimit.

paraqet një rritje vjetore prej 23.6 përqind. Numri i pagesave të kryera përmes e-banking arriti në mbi 9.7 milionë transaksione, që krahasuar me vitin paraprak paraqet rritje për

17 përqind, me një vlerë që arriti në mbi 21.4 miliardë euro apo një rritje vjetore prej 13 përqind.

Tabela 9. Rrjeti i sektorit bankar

Përshkrimi	2019	2020	2021	2022	2023
Numri i degëve bankare	47	50	43	49	50
Numri i nëndegëve bankare	159	149	145	141	152
Numri i ATM-ve	497	513	516	534	583
Numri i POS-ve	13,769	13,421	13,836	14,769	17,187
Numri i llogarive 'e-banking'	337,693	411,346	537,733	688,891	851,645

Burimi: BQK.

Numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe pagesa të ndryshme u rrit për 4.3 përqind. Numri i kartelave me funksion debiti shënoi rritje vjetore prej 5.1 përqind dhe arriti në 1.37 milionë, kurse me funksion krediti shënoi rënie prej 1.0 përqind, në 180 mijë sosh. Pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të kartelave sipas operatorëve e kishin kartelat Visa me 53.0 përqind, pasuar nga ato Master Card me 43.2 përqind, kurse kartelat lokale⁵² kishin një pjesëmarrje prej 3.8 përqind.

Infrastruktura bankare në vend është zgjeruar në kontekst të rrjetit të numrit të bankomatëve (angl. Automated Teller Machine: ATM) dhe të numrit të paisjeve POS

(angl. Point-of-Sale) krahasuar me periudhën paraprake (tabela 10).

Kjo ndikoi pozitivisht në trendin në rritje të përdorimit të pagesave me kartelë. Numri i pagesave në pikat e shitjeve/POS është rritur për 33.7 përqind në 33.3 milionë, ndërsa në vlerë është evidentuar rritje krahasuar me vitin paraprak për 37.6 përqind duke arritur vlerën 1.0 miliardë euro. Vlera e pagesave përmes POS ndaj gjithsej transaksioneve me kartela në vitin 2023 kishte një pjesëmarrje prej 12.9 përqind.

Tërheqjet në bankomate/ATM gjithashtu tregojnë rritje në numër dhe vlerë krahasuar me vitin paraprak, për 7.6 përqind dhe 12.4 përqind, respektivisht.

Tabela 10. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela, në përqindje

Përshkrimi	2019	2020	2021	2022	2023
ATM tërheqje në para të gatshme	59.5%	62.7%	58.8%	56.1%	54.9%
ATM depozitime	29.9%	27.3%	30.8%	32.2%	32.0%
Kredit transfere nëpërmjet ATM	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Tërheqje cash në terminale POS	0.2%	0.1%	0.2%	0.2%	0.2%
Pagesa me kartela në terminale POS	10.3%	9.8%	10.2%	11.6%	12.9%

Burimi: BQK.

Numri i depozitimeve në sektorin bankar përmes ATM-ve gjatë kësaj periudhe arriti në 2.98 milionë transaksione apo rritje vjetore

prej 8.5 përqind, ndërsa në vlerë arriti 2.53 miliardë euro duke shënuar rritje vjetore prej 14.2 përqind.

⁵² Në kartela lokale përfshihen kryesisht kartelat e dedikuara për pensionistët.

Tabela 11. Numri i llogarive të parasë elektronike

Përshkrimi	2021	2022	2023
Llogaritë e parave elektronike (E-money accounts)	11,543	25,164	45,310

Burimi: BQK.

Tabela 12. Numri i llogarive të parasë elektronike

Përshkrimi	2021	2022	2023
Numri	52,779	293,097	1,620,139
Vlera	29,170,803	70,005,357	617,969,803

Burimi: BQK.


Në rritjen e digjitalizimit të pagesave kanë kontribuar edhe IFJB-të e regjistruara për emetimin e parasë elektronike. Në fund të vitit 2023, janë raportuar 45,310 llogari të parasë elektronike në këto institucione, duke shënuar një rritje të shpejtë bazuar në faktin se ky

është vetëm viti i katërt i operimit të tyre në treg (Tabela 11). Këto institucione së bashku kanë kryer një volum prej 1,6 milionë pagesa me para elektronike, me një vlerë prej rreth 617 milionë euro (Tabela 12).

8. Shtojca Statistikore


Shtojca 1. Harta e Stabilitetit Financiar - Dinamika e ndryshimit të rrezikut të treguesve dhe kontributi në rrezik nga komponentët përkatës

Figura 1. Ekonomia e jashtme




Burimi: BQK.

Figura 1. Ekonomia e jashtme




Burimi: BQK.

Figura 3. Ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Figura 4. Ndërmarrjet




Burimi: BQK.

Figura 5. Qeveria



Burimi: BQK.

Figura 6. Struktura e sektorit bankar



Burimi: BQK.

Figura 7. Kapitalizimi dhe profitabiliteti




Figura 8. Likuiditeti dhe financimi




Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sektori bankar	Grupi bazë i indikatorëve	Dhjetor 2020	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023
Mjaftueshmëria e kapitalit	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	16.5	16.4	15.5	16.5
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	14.7	14.7	13.5	14.6
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	4.6	3.4	3.4	3.2
Cilësia e asetëve	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	2.5	2.1	1.9	1.9
Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive	Korporatat tjera financiare	0.2	0.3	0.3	0.4
	Korporatat publike jofinanciare	0.00	0.00	0.00	0.00
	Korporatat tjera jofinanciare	63.3	62.3	62.1	60.2
	Ekonomitë familjare	36.4	37.4	37.6	39.2
	QUSHEF	0.03	0.02	0.01	0.02
	Jo-rezidente	0.1	0.0	0.1	0.2
	Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0
Profitabiliteti	Kthimi në asete (KNA)	1.7	2.1	2.6	2.5
	Kthimi në kapital (KNK)	14.0	17.3	20.7	19.8
	Margjina e interesit ndaj të hyrave bruto	79.2	76.5	76.4	79.4
	Shpenzimet e jo-nteresit ndaj të hyrave bruto	46.1	45.4	43.8	44.0
Likuiditeti	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	30.1	28.8	26.8	25.1
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	23.2	23.7	21.5	20.0
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	31.1	30.6	29.3	27.6
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	40.4	37.2	36.5	34.7
Senzitiviteti ndaj riskut të tregut	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	3.5	1.5	1.8	0.6
	Grupi i zgjeruar i indikatorëve				
	Kapitali ndaj asetëve	11.7	11.1	9.4	10.4
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	89.5	89.8	78.2	61.7
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointerеси	43.3	43.2	44.4	44.3
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	4.7	4.5	3.9	3.2
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	133.9	130.9	127.9	124.8
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	4.2	4.3	3.0	3.3

Të dhënat nga janari 2022 janë në përputhje me metodologjinë e re të rekomanduar për FSI-të (Udhëzuesi FSI 2019).



Rruga Garibaldi, Nr.33, Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org